



PLANI MENAXHIMIT TE MBETJEVE URBANE BASHKIA GRAMSH

Përmbajtja

Lista e Figurave, Tabelave dhe Hartave	3
I. HYRJE	4
1.1 Çfarë është plani vendor i menaxhimit të mbetjeve urbane?	4
1.2 Nevoja për hartimin e një plani vendor për mbetjet	5
1.3 Detyrimi dhe mbështetja ligjore për hartimin e planit	5
1.4 Procesi i hartimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes	6
II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIKA KOMBËTARE E RAJONALE	8
2.1 Përmbajtja e legjislacionit shqiptar	8
2.2 Politikat kombëtare	10
2.3 Politikat sipas planit rajonal	10
III. Informacion i Përgjithshëm	12
3.1 Profili i Bashkisë	12
3.1.1 Pozita Gjeografike	12
3.1.2 Hidrografia	13
3.1.3 Demografia	14
3.1.4 Bizneset dhe institucionet	16
3.1.5 Rrjeti Rrugor	17
3.1.6 Gjendja e Përgjithshme Mjedisore	18
3.2 Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve	20
3.2.1 Organizimi në nivel qendror	20
3.2.2 Organizimi në nivel rajonal	21
3.2.3 Organizimi në nivel lokal	21
3.2.4 Struktura e Bashkisë për mbetjet	22
3.2.5 Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet	23
3.3 Analiza e Mbetjeve	24
3.3.1 Shërbimet e mbetjeve	24
3.3.2 Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane	25
3.3.3 Infrastruktura e ofrimit të shërbimit aktual	26
3.3.4 Pastrimi i rrugëve	29
3.3.5 Lagia e rrugëve	30

3.3.6 Depozitimi	30
3.3.7 Riciklimi	31
3.4 Ekonomia dhe financimi.....	32
3.4.1 Buxheti vjetor dhe investimet.....	32
3.4.2 Ndarja e kostove	33
3.4.2 Tarifat dhe realizimi i të ardhurave.....	33
3.5 Performanca aktuale e administrimit të mbetjeve vendore	37
3.5.1 Analiza e indikatorëve të performancës	37
IV. PLANIFIKIMI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE URBANE	40
4.1 Vizioni.....	40
4.2 Objektivat.....	40
4.3 Objekti i Planit.....	41
4.3.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit.....	41
4.3.2 Integrimi me aktet nënligjore dhe dokumentet e tjera strategjike vendore dhe rajonale, që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me mbetjet	42
4.3.3 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit	42
4.4 Skenarët e administrimit të mbetjeve	43
4.4.1 Menaxhimi i mbetjeve bazuar ne objektivat ndërkombëtar, kombëtare dhe rajonale	50
4.4.2 Buxhetimi në bazë aktiviteti.....	55
V. PERSPEKTIVA FINANCIARE	75
5.1. Çështja e financimit dhe strategjia e “mbulimit të kostos”	75
VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	81
6.1 Rregullorja vendore	81
6.2 Detyrimi dhe sanksionet	82
6.3 Liçencimi Mjedisor	84
6.4 Pjesëmarrja e Sektorit Privat	85
6.5 Mbështetja Politike	86
VII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK	87
7.1 Metodat që mund të përdoren.....	88
VIII. PLANI I AKTIVITETEVE.....	90
IX. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE.	99
<i>Detyrat e ekipit monitorues:</i>	<i>101</i>

Lista e Figurave, Tabelave dhe Hartave

- Figura 1. Hapat e hartimit të planit MIMU
- Figura 2. Organograma e Bashkisë Gramsh
- Figura 3. Foto e gjendjes aktuale te vend-depozitimit.
- Figura 4. Skema nr.1 e menaxhimit të mbetjeve
- Figura 5: Skema nr.2 e menaxhimit të mbetjeve
- Figura 6: rritja e numrit të kontenierëve në 5 vitet e ardhshme
- Figura 7. Ndryshimi i kostove të shërbimit 2019-2024
- Figura 8. Struktura e koston së shërbimit në vitin 2024
- Figura 9. Shkalla e hierarkisë për PVMMU
- Figure 10: Skema e komunikimit mes aktorëve

- Tabela 1. Përmbledhja e kuadrit ligjor shqiptar për mbetjet
- Tabela 2. Qyteti dhe fshatrat sipas NJA
- Tabela 3. Popullsia për çdo NJA dhe ndryshimi mesatar i popullsisë
- Tabela 4. Kategorizimi i familjeve në Bashkinë Gramsh
- Tabela 5. Numri i Bizneseve sipas natyrës dhe NJA, Bashkia Gramsh
- Tabela 6. Popullsia sipas NJA, dhe gjenerimi i mbetjeve Bashkia Gramsh
- Tabela 7. Mbulimi me shërbimin e largimit të mbetjeve
- Tabela 8. Mjetet dhe tonazhi
- Tabela 9: Sipërfaqet që pastrohen Bashkia Gramsh
- Tabela 10. Tabelë përmbledhëse mbi shërbimin e mbetjeve Gramsh
- Tabela 11. Mbi buxhetin vjetor të shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve
- Tabela 12. Niveli i tarifave dhe të ardhurat për vitin 2019
- Tabela 13. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas viteve 2016-2017-2018
- Tabela 14. Mbulimi i koston operative nga të ardhurat
- Tabela 15. Indikatorët e performancës, viti 2018
- Tabela 16. Numri banorëve, bizneseve dhe institucioneve për periudhën 2019-2024
- Tabela 17. Konsumatorët dhe gjenerimi i mbetjeve në bazë vjetore 2019
- Tabela 18. Konsumatorët dhe gjenerimi i mbetjeve në bazë vjetore 2021
- Tabela 19. Mbledhja e mbetjeve për vitet 2019-2024
- Tabela 20. Llogaritja e numrit të kontenierëve për vitet 2019-2023
- Tabela 21. Kosto e fshirjes së rrugëve
- Tabela 22. Kosto e larjes së rrugëve
- Tabela 23. Të dhëna bazë për çdo zonë mbetjesh Viti 2019
- Tabela 24. Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme
- Tabela 25. Nevojat kapitale për makina teknologjike
- Tabela 26: Kosto e mirëmbajtjes
- Tabela 27. Kosto e grumbullimit të mbetjeve

Tabela 28. Kosto e transportit të mbetjeve

Tabela 29. Kosto e shoferëve dhe operatorëve viti 2019

Tabela 30. Kosto e amortizimit

Tabela 31. Kosto e totale e shërbimit

Tabela 32. Struktura e koston së shërbimit

Tabela 33. Kosto e totale e shërbimit

Tabela 34. Struktura e koston së shërbimit në vitin 2024

Tabela 35 Përmbledhje e evidentimit të kostove, 2019-2024

Tabela 36. Analizë e përmbledhur e planifikimit të të ardhurave

Tabela 37. Koeficienti i mbulimit të koston 2019-2024

Tabela 38. Plani i veprimit 2019-2024

Tabela 39. Aktorët kryesorë për zbatimin e PVMMU

Harta 1. Bashkia Gramsh

Harta 2. Hidrografia e Gramshi

Harta 3. Rrjeti rrugor i Bashkisë Gramsh

Harta 4. Mbulimi me shërbimin e pastrimit

Harta 5: Shpërndarja e PGM NJA Gramsh

Harta 6: Shpërndarja e PGM NJA Kodovjat

Harta 7: Shpërndarja e PGM NJA Pishaj

Harta 8. Gjurmët e pastrimit për rrugët dhe trotualet

Harta 9: Vendepozitimi i mbetjeve.

Harta 10. Zonat e mbetjeve.

I. HYRJE

1.1 Çfarë është plani vendor i menaxhimit të mbetjeve urbane?

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane (PVMMU) është një dokument udhëzues dhe planifikues, i cili mundëson zbatimin e politikës kombëtare dhe rajonale të mbetjeve në nivel vendor, drejt një menaxhimi të integruar e të qëndrueshëm të mbetjeve.

Qëllimi i tij është të prezantojë një përjasje të qartë të politikave të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, duke tentuar drejt një harmonizimi sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës të interesave dhe qëndrimeve të përbashkëta midis aktorëve të ndryshëm të interesuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

PVMMU është i orientuar në veprime konkrete në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, dhe menaxhimit. Më konkretisht, PVMMU përcakton mënyrën sipas të cilës do të manaxhohen mbetjet në Bashkinë Gramsh duke mundësuar dhe siguruar:

- ✓ Përputhshmëri me draft Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj, duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- ✓ Të ndërtojë dhe krahasojë skenarët specifikë të menaxhimit të mbetjeve për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare e rajonale.

- ✓ Të propozojë dhe rekomandojë hartimin e instrumentave të rëndësishëm institucionale, organizativ dhe financiar. Plani mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij;
- ✓ Të parashikojë koston operative të shërbimit dhe nevojat financiare për investime, duke përshkruar dhe argumentuar këto nevoja të lidhura me zbatimin e skemave efektive të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- ✓ Të ndërtojë instrumentat për informimin, komunikimin dhe monitorimin e planit në përgjithësi dhe treguesve të shërbimit në vecanti.

PVMMU shtrihet për njëperiudhë pesëvjeçare (2020-2024). Përgatitja e planit u mbështet nga "Bashki të Forta". Projekti zbatohet nga Helvetas dhe financohet nga qeveria zviceriane.

Ky është plani i parë për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Gramsh e lidhur vecanërisht me dy dokumenta të tjetër specifik: (i) Draft Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Strategjia); (ii) Masterplani ose Studimi i Nevojës për Investime në Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve (Masterplani Kombëtar).

1.2 Nevoja për hartimin e një plani vendor për mbetjet

Që prej vitit 1994 grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre dhe njëkohësisht duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të "granteve të pakushtëzuara".

Bashkia Gramsh tashmë përfshin një territor të zgjeruar urban dhe rural dhe mungesë të shërbimit në të gjithë territorin. Deri më sot është realizuar vetëm grumbullimi miks i mbetjeve të ngurta urbane dhe transportimi i tyre drejt vendit të grumbullimit dhe mungojnë nismat dhe politikat vendore, për të zvogëluar dhe diferencuar sasinë e mbetjeve në burim.

Në përgjithësi, problematika në sektorin e mbetjeve lidhet ngushtë me mungesën e instrumenteve të duhura për menaxhimin mjedisor të tyre, mungesën e teknologjive dhe investimeve dhe kapacitetet e pamjaftueshme në burimet njerëzore dhe financiare.

1.3 Detyrimi dhe mbështetja ligjore për hartimin e planit

Politika kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, përfshin edhe detyrimin ligjor për hartimin e një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane (SKMM, PKMM, neni 12 i ligjit 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"), që çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve; (neni 4 i ligjit 10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"), ku mbrojtja e mjedisit nga ndotja përbën përparësi dhe është e detyrueshme edhe nga bashkia¹.

¹ Sipas nenit 11 të ligjit 10431/2011, Bashkia brenda kompetencave të saj, harton planin përmes bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

Hartimi i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve², planit rajonal dhe atij vendor është një detyrim, që rrjedh nga direktivat e Këshillit të Evropës që Shqipëria duhet të zbatojë si një vend potencial për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian³.

1.4 Procesi i hartimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në mirëqeverisjen vendore të bashkisë Gramsh në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane duke ngritur kapacitetet e administratës dhe përmirësuar kuadrin rregullator të menaxhimit të mbetjeve urbane. Nëpërmjet këtij projekti përpjekjet tona më të mëdha u fokusuan në promovimin e përqaesgjithëpërfshirëse, transparencës në hartimin e planit vendor si një ndër treguesit kryesor të mirëqeverisjes dhe demokracisë.




Figura 1 Hapat e hartimit të planit MIMU

PVMMU është bazuar mbi indikatorë të performancës duke synuar monitorimin e cilësisë së shërbimit si edhe përfshirjen e publikut në proces. Procesi i hartimit të PVMMU në Bashkinë Gramsh filloi në prill të 2019 dhe kaloi në 5 faza kryesore (figura 1).

Gjatë fazës së parë u ngrit Grupi i Punës (GP) me përfaqësues nga administrata e Bashkisë që punoi në mënyrë aktive përgjatë gjithë procesit. Vlerësimi i situatës ekzistuese për menaxhimin e mbetjeve urbane u realizua nëpërmjet hulumtimit dokumentor në Bashki dhe duke mbledhur perceptimin e publikut realizuar nga projekte të tjera në zonë.

Tre fazat e fundit të procesit u zhvilluan në një bashkëpunim të ngushtë midis ekspertëve dhe GP. Ata punuan dhe diskutuan sëbashku përgjatë takimeve të ndryshme dhe ëorkshop-eve çdo element të planit. Sugjeruan dhe komentuan mbi draftet e përgatitura nga ekspertët dhe përfshinë në komunikime edhe aktorë të tjerë të interesuar sikundër është shoqëria civile dhe bizneset vendase.

Përgjatë gjithë procesit të hartimit të PVMMU në Bashkinë Gramsh element shumë i rëndësishëm ishte hartimi dhe zbatimi i një strategjie të gjerë të pjesëmarrjes dhe informimit të publikut.

Gjatë periudhës së përgatitjes së PVMMU, Bashkia Gramsh sapo kishte mbaruar procesin e Hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. **Vizionii këtij plani** është “*Bashkia e Gramshit është një bashki me standard të lartë, jete e mirë integruar me rrjetet kombëtare dhe rajonale, me zona rurale dhe urbane të konsoliduara që kanë akses të mirë tek njera tjetra. Bashkia Gramsh është një bashki me një ekonomi të bazuar në ferma blegtorale dhe turizëm, por edhe në shërbime dhe sektorët e industrisë.*”

² Miratuar: VKM nr.175, datë 19.1.2011

³Në qershor 2006 është firmosur Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe rrjedhimisht Qeveria Shqiptare ka marrë një seri angazhimesh që janë përqendruar në arritjen e pranimit në BE.

Ndërsa **Objektivi Strategjik** në lidhje me menaxhimin e integruar tëmbetjeve urbane përfshin mbledhjen e diferencuar dhe reduktimin e mbetjeve, zhvendosjen dhe rregullimin e venddepozitimit ekzistues për t'u përshtatur me kushte më sanitare, si dhe mundësitë e kryerjes së kompostimit të mbetjeve organike.

Më konkretisht:

- ✚ Hartimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkie me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane, si dhe blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane.
- ✚ Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi sipas standarteve të pikës së transferimit të mbetjeve të ngurta.
- ✚ Hartimi i një strategjie dhe sigurimi i kushteve fizike për kompostimin e mbetjeve organike si dhe ndërtimi i pikës së kompostimit.

II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIKA KOMBËTARE E RAJONALE

2.1 Përmbajtja e legjislacionit shqiptar

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislative të BE.

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të punës së MTM. Ndarja e mbetjeve në burim, rritja e nivelit të riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, asimilimi i plotë i hedhjes së mbetjeve në vendgrumbullime të pasigurta dhe asimilimi i plotë i djegies së mbetjeve, ndërtimi i landfilleve sipas standardeve të BE-së, sigurimi i lehtësive për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe sigurimi i investimeve të reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve, janë disa nga prioritetet kryesore në këtë fushë.

LMIM adapton shumicën e direktivave, vendimet dhe rregulloret e BE-së, dhe parashikon prioritetet dhe hierarkinë për menaxhimin e mbetjeve që paraprihet nga: (1) parandalimi; (2) ripërdorim; (3) riciklimi; dhe (4) alternativa të tjera, si burim energjie; dhe (5) asgjësimin përfundimtar".

Ligji përcakton njëherazi dhe hierarkinë e autoriteteve në menaxhimin e mbetjeve, ndër të tjera pushteti vendor duhet të hartojë, miratojë dhe zbatojë PVMMU.

Përveç kësaj, akte të tjera ligjore, të cilat janë zhvilluar më vonë për zbatimin e ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, kanë përcaktuar përgjegjësi të detajuara institucionale, duke përfshirë MTM dhe MIE:

- ✓ VKM nr. 509, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit";
- ✓ VKM nr. 504, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Enrgjisë";

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve plotësohet me Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili në nenin 23, përcakton që mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, është tërësisht një përgjegjësi funksionale dhe organizative e bashkisë.

Ligji për koncesionet dhe PPP 125/2013 i miratuar nga Parlamenti më 25/04/2013, lehtëson njësitë e qeverisjes vendore në përfshirjen e kapitalit privat përmes zhvillimit të programeve të PPP.

Më poshtë pasqyrohet përmbledhja ligjore në fushën e mbetjeve:

Ligjet kryesore në fushën e mbetjeve	Ligji nr.10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar me ligjin nr.156, datë 10.1 2013.
	Ligji nr. 8094/1996 "Për largimin publik të mbetjeve".
	Ligji nr. 9537/2006 "Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme", i azhurnuar me ligjin nr.9890, datë 20.03.2008.
	VKM nr. 389/2018 "për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të këshillit të ministrave, "për lëndfillet e mbetjeve"
	VKM 319/2018 për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të

Ligjet dytësore në fushën e mbetjeve	mbetjeve
	VKM 232/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të këshillit të ministrave, për ambalazhet dhe mbetjet e tyre;
	VKM nr. 652/2016 “për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura”
	VKM nr.687/2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.
	VKM nr.575/2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
	VKM 418/2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”
	VKM 641/2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte”
	VKM nr.608/2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”.
	VKM 117/2013 “Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”
	VKM Nr. 866 / 2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”.
	VKM Nr. 705 /2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”
	VKM nr. 452/2012 “Për lendfillet e mbetjeve”
	VKM Nr. 178/2012 “Për Incinerimin e mbetjeve”
	VKM nr. 177/2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre, ndryshuar me VKM nr.52, date 5.2.2014”.
	VKM Nr. 765/2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur”
	VKM nr. 333/2011 “Për administrimin e venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”.
	VKM 175/2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”
	VKM 798/2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”
	Rregullore nr. 1, datë 30.3.2007 “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimet dhe shkatërrimet, nga krijimi, transporti dhe deri tek trajtimi përfundimtar”
	Rregullore nr. 6, datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
Akte të tjera ligjore që lidhen direkt apo indirekt edhe me menaxhimin e mbetjeve	Udhëzues nr. 6, datë 27.11.2007 “Për aprovimin e rregullave, përmbatjes dhe afatave për skicimin e planeve për menaxhimin e mbetjeve”
	Ligji nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
	Ligji nr.9663/2006 “Për koncensionet”, të ndryshuar me ligjin 10157, date 15.10.2009
	Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
	VKM nr.247/2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
	Vendimi nr. 103/2002 “Në lidhje me monitorimin mjedisor në Republikën e Shqipërisë”
	Ligji nr. 10440/2011 , "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
	Ligji nr.10081/2009 “Mbi licensimin, autorizimin dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Tabela 1. Përmbledhja e kuadrit ligjor shqiptar për mbetjet

2.2 Politikat kombëtare

Strategjia dhe Plani Kombëtar 2011 – 2017 përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Këto dokumente janë në proces rishikimi dhe rikonceptimi që ka nisur në vitin 2017 dhe mbulon periudhën 2018 – 2033.

Kjo draft Strategji e Menaxhimit të Mbeturave dhe Plani i Veprimit (2019) ka si qëllim kryesor të përditësojë politikat dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe të rivlerësojë aftësitë e vendit për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në BE dhe specifikisht *acquis communautaire* të mishëruara në Kapitullin 27 për mjedisin. Ky dokument do të përshtasë drejtimet strategjike për ti bërë ato me efikase dhe të realizueshme për zbatuesit e politikave të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit si në nivelin qendror ashtu edhe atë vendor.

Objektivat specifike të strategjisë janë:

- Përmbushja e detyrimeve specifike të *acquis* të KE-së për menaxhimin e mbetjeve dhe të ligjit kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Zbatimi i Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) që kanë të bëjnë me sektorin e mbetjeve.
- Adresimi i problemeve kryesore të menaxhimit të mbetjeve me të cilat ballafaqohet vendi në një mënyrë të koordinuar dhe të integruar.

2.3 Politikat sipas planit rajonal

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka nxjerrë udhëzimin “Për rregullat, përmbajtjen dhe afatet e aprovuara që janë përcaktuar për përgatitjen e planeve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, nr. 6, datë 27.11. 2007. Sipas Udhëzimit, brenda një viti nga miratimi i Planit Kombëtar, duhet të hartohen planet rajonale në përputhje me parimet dhe objektivat e Planit Kombëtar (neni 8). Po ashtu në bazë të ligjit të MIM (neni 13 i ligjit 10463/2011 të amenduar me 2013) qarku është institucioni përgjegjës për aprovimin dhe ndjekjen e zbatimit të planit rajonal të MIM dhe atë planeve vendore, përmes dhe raportimeve që ky institucion bën në ministrinë përkatëse.

Planet rajonale përcaktojnë masat që duhen ndjekur nga autoritetet e qeverisë vendore për zbatimin e objektivave të PKMM të ngurta (neni 10).

Qarku i Elbasanit nuk ka ende një plan rajonal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake, pritet që në 2020 të nisë puna për hartimin e tij për zonën respektive të mbetjeve;

Ndërkohë objektivate draft Strategjisë që lidhen me kompetencat në nivel rajonal dhe vendor janë:

- Afatshkurtra (2018-2023)
 - Zhvillimi dhemitimi i Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve bashkiake / vendore në 50% të NJA
 - Zhvillimi i Studimeve të Fizibilitetit për MIM rajonale me prioritet "Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve" (ZMM)
 - Mbulimi 80% të popullsisë me shërbimin e grumbullimit

- 20% e popullsisë, por jo më pak se 10% e popullsisë në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë, (zona urbane) janë mbuluar nga shërbimi i integruar i mbetjeve
- Afatmesëm (2023-2028)
 - Zhvillimi dhe miratimi i Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve bashkiake / vendore në të gjitha bashkitë
 - Zhvillimi i Studimeve të Fizibilitetit për MIM rajonale të të gjitha ZMM
 - Mbulimi i 90% të popullsisë me shërbimin e grumbullimit
 - 25% e popullsisë, por jo më pak se 20% e popullatave në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë (zonat urbane) mbulohen nga shërbimi i integruar i menaxhimit të mbetjeve.
- Afatgjatë (2028-2033)
 - 95% e popullsisë mbulohet nga shërbimi i grumbullimit të mbetjeve
 - 30% e popullsisë, por jo më pak se 30% e popullatave në bashkitë me më shumë se 100,000 banorë (zonat urbane) mbulohen nga shërbimi i integruar i menaxhimit të mbeturinave.


III. Informacion i Përgjithshëm

3.1 Profili i Bashkisë

3.1.1 Pozita Gjeografike

Bashkia Gramsh ndodhet në pjesën qendrore dhe jugore të Shqipërisë, nga Qafa e Shënkollit, Lleshan në veri deri në Siman (Sqimar) në jug dhe nga Saraseli në perëndim deri në malin e Valamarës, Lenie në lindje.

Pjesa më e madhe e tij shtrihet në Krahinën Malore Qendrore, e cila quhet Krahina e Vërçës. Kjo pjesë ndodhet në anën lindore të lumit të Devollit. Pjesa tjetër e tij shtrihet në Ultësirën Perëndimore, e njohur kjo si krahina e Sulovës dhe zona që shtrihet midis lumit të Devollit dhe të Tomorricës shtrihet në Krahinën Malore jugore dhe njihet si krahina e Tomorricës.



Harta 1: Bashkia Gramsh

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS; 2017

Gramshi shtrihet në sektorin e mesëm të lumit të Devollit, i cili brenda rrethit ka një gjatësi prej 49 km, lumë, i cili siç e thamë, së bashku me lumën e Tomorricës, e ndan Gramshinnë tri krahina.

Bashkia Gramsh perbehet nga 94 fshatra dhe kufizohet nga tetëbashki të tjera të cilat janë: Cerrik, Elbasan, Perrenjas, Maliq, Skrapar, Berat, Kucove, dhe ka një sipërfaqe prej 739.2 km².

Sipas vendosjes gjeografike, ndodhet në zonën e klimës tranzitore, zonë që është mjaft e përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Lugina e Devollit dhe e Tomorricës përbëjnë pjesën më të shtruar të terrenit dhe ku gjenden edhe tokat më pjellore të tij. Në kurrizin jugor të vargut perëndimor janë

Njësitë Administrative Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre

Gramsh	Qyteti i Gramshit.
Pishaj	20 Fshatra: Pishaj, Trashovicë, Shëmrizë, Ostenth, Gurrëz, Cerunjë, Çekin, Qerret, Koçaj, Vinë, Fshat-Gramsh, Drizë, Cingar i Sipërm, Cingar i Poshtëm, Galigat, Kotorr, Gjergjovinë, Storrë, Liras, Tervol
Kodovjat	12 Fshatra: Kodovjat, Bratilë, Bulçar, Kishtë, Kokel, Posnovisht, Shelcan, Bersnik i Poshtëm, Bërsnik Sipërm, Mashan, Broshtan, Zamshe
Kukur	9 Fshatra: Kukur, Grazhdan, Gribë, Kalaj, Mukaj, Rashtan, Rmath, Snosëm, Sojnik
Kushovë	8 Fshatra: Kushovë, Bregas, Gjeraqinë, Dumberas, Bërsnik, Ulovë, Sotirë, Kerpice
Lenie	6 Fshatra: Lenie, Bicaj, Grabovë e Poshtme, Grabovë e Sipërme, Kurate, Valth
Poroçan	5 Fshatra: Poroçan, Lleshan, Gjerë, Kabash, Holtas
Skënderbegas	13 Fshatra: Skënderbegas, Bletëz, Ermenj, Fushëz, Harunas, Kotkë, Kullollas, Lemnushë, Nartë, Siman, Sëmbërdhenj, Vidhan, Zenelas
Sult	9 Fshatra: Sult, Mazrek, Dushk, Kukuçovë, Kutërqar, Kodër Zgjupe, Zgjupe Fushë, Dufshan, Grekan
Tunjë	12 Fshatra: Tunjë, Duzh, Irmanj, Jançe Qëndër, Jançe Mal, Katërlis, Lubinjë, Oban, Prrenjas, Plepas, Saraselë, Tunjë e Re

zhvilluar mjaft fenomenet glaciale si liqene, të vendosura në lartësinë 1500-1800 m mbi nivelin e detit.


Bashkia Gramsh ka në përbërje të saj 10 NJA.

Tabela 2: Qyteti dhe fshatrat sipas NJA

Burimi: Bashkia Gramsh

3.1.2 Hidrografia

Gramshi ka një hidrografi të pasur si me ujëra sipërfaqësore ashtu edhe nëntokësore, edhe pse burimet aktive gjithëvjetoje janë të dendura vetëm nga lartësia 1,000 m mbi nivelin e detit, ndërsa në zonën e poshtme ato janë të rralla. Këtu mund të përmendim dy lumenjtë kryesorë të rrethit Devolli me gjatësi brenda tij 49km dhe Tomorrica me një gjatësi prej 14km, gjithashtu janë të pranishme edhe disa lumenj të tjerë, por më të vegjël si ai i Holtës, Lenies, etj. Ndër liqenet mund të përmendim më të rëndësishmin prej tyre, liqenin e Dushkut me sipërfaqe prej 1km². Në rrëzë të malit të Tomorrit gjendet burimi i Kerpices, që furnizon qytetin e Gramshit dhe shumë fshatra në të cilat kalojnë tubacionet e ujit të pijshëm, por edhe më gjërë. Mund të themi se vetëm gjysma e tij shfrytëzohet për ujë të pijshëm, pjesa tjetër shfrytëzohet për prodhimin e energjisë në hidrocentralin e Kërpices. Gjithashtu, të pakëta por jo të parëndësishme janë dhe ujërat termale, të cilat kanë një shfrytëzim të kufizuar vetëm për popullsinë e zonës. Pra duke bërë një vlerësim të hidrografisë, mund të themi se ky rreth është mjaft i pasur me ujëra, si për të pirë, për ujitje dhe për aktivitete të ndryshme të ekonomisë siç mund të përmendim mullinjtë e bluarjes së miellit, të cilët përdorin ujin e rrjedhshëm 24 h për ushtrimin e aktivitetit të tyre punues.



Harta 2: Hidrografia e Gramshi

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS; 2016

3.1.3 Demografia

Bashkia Gramsh, ka nën administrimin e saj një qytet, 94 fshatra dhe një sipërfaqe prej 739.2 km².

Sipas Census-it, bashkia numëron 24,231 banorë ndërkohë që, sipas RGJC-së një popullsi prej 36,305 banorë. Dendësia e popullsisë llogaritet në rreth 49.1 banorë/km².

NJA	Tipologjia	Census	Sipas Rregjistrat Civil				
		2011	2016	2017	2018	2019	% Koeficienti i ndryshimit (2019/2018)
Gramsh	Urbane	8440	12880	12894	13980	13995	0.11%
Kodovjat	Rurale	2355	2994	2994	2823	2800	-0.82%
Kukur	Rurale	2560	3200	3200	2948	2948	0.00%
Kushove	Rurale	659	965	950	862	855	-0.82%
Lenie	Rurale	779	1957	1956	1447	1447	0.00%
Pishaj	Rurale	4906	7414	7410	7378	7366	-0.16%
Poroçan	Rurale	1269	1769	1765	1519	1504	-1.00%
Skenderbegas	Rurale	1239	1525	1524	1479	1475	-0.27%
Sult	Rurale	631	1158	1156	854	847	-0.83%
Tunje	Rurale	1393	2213	2213	2117	2106	-0.52%

Totali		24231	36075	36062	35407	35343	-0.18%
Urbane		8440	12880	12894	13980	13995	0.11%
Rurale		15791	23195	23168	21427	21348	-0.37%

Tabela 3: Popullsia për çdo NJA dhe ndryshimi mesatar i popullsisë

Burimi: Instat dhe Zyra e Gjëndjes Civile Bashkia Gramsh

35% e popullsisë klasifikohet si popullsi e zonës urbane dhe diferenca prej 65% si popullsi rurale.

Bashkia e Gramshit ka rreth 2,600 banesa të rregjistruara, ku banojnë rreth 11,600 familje.

Ndër problemet kryesore ekonomike dhe sociale me të cilat përballet sot bashkia mund të përmendim papunësinë që rezulton në nivele të larta: rreth 48.7% (më e lartë se mesatarja e papunësisë në rang vendi 30%). Indeksi i papunësisë për të rinjtë (mosha 15-24 vjec) dhe për femra paraqiten gjithashtu më të larta se mesatarja e vendit. Respektivisht, norma e papunësisë për të rinjtë është 71.2% (mesatarja kombëtare: 52.9%), ndërsa norma e papunësisë për femrat është 44.2% (mesatarja kombëtare 31.4%). Këta tregues flasin për domosdoshmërinë e marrjes së masave urgjente, duke synuar rritjen e numrit të të punësuarve, pa lënë jashtë vëmendjes edhe fuqizimin e orientimin nga tregu i punës të arsimit profesional të mesëm.

Në sektorin shtetëror kemi të punësuar 1,103 individë, ndërsa në sektorin privat kemi të punësuar 776 individë. Pra një përqindje relativisht shumë e vogël është e punësuar në këta dy sektorë, pjesa tjetër e popullsisë punojnë në bujqësi ose janë të papunë.

NJA	Familje gjithsej	Familje me ndihmë ekonomike		Me aftësi të kufizuar
		Numri	Në % ndaj totalit	Numri
Gramsh	4374	298	6.81%	886
Kodovjat	957	304	31.77%	177
Kukur	980	335	34.18%	162
Kushove	449	133	29.62%	59
Lenie	700	120	17.14%	50
Pishaj	2196	446	20.31%	379
Poroçan	597	209	35.01%	108
Skenderbegas	603	168	27.86%	114
Sult	437	82	18.76%	75
Tunje	673	202	30.01%	147
Totali	11966	2297	19.20%	2157

Tabela 4: Kategorizimi i familjeve në Bashkinë Gramsh

Burimi: Sektori i Mbrojtjes Sociale, Bashkia Gramsh

Të dhënat mbi numrin e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike janë një tregues indirekt i nivelit të varfërisë në Bashkinë Gramsh. Këtë ndihmë e përfitojnë në total rreth 2,297 familje, nga të cilat 298

në qytetin e Gramshit. Në raport me numrin total të familjeve, rezulton se në Bashkinë Gramsh përfitojnë ndihmë ekonomike rreth 19.2% e familjeve.

3.1.4 Bizneset dhe institucionet

Rrethi i Gramshit historikisht renditet ndër zonat me zhvillim të ulët ekonomik. Nga regjimi i kaluar Gramshi trashëgoi industrinë e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale. Edhe në ditët e sotme bujqësia është dega bazë e ekonomisë së rrethit, ajo zë 65% të GDP-së. Çdo familje fshatare në Gramsh ka në pronësi 0,97ha tokë arë ose 0.2 ha për frymë, sasi kjo e pamjaftueshme për zhvillimin e një ekonomie bujqësore me kërkesat e ekonomisë së tregut. Ndër kulturat e drithërave gruri zë peshën specifike më të madhe. Ai zë aktualisht 46% të sipërfaqes së mbjellë me bimë arësh dhe 72% të prodhimit të drithërave të bukës. Me misër mbillet 21% e sipërfaqes që zënë drithërat e kjo kulturë jep 27% të prodhimit të drithërave.

Gjithashtu nga të dhënat nga zyra e tatim taksave rezultojnë se në bashki operojnë 375 biznese të vogla, kryesisht shërbime dhe 50 biznese të mëdha.

Nga të dhënat nga zyra e tatim taksave rezultojnë se në bashki operojnë 481 biznese të vogla, kryesisht bar-kafe, shërbime, profesione të lira etj. Të ndara sipas tabelës së mëposhtme dhe 60 biznese të mëdha (subjekte juridik) ku dhe 50 janë të përqëndruara në qytet dhe 10 në NJësinë Administrative Pishaj kryesisht supermarket, farmaci, institucione financiare, kompani ndërtimi dhe hidrokarburesh etj.

Nr	Bizneset sipas aktivitetit	Totali	Sipas Njësi Administrative									
			Qytet	Pishaj	Kodovjat	Poroçan	Lenie	Kukur	Tunjë	Sult	Kushovë	Skënderbegas
A	Institucionet shtetërore	17	16	1	0	0	0	0	0	0	0	0
B	Shoqata Jo fitimprurëse	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C	Biznese	481	385	35	14	8	5	15	7	0	5	7
1	Prodhome brumi, embelsira, buke, sallam. Prodhome druri, duralumin	23	21	2	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Aktivitete kontabilist , noteri, avokat, dentist	29	28	1	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Bar-restorant, bar kafe e te ngjashme etj	151	86	21	10	6	4	8	7	0	5	4
4	Subjekte qe tregetojne mish, baxho etj	13	9	0	0	0	1	0	0	0	0	3
5	Ushqimore	47	38	5	4	0	0	0	0	0	0	0
6	Industriale, kinkaleri, kancelari, tregeti rrobash etj.	84	73	4	0	0	0	7	0	0	0	0

7	Subjekte sherbimi mekanik, parukeri, berber, servis tel etj.	95	93	2	0	0	0	0	0	0	0	0
8	Transport mallrash, autobus, taxi	27	25	0	0	2	0	0	0	0	0	0
9	Tregtare ambulant	12	12	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 5: Numri i Bizneseve sipas natyrës dhe NjA, Bashkia Gramsh

Burimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashki, Shtator 2019

Performanca e përgjithshme e bizneseve është e lartë, përse i takon pagesës së tarifës së vendosur në lidhje me shërbimin e pastrimit dhe e ulët përse i përket familjarëve. Tarifa e mbledhur nga familjet është në masën 28-30% e planit, ndërsa për bizneset është në masën pothuajse 100% realizim plani. Edhe pse bizneset në Bashkinë e Gramshit përballen me një sërësfidash dhe me një fuqi të ulët blerëse janë tepër të ndërgjegjësuar për detyrimet që kanë duke i likuiduar ato. Duhet të punohet më shumë me familjet në mënyrë që të rriten arkëtimet nga kategoria e familjeve dhe pse administratatimore pranë Bashkisë Gramsh përballet cdo ditë me faktin që papunësia është shumë e lartë dhe një pjesë shumë e madhe e familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike.


3.1.5 Rrjeti Rrugor

Gramshi është 97 km larg Tiranës, 94 km larg Korçës dhe 47 km larg Elbasanit. Pra, duhet theksuar fakti se ai është afër autostradave, veçanërisht pranë aksit perëndim-lindje: Durrës-Qafë Thanë-Pogradec-Korçë.

Në bashkinë Gramsh ekzistojnë këto linja ndërqytetase:

- Linja Gramsh- Tiranë me 4 orare në ditë;
- Linja Gramsh - Durrës me 4 orare në ditë;
- Linja Gramsh - Elbasan me 8 orare në ditë;
- Linja Gramsh - Berat me 1 orar në ditë.

Përse i përket transportit rrethqytetas, janë 19 linja të shpërndara në pjesën më të madhe të territorit, në çdo Njësi Administrative. Linjat në këtë territor funksionojnë në mënyrë lineare duke parë relievin e vështirë ku shtrihet kjo bashki. Ndër itineraret me më shumë fluks mund të përmendim linjat që kalojnë në pjesën veriore dhe perëndimore, respektivisht 3-4 orare në ditë. Ky lloj transporti shtrihet në një gjatësi 294.8 km linear.



Harta 3: Rrjeti rrugor i Bashkisë Gramsh

Burimi: Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Gramsh

3.1.6 Gjendja e Përgjithshme Mjedisore

Gramshi është një zonë që ka një pozitë të favorshme gjeografike dhe një klimë që është shumë e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë së tij, por këto favore dëmtohen nga karakteristikat e relievit, që përgjithësisht është e përthyer (kodrinoro-malor). Por këtë reliev të përthyer mund ta vlerësojmë për pasurinë e peizazheve që na ofron. Gjithashtu gjenden luginat e gjëra lumore deri tek kanionet, burime të shumta ujore e ujëvara, ujra të pijshëm e termale, kodra e deri tek malet më të larta të zonës të mbuluar pothuajse gjysëm viti me dëborë, zona të zhveshura, por edhe hektarë të tërë me pyje rrobulli, ahu e pishe. Të gjitha këto pasuri bëjnë që në të të krijohen lloje të ndryshme vendbanimesh, të cilat edhe këto formojnë një peizazh interesant kryesisht në zonat rurale. Këto pasuri përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë sidomos sektorit të tretë dhe më saktësisht të disa llojeve të turizmit si: turizmi i bardhë në Malin e Valamarës, turizmi kurativ duke shfrytëzuar burimet e liqenit të Zi, turizmi kulturor e fetar në Grabovën e Sipërme etj.

Problemet aktuale dhe e ardhmja, perspektiva e zhvillimit ekonomik të kësaj zone

Zhvillimi i Industrisë - Pas rënies së sistemit socialist dhe nga kalimi i ekonomisë nga ajosocialiste në ekonomi tregu, e dëmtoi rëndë ekonominë e këtij rrethi. Gjithashtu një sërë uzinash e fabrikash u ngritën në periudhën socialiste dukeu siguruar punë një numri të madh të popullsisë. Teknologjia e tyre ishte shumë e vjetër dhe nuk jepte rendiment. Në Bashkinë e Gramshit gjendet ish Uzina e prodhimit të baterive e cila është klasifikuar si një hotspot mjedisor dhe shtrihet në NjA Gramsh. Mbetjet industriale, edhe pse nuk janë kompetencë e bashkisë, institucionet vendore duhet të hyjnë në diskutime për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme, kryesisht në zonat ish industriale të Çekinit dhe Gramshit.

Lumi i Devollit e degët e tij kanë pësuar dëmtime të shumta brenda territorit të Bashkisë së Gramshit dhe jashtë saj, në 20 vitet e fundit. Nga vëzhgime të vazhdueshme në territorin e saj ka rezultuar se presionet kryesore të lumit janë mbetjet urbane, shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe ato nga industria, kryesisht të trashëguara nga ish-industritë. Problemet kryesor nga burimet ndotës shfaqen në segmentin pranë qytetit të Gramshit, ku derdhen ujërat e ndotur urban (pasi jo të gjitha janë të lidhura me impiantin e trajtimit të ujrave) të patrajtuar, gjithashtu në këtë segment të lumit bashkohen ujërat të cilët janë të ndotura nga shllami që shkarkohet nga vend-depozitimi i mbetjeve urbane në afërsi të Gramshit.

Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza Bashkia e Gramshit nuk është e mbuluar tërësisht me sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemi aktual shfaq problematika për shkak të tubacioneve të vjetëruara dhe në disa pjesë të bllokuara. Gjithashtu, ka humbje të mëdha në rrjet për shkak të lidhjeve të paligjshme e të parregjistruara. Ndonëse të gjitha njësive administrative iu ofrohet shërbimi i ujësjellësit, ende mbeten disa fshatra të cilët nuk mbulohen nga ky shërbim duke e siguruar këtë shërbim nëpërmjet puseve individuale, krojeve malore dhe burimeve. Një menaxhim më i mirë i ofrimit të shërbimit do të sigurojë ujë të pijshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh.

Nga analizimi i rrjetit të kanalizimeve në Bashkinë e Gramshit shihet që shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet në qytetin e Gramshit dhe pjesërisht në Kodovjat dhe Çekin nëpërmjet sistemit të kanalizimeve. Për sa i përket gjëndjes së këtij shërbimi, ky rrjet është relativisht i amortizuar dhe nuk përmbush me efikasitet funksionin bazë si pasojë e vjetërsisë së tij. Ky sistem është i kombinuar, mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, industriale dhe ato të shiut. Infrastruktura e kanalizimeve të ujrave të ndotura është relativisht problematike duke qënë se në të gjithë fshatrat e NjA-ve nuk ekziston asnjë sistem i organizuar inxhinierik i mbledhjes dhe largimit të ujërave të ndotura (pjesërisht Kodovjat dhe Çekin, por që nuk janë plotësisht funksional). Duke qënë se fshatrat përdorin gropa septike, jashtë kushteve higjieno-sanitare për largimin e ujërave të ndotura urbane nga shtëpitë dhe shpesh hasen raste ku ujrë të ndotura derdhen direkt në trupat ujorë sipërfaqësor, përrenj dhe lumenj.

Menaxhimi i mbetjeve Shërbimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve në bashkinë Gramsh duhet të shtrijë infrastrukturën e tij në të gjithë territorin dhe të nisë me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve që në pikat e grumbullimit. Vend-depozitimi aktual duhet t'i nënshtrohet rehabilitimit mjedisor të tij, dhe të mendohet për të gjetur një zgjidhje për vend depozitimin e ri të mbetjeve, i cili duhet të jetë në standartet e një landfilli sanitar të menaxhuar. Opsion kryesor mbetet kthimi i venddepozitimit aktual në stacion transferimi dhe depozitimi i mbetjeve në landfillin rajonal.

Aktualisht nuk ka të dhëna mbi sasinë dhe mënyrat e riciklimit të mbetjeve në territorin e bashkisë, riciklimi ndodh në mënyrë joformale, ndaj shikohet e arsyeshme që bashkë me hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve të formalizohet sektori i riciklimit.

Zonat me nivel të lartë ndotjeje, sidomos industriale, në Gramsh përbën një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këtë zonë duhet të jenë pjesë e skemës së re, që duhet të përvetësojë Bashkia e Gramsh për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Problematike mbetet menaxhimi i mbetjeve inerte dhe përcaktimi i një venddepozitim për mbetjet inerte dhe një për mbetjet elektronike, e me pas të mendohet për trajtimin e tyre.

Persa i perket mbetjeve spitalore, ato trajtohen brenda territorit tëspitalit në inceneratorin e tij sipas të gjitha kushteve higjenike të lejuara.

Riciklimi i mbetjeve nuk ka subjekte të licensuar dhe aktualisht bëhet në mënyrë informale nëpërmjet komunitetit rom/egjyptian.

3.2 Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve

3.2.1 Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) me agjencitë e tyre respektive.

MTM është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Mjedisor (IM) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM).

MIE ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat e zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i lëndfilleve dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane.

MSHMS harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore.

MBZHR është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore. Rregullorja nuk është hartuar ende.

MFE është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për taksat e ndryshme mjedisore. Deri tani janë paraqitur dy taksat e para mjedisore (taksa e gjelbër dhe taksa e ambalazhimit mbi pijet).

AKUKIM - është përgjegjëse për zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, derisa ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ndërmarrjet e menaxhimit të infrastrukturës së mbetjeve të jenë të afta për të kryer këto funksione.

3.2.2 Organizimi në nivel rajonal

Inspektorati Mjedisor është përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve, rregulloret teknike dhe teknologjitë.

Agjencia Rajonale e Mjedisit është autoriteti i specializuar për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal. Ka përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe jep, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhje edhe për *landfill*-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Inspektorati Sanitar Shtetëror ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai ka për detyrë të vendosë gjopa për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë.

3.2.3 Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: bazuar në ligjin nr. 139/2015, ligjin 8094/1996, dhe në ligjin nr. 9010/2003, NJQV-të janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia përcakton:

- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për menaxhimin e mbetjeve bashkiake në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë menaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret "tip" të miratuara nga ministritë respektive;
- iv. Harton planet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor për mbetjet, bashkitë kanë si detyrime samë poshtë:

- i. Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
- ii. Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
- iii. Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitim përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;
- iv. Të inspektojnë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- v. Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve;
- vi. Të bashkëpunojë me Inspektoratin Mjedor, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal.
- vii. Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

3.2.4 Struktura e Bashkisë për mbetjet

Diagrama më poshtë ilustron strukturën e bashkisë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke filluar nga përfaqësuesit në nivel Këshilli Bashkiak, Kryetar Bashkie, drejtuesit e shërbimeve dhe njësitë administrative.

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave bashkiake për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligjit 9537).

Policia e bashkiake: ushtron funksionin e saj bazuar në ligjin nr. 8224/1997, është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Brenda strukture së Bashkisë Gramsh operon **Agjencia e Shërbimeve Publike**, Sektori i mjedisit e cila ka në përbërje të saj 24 punonjës, nga të cilët vetëm 5 vetë janë të përfshirë në menaxhimin e mbetjeve, 1 drejtor, 1 supervisor i firmës kontraktore, 2 punonjës dhe 1 shofer. Kapacitetet njerëzore në nivel specialisti janë të limituara, të patrajnuara për ofrimin e një shërbimi sipas standardeve, për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes urbane nga mbetjet.




Figura 2. Organograma e Bashkisë Gramsh

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Bashkia Gramsh

3.2.5 Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet

Ligji i instrukton qeveritë vendore të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e menaxhimit të mbetjeve dhe objektin, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin. Kuadri rregullator lokal duhet të përfshijë:

- **Rregulloren bashkiake për menaxhimin e mbetjeve:**e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimit të mbetjeve brenda territorit administrativ të bashkisë, të hartojë procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitullin për aplikimin e sanksioneve. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak.Bashkia nuk ka një rregullore të tillë.
- **Rregulloren bashkiake për tarifat e mbetjeve:**ka për qëllim të krijojë një sistem efektiv për mbulimin e koston së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Rregullorja e tarifave të mbetjeve

përfaqëson një politikë bashkiake afatgjatë për mbulimin e kostos, nivelin e tarifave dhe sistemin e mbledhjes së tyre dhe vendos rregulla specifike për autoritetet lokale si dhe për komunitetin lokal dhe biznesin. Aktualisht Bashkia Gramsh nuk ka një rregullore për mbledhjen e tarifës së pastrimit.

3.3 Analiza e Mbetjeve

3.3.1 Shërbimet e mbetjeve


Shërbimet e mbetjeve përfshijnë të gjitha aktivitetet lokale që lidhen me ofrimin e shërbimit të pastrimit apo elementë të tjerë të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Gramsh. Ky seksion merr në konsideratë dhe përshkruan të gjithë shërbimet e pastrimit, infrastrukturën aktuale për kryerjen e shërbimeve nga sistemin aktual të kontenerëve deri në incenerator, zonën e shërbimit, volumet e punës dhe frekuencat e shërbimeve, rrymat e mbetjeve që administrojnë sot bashkia dhe konsumatorëve të cilëve u shërbehet. Në këtë seksion identifikohen dhe vlerësohen të gjitha problematikat aktuale të sistemit të menaxhimit të mbetjeve apo shërbimeve të veçanta, si dhe jepen arsyet apo faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë gjëndje.

Bashkia Gramsh ka planifikuar që sasia mesatare e mbetjeve të prodhuara që do të grumbullohen dhe transportohen gjatë vitit 2019 është rreth 17.2 ton/ditë, ose 6,200 t/vit pa përfshirë mbetjet nga ndërtimet.

Sot, Gramshi mbulon me shërbimin e mbetjeve jo më shumë se 50% të popullsisë, që është afërsisht 95% popullsia e qytetit dhe pjesërisht (rreth 25-30%) NJ.APishaj e NJ.AKodovjat (banesat përgjatë rrugës nacionale).

Në Gramsh shërbimi i pastrimit ofrohet nga kompania private "Kurora" Shpk (kontratë me shtrirje kohore korrik 2015-2020. Ndërsa NJA Pishaj dhe Kodovjat e realizojnë shërbimin e pastrimit përmes Agjensisë së Shërbimit Publik. Në njësitë e tjera administrative nuk ofrohet fare shërbimi i pastrimit.

Natyrisht që për pasojë do krijohen vende të paautorizuara ilegale për hedhjen e mbeturinave ose përgjatë anëve të lumenjve dhe prrenjve.



Harta 4: Mbulimi me shërbimin e pastrimit

Burimi: Drejtoria e shërbimeve Publike, Bashkia Gramsh

NJA	Popullsia sipas GJ.C	Popullsia sipas Census	Popullsia e Korrektuar	Norma e gjenerimit	Frekuenca dite ne jave	Gjenerimi (kg/ditë)	Gjenerimi kg/here	Gjenerimi (ton/muaj)
Gramsh	13,995.00	8,440.00	10,107.00	0.5	7	5,053.50	5,053.50	151,605.00
Pishaj	7,366.00	2,355.00	3,858.00	0.3	1	1,157.40	8,101.80	34,722.00
Kodovjat	2,800.00	2,560.00	2,632.00	0.3	1	789.60	5,527.20	23,688.00
Sult	847.00	659.00	715.00		0	-	-	-
Tunjë	2,106.00	779.00	1,177.00		0	-	-	-
Kushovë	855.00	4,906.00	3,691.00		0	-	-	-
Skëndërbegas	1,475.00	1,269.00	1,331.00		0	-	-	-
Lenie	1,447.00	1,239.00	1,301.00		0	-	-	-
Kukur	2,948.00	631.00	1,326.00		0	-	-	-
Poroçan	1,504.00	1,393.00	1,426.00		0	-	-	-
TOTAL	35,343.00	24,231.00	27,565.00			7,000.50	18,682.50	210,015.00

Tabela 6: Popullsia sipas NjA, dhe gjenerimi i mbetjeve Bashkia Gramsh

Burimi: Agjencia e shërbimeve Publike, Shtator 2019

3.3.2 Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane

Norma ditore e gjenerimit të mbetjeve është 0.5 kg/ditë/banorë në qytet dhe 0.3 kg/ditë/banorë. Për bizneset e vogla e të mëdha kjo normë gjenerimi është 10 kg/ditë, ndërsa për institucionet është 12 kg/ditë. Pjesa më e madhe e mbetjeve të prodhuara vjen nga familjarët, ndjekur nga bizneset e vogla, të mëdha dhe në sasi më të vogël nga institucionet. E shprehur në përqindje 72% e mbetjeve të prodhuara vijnë nga sektori familjar, 22% nga bizneset dhe rreth 6% nga institucionet.

NjA

	Familje që përfitojnë		% e mbulimit		Biznese që përfitojnë		% e mbulimit		Institucione që përfitojnë		% e mbulimit	
	v.'18	v.'19	v.'18	v.'19	v.'18	v.'19	v.'18	v.'19	v.'18	v.'19	v.'18	v.'19
Gramsh	4149	4156	95%	95%	402	385	100%	100%	16	16	100%	100%
Pishaj	660	659	95%	30%	30	30	86%	86%	1	1	100%	100%
Kodovjat	195	192	95%	20%	11	11	79%	86%	0	0	0%	0%
Sult	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%
Tunjë	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%
Kushovë	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%
Skëndërbegas	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%
Lenie	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%
Kukur	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%
Poroçan	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%	-	-	0%	0%

Tabela 7: Mbulimi me shërbimin e largimit të mbetjeve

Burimi: Agjencia e shërbimeve Publike, tetor 2019

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Gramsh kryhet pjesërisht nga kompania kontraktore Kurora sh.p.k dhe pjesërisht nga vetë bashkia (dshp).

Kompania kontraktore Kurora sh.p.k mbulon vetëm qytetin e Gramshit. Ajo grumbullon dhe transporton mbetjet çdo ditë, rreth 15.05 ton/ditë (referuar kapacitetit mbajtës të makinës teknologjike). Mbetjet pasi mblidhen transportohen deri në venddepozitim, i cili ndodhet në fshatin Mashan, Nj.A.Kodovjat, me një distancë prej 7km nga qendra e qytetit.

Personeli përkatës i subjektit “KURORA” shpk evadon çdo ditë, mbetjet urbane (plehrat e mbledhura në kazanë), duke i dërguar ato në fushën e depozitimit të përkohshëm të tyre.

Agjencia e Shërbimeve e bashkisë Gramsh kryen grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve në dy Njësi Administrative me një frekuencë dy herë në javë dhe kapacitet mbajtës 5 ton.

- Në Nj.A.Pishaj shërbimi ofrohet në fshatrat: Ceruje, Qerret, Cekin, Pishaj, Kocaj (lagjia sipër).
- Në Nj.A.Kodovjat shërbimi ofrohet në fshatrat: Kodovjat, Bersnik Poshtë dhe Mashan.

Në Nj.A të tjera ku nuk ofrohet shërbimi nga bashkia, menaxhimi i mbetjeve kryhet me sistemin e vet-groposjes në zonat e paracaktuara nga vetë banoret, të cilat mund të jenë përrenj, gropa të krijuara nga vetë banorët, rrëpira etj. Gjithsesi bashkia me stafin e saj e konsideron që në zonat rurale pjesa dërmuese e mbetjeve janë organike, ndaj duhet të shtyhet më tej nxitja e aktivitetit të kompostimit përkrah zgjerimit të zones së mbulimit me shërbimin e pastrimit.

3.3.3 Infrastruktura e ofrimit të shërbimit aktual

Kurora sh.p.k ka venë në dispozicion një makinë teknologjike me kapacitet mbajtës 15 ton, një kamionçinë me kapacitet 5 ton dhe një traktor për ngjeshjen e mbetjeve në vend-depozitim.

Kurora mbulon shërbimin e pastrimit me 14 punonjës nga të cilët 4 janë të dedikuar për menaxhimin e mbetjeve, 10 punonjës janë dedikuar në fshirje, pastrim dhe lagje rrugësh.

Ndërsabrenda strukturës së bashkisë Gramsh operon Agjencia e Shërbimeve Publike, e cila ka në përbërje 24 punonjës, nga të cilët vetëm 5 vetë janë të përfshirë në menaxhimin e mbetjeve, 1 drejtor, 1 supervisor i firmës kontraktore, 2 punonjës dhe 1 shofer.

Mjetet	Volumi	Sasia	Pronësia
Mjet teknologjik	15 ton	1	Kurora shpk
Traktor	-	1	Kurora shpk
Kamion i hapur	5 ton	1	Bashkia

Tabela 8: Mjetet dhe tonazhi

Burimi: Agjencia e Shërbimeve Publike

Në qytetin e Gramshit funksionojnë 56 pika grumbullimi, me 101 kontenier metalike me kapacitet 1.1 m^3 (Shih hartën 5). Gjithashtu përgjatë rrugës kryesore të qytetit dhe në parqet kryesore të qytetit janë vendosur 40 kosha metalike, të cilët zbrazen cdo ditë në mëngjes.


Për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Nj.A.Kodovjat dhe Nj.A.Pishaj mbetjet mblidhen dhe transportohen nga një kamionçinë e hapur 5 ton.

Në Nj.A.Pishaj funksionojnë 26 pika grumbullimi, me përbërje kontenierësh pjesërisht metalike dhe pjesërisht prej betoni. Ndërsa në Nj.A.Kodovjat funksionojnë 28 pika grumbullimi me kontenierë metalikë.

Në Bashkinë Gramsh shërbimi aktual i pastrimit, i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve është një shërbim i cunguar dhe jo i plotë në të gjithë territorin. Aktualisht nuk ka të dhëna zyrtare mbi mbetjet voluminoze që bashkia vetë ose përmes firmës kontraktuese largon nga territori i saj dhe shumica e mbetjeve inerte janë depozituar pranë brigjeve të lumenjve dhe pranë rrugëve automobilistike. Për këtë qëllim gjenerimi, mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve voluminoze duhet të adresohet si një çështje e rëndësishme për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë e Gramshit.



Harta 5: Shpërndarja e PGM NJA Gramsh
Burimi: Bashkia Gramsh



Harta 6: Shpërndarja e PGM NJA Kodovjat



Harta 7: Shpërndarja e PGM NJA Pishaj

3.3.4 Pastrimi i rrugëve

Nga 99,583 m² sipërfaqe rruge, trotuare dhe sheshe, fshihen dhe pastrohen me krah përcdoditë/muaj 272.63m². Fshirje dhe pastrim të plotë përfitojnë rrugët, sheshet dhe trotuaret e NjA Gramsh (99,583 m²), ndërsa NjA të tjera nuk e përfitojnë këtë shërbim. Procesi i fshirjes lidhet me aktivitetet e fshirjes me fshesë dhe grumbullimi i mbetjeve e transportimi i tyre me karrocë dore në vendgrumbullimin e tyre më të afërt. Për të përmbushur detyrimet, për kryerjen e këtyre shërbimeve janë 10 punonjës me kohë të plotë përgjatë gjithë vitit.

Orari i fshirjes së rrugës është (02:00-06:00), në total (4 orë/ditë). Tabela e mëposhtme pasqyron nëmënyrë më të detajuar sipërfaqet e pastrimit të shesheve, rrugëve dhe trotuareve.

NjA	Rrugë		Trotuare		Sheshe		TOTALI		% e ofrimit shërbi mit
	Gjithsej	Fshihen	Gjithsej	Fshihen	Gjithsej	Fshihen	Gjithsej	Fshihen	
	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	
Gramsh	66.730	53.315	34.305	30.937	10.916	4558	111.951	87.810	78.4%
Bashkia									

Tabela 9: Sipërfaqet që pastrohen Bashkia Gramsh
Burimi: Agjensia e Shërbimeve Publike



Harta 8: Gjurmët e pastrimit për rrugët dhe trotuaret
Burimi: Agjensia e Shërbimeve Publike

3.3.5 Lagia e rrugëve

Gjithashtu Bashkia Gramsh për periudhën Maj-Shtatortë çdo viti ofron çdo ditë shërbimin e lagies për rrugët e qytetit, ku sipërfaqja e përllogaritur është 172.60 m²/ditë. Procesi i larjes kryhet me një mjet autobot dhe për të përmbushur detyrimet, për kryerjen e këtyre shërbimeve janë dy punonjës (1 shofer, 1 punëtor) me kohë të pjesshme.

Orari i lagies së rrugës është (05:00-07:00), në total (2 orë/ditë).

3.3.6 Depozitimi

Para vitit 2016 vend depozitimi i mbetjeve të Gramshit gjendej 3 km nga qendra e qytetit në afërsi të brigjeve të lumit Devoll në pjesën lindore të territorit. Sot, ky vend depozitim është mbyllur sipas dispozitave ligjore dhe është ndertuar një vend-depozitimi i ri 7 km në jug-lindje të qytetit, në fshatin Mashan të Nj.A.Kodovjat. Kushtet e rrugës ku bëhet transporti janë përgjithësisht të mira, por ka ngarkesë pasi është rruga që lidh qytetin e Gramshit me Nj.A.Kodovat dhe Nj.A.Kukur dhe më tej me Korçën. Momentalisht situata është më e përmirësuar, por kjo zgjidhje është e përkohshme pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret për leje mjedisore.

Në vend-depozitim kryhen keto operacione si më poshtë:

- *Depozitim i mbetjeve*

Te gjitha mbetjet që mbledh Drejtoria e Shërbimeve Publike, kompania Kurora sh.p.k. si dhe nga subjekte të tjera private, të cilët i sjellin mbetjet në mënyrë të pavarur depozitohen në këtë vend-depozitim.


- *Sistemim*

Grumbullimi në një vend të caktuar i të gjitha mbetjeve të grumbulluara.

- *Ngjeshje*

Ngjeshja bëhet e mekanizuar me mjetin tip traktor me thikë, i cili kalon sipër mbetjeve duke realizuar ngjeshjen e tyre.

- *Mbulim i mbetjeve.*



Harta9: Vendepozitimi i mbetjeve.

Burimi: Sipas Kadastres Pyjore, 2016

- Mbulimi eshte procesi perfundimtar, i cili kryhet menjehere pas ngjeshjes. Per procesin e mbulimit perdoret material dheu, i cili merret po brenda vend-depozitimit.

Ky vend-depozitim eshte i percaktuar vetem per mbetjet urbane dhe eshte parashikuar per nje jetegjatei 10 vjet.



Figura 3: Foto e gjendjes aktuale te vend-depozitimit.
Burimi: Sektori i Mjedisit, Bashkia Gramsh 2019.

3.3.7 Riciklimi

Përvec territorit të kufizuar ku ofrohet shërbimi dhe depozitimi në një vend-depozitim të përkohshëm, bashkia nuk ka trashëguar ndonjë sistem tjetër operimi. Për shkak të terrenit kodrinor-malor dhe mungesës së mundësisë për mbulim, banorët lokal kanë gjetur zgjidhje individuale.

Një pjesë e mbetjeve të gjeneruara, kryesisht ato organike përdoren në kompostim, por jo në mënyrë teknologjike (proces pasiv).

Po ashtu ka një komunitet Egjiptian, në lagjet e jashtme të qytetit mbledhin kryesisht plastik dhe metal (Faja), ndërsa një person nga Elbasani shërben si mbledhës i mesëm për këto mbetje. Megjithatë nuk ka asnjë informacion në shifra në lidhje me këtë lloj aktiviteti.

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të përgjithshme të shërbimit aktual të mbetjeve, pastrimit të rrugëve dhe mjeteve teknologjike që përdoren.

Treguesit	NJA Gramsh	NJA Pishaj	NJA Kodovjat
Popullsia e sherbyer	10,107 banorë	3,858 banorë	2,632 banorë
Norma e gjenerimit	0.5 kg/banore	0.3 kg/banore	0.3 kg/banore
Mbetjet e gjeneruara	5.05 ton/dite	1.16 ton/dite	0.79 ton / dit
Numi i kontenjereve	58PGM (101 kontenier 1.1 m³)	24PGM (34 konteniere + pika betoni)	28 PGM (31 konteniere 1.1 m³)
Frekuenca	7 here ne jave	1 here ne jave	
Tipi i makinave	1 Makine teknologjike 15 ton	1 Kamion i hapur 5 ton	
	1 traktor per ngjeshjen e mbetjeve ne vend-depozitim.		

Menyra e trajtimit	Depozitim ne Mashan	
Siperfaqe qe fshihen	87,810 m ² /ditë	Nuk ofrohet
Siperfaqe qe lahen (maj – shtator)	172.60 m ² /ditë	Nuk ofrohet

Tabela 10. Tabelë përmbledhëse mbi shërbimin e mbetjeve Gramsh

Burimi: Bashkia Gramsh

3.4 Ekonomia dhe financimi

3.4.1 Buxheti vjetor dhe investimet

Çdo fillim viti, Bashkia në zbatim të funksioneve ligjore dhe administrative, përcakton dhe miraton buxhetin vjetor ku përfshihen edhe shpenzimet e parashikuara për pastrimin e qytetit. Në Buxhetin e Bashkisë Gramsh, shpenzimet buxhetore detajohen mbi bazën e Programeve ekonomike, ku "Programi Pastrim-Gjelbërim", mbulon shpenzimet për pastrimin e qytetit dhe gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e varrezave ze 4.5% të buxhetit total të Bashkisë. Nga të dhënat e Bashkisë, vetëm shpenzimet për pastrimin e qytetit, zënë 64.5%-66% të këtij programi.

Duke iu referuar këtyre të dhënave mbi buxhetet e realizuara të bashkisë dhe të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2019 për menaxhimin e mbetjeve, rezulton se buxheti për pastrimin përbën rreth 4.5 % të buxhetit total për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 kjo vlerë ka qenë po njësoj 4.5%.

Bashkia Gramsh	Viti 2018			Viti 2019		
	Buxheti total	Buxheti i Programit Pastrim-gjelberim	Buxheti për shërbimin e ofruar	Buxheti total	Buxheti i Programit Pastrim-gjelberim	Buxheti për shërbimin e ofruar
Vlera 000/lekë	472,197,000	21,265,000	13,727,797	467,863,000	21,000,000	13,915,170
Pesha specifike e treguesit mbi buxhetin total (në %)	100%	4.5%	2.9%	100%	4.5%	3%

Tabela 11. Mbi buxhetin vjetor të shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve

Burimi: Bashkia Gramsh, Buxheti i viti 2018-2019

Megjithatë, duke iu referuar të dhënave paraprake, rezulton se buxhetet e deritanishme për menaxhimin e mbetjeve, kanë qenë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit, apo përmbushjen e investimeve ne infrastrukturën e mbetjeve. Analiza e mëtejshme e skemës optimale dhe kostos së plotë të këtij shërbimi do të mundësojë një pamje më të qartë të nevojave dhe mundësisë së bashkisë për të realizuar qëllimet e veta.

Objektivat për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të përcaktuara nga Strategjia dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të mbetjeve vazhdojnë akoma të mbeten të pazbatueshme për shkak të mungesës të financimeve dhe kapaciteteve të nevojshme.

3.4.2 Ndarja e kostove

Buxheti i përgjithshëm i alokuar për vitin 2018 ne Programin e Shërbimeve publike, ishte në vlerën 22,864,360 lekë, dhe përkatësisht:

- a) 21,265,000 lekë për kompaninë e pastrimit "Kurora shpk" dhe
- b) 1,599,360 lekë për Agjencinë e Shërbimeve Publike.

Në vitin 2018 ky shërbim u realizua ne fakt ne vleren prej 20,099,360 Lekë.

Shpenzimet e Shërbimit të Menaxhimit të Mbeturinave përbëjnë 4% të shpenzimeve totale të Bashkise për 2018, e cila konsiderohet më pak se % në nivel kombëtar për të njëjtin shërbim.

Bashkia e Gramshit ka një Agjenci për Shërbime Publike dhe brenda saj ka 3 sektorë.

Spektori i Shërbimeve Publike ka:

- 1- Përgjegjes të sektorit dhe 24 punonjës.
- Spektori publik ka 3 persona menaxhimit të përgjithshëm dhe shërbimit të mbeturinave dhe 3 persona në NJA ku:
- 1- shofer dhe 2 punonjës.
- Kompania Kurora shpk është kontraktuar nga Bashkia Gramsh për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave në venddepozitimin e ri, me një numër prej 27 punonjësish.

Sipas të dhënave nga komuna, të ardhurat vjetore nga tarifa e pastrimit për vitin 2018 janë 8.295.000 lekë, ndërsa të ardhurat totale të planifikuara janë 9.642.700 lekë, kështu që niveli i mbledhjes është 86%.

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave kushton per Bashkine 20.099.360 leke.

- Nga Bashkia mbliidhet vlara prej 8.295.000 lekë nga tarifa e pastrimit.
- Në total, vetëm 41% e shërbimit mbulohen nga tarifa.

3.4.2 Tarifat dhe realizimi i të ardhurave

Tarifat e pastrimit për nivele të ndryshme të konsumatorëve, si familjet, bizneset dhe insitucionet, caktohen dhe propozohen nga bashkia dhe miratohen çdo vit nga Këshilli Bashkiak në paketën fiskale bashkë me taksat dhe tarifatat e tjera lokale. Nuk rezulton të jetë kryer ndonjë studim i mirëfilltë për nivelet e tarifave për secilin konsumator në funksion të gjenerimit të mbetjeve apo të shërbimeve që përfitojnë. Tarifa familjare e pastrimit është një shumë e caktuar vjetore për t'u paguar nga familjet pavarësisht madhësisë së tyre, por që klasifikohet/kufizohet nga NJA ku ofrohet shërbimi. Përjashtim ose diferencim nga kjo tarifë përcaktohet në paketën fiskale dhe ka të bëjnë me familjet me niveli i të ardhurave më të ulët, si familjet me kryefamiljarë persona me aftësi të kufizuar (PAK), paraplegjike, tetraplegjike, veterane etj..

Në tabelën e mëposhtme paraqiten nivelet e tarifave dhe të ardhurat e planifikuara për vitin 2019 e detajuar sipas ndarjes për tarifën familjare dhe subjektet publike/private.

Nr	Tarifa e shërbimeve publike sipas Paketës fiskale	Baza e tatueshme sipas paketës fiskale /numer	Tarifa miratuar ne paketen fiskale lek/vit	Vlera e planifikuar ne Buxhetin e Bashkisë lek/vit
1	2	3	4	5=3*4
1	Tarifa familjare:			
	Per cdo familje qytetare	2,249	1200	2,698,800
	Per familjet me pjesetare invalid pune/te verber, veteran lufte, para e tetraplegjike	333	200	66,600
	Per pensionistet e vetmuar ose cift	201	100	20,100
	Per cdo familje qe u ofrohet ky shërbim ne NJA Pishaj dhe Kodovjat	270	700	189,000
2	Tarife institucione shteterore			0
	OSHE	1	200000	200,000
	Ujesjells, Spitali, Albtelecom	3	100000	300,000
	Institucionet e tjera	12	15000	180,000
3	Tarife shoqata jofitimpruese	0		0
4	Tarife per bizneset sipas kategorive			0
	Biznes i vogel 0-5 mln leke	331	3500	1,158,500
	Biznes i vogel 5-8 mln leke	39	7000	273,000
	Biznes i vogel ne NJA	10	2500	25,000
	Per ambulantet ne NJA	8	750	6000
5	Subjekte juridike			0
	Subjekte ndertimi	4	70000	280,000
	Subjekte prodhimi + Bankat dhe institucione kredie	8	60000	480,000
	Subjekte tregtare	24	40000	960,000
	Subjekte riparimi e shërbimi	11	30000	330,000
	Devoll Hydropoëer	1	150000	150,000
	Per subjekte prodhimi+karburante NJA	3	10000	30000
	Per biznese VIP NJA	1	50000	50000
		3,509		7,397,000

Tabela 12. Niveli i tarifave dhe të ardhurat për vitin 2019
Burimi: Paketa fiskale dhe buxheti i vitit 2019

Sipas tabelës së mësipërme, bazuar në të ardhurat dhe nivelin e miratuar nga këshilli i bashkisë, konstatohet që bashkia ka planifikuar për pagimin e detyrimeve 3053 familje, duke përjashtuar nga pagesa e detyrimit të gjitha ato familje të NJA që nuk ju ofrohet ky shërbim dhe janë kategori të përjashtuara me VKB (si psh. Invalidët k/familjarë , paraplegjike, tetraplegjikë etj).

Nivelet e tarifave nga viti në vit nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme (nga 2018 në 2019 nuk kanë pësuar asnjë ndryshim). Në paketën fiskale 2019, tarifa për familjarët është në nivel të pandryshuar nga viti 2018 (1200 lekë/vit për zonat urbane dhe 700 lekë në vit për zonat rurale), kurse nga viti 2017 në 2018 tarifa e pastrimit ka pësuar një rritje prej 200 lekë për familje në qytet dhe në NJA. Vlera e parashikuar për të ardhurat nga tarifa familjare është 2,974,500 lekë në vit dhe zë 28.7% të të ardhurave të kësaj tarife.

Në përgjithësi politikat e NjQV janë drejtuar drejt niveleve të larta të tarifave për biznesin. Kriteri i parë për vendosjen e tyre është klasifikimi i aktivitetit (psh biznes i madh, apo i vogël), ndërsa kriteri i dytë që pritët të aplikohet për vitin 2020 është lloji i aktivitetit (ushqimore, restorant, rrobaqepësi, klub kafe, etj). Pasi jo të gjitha bizneset pavarësisht se janë një kategori përsa i përket xhiros, e kanë të njëjtë normën e gjenerimit të mbetjeve.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat e tre viteve të fundit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, të ardhurat vetëm nga tarifave dhe të ardhurat nga tarifa e pastrimit, të analizuara në nivelin e planifikimit, realizimit dhe ndryshimit të tyre nga viti në vit.

Nr	Emertimi të ardhurave sipas viteve	PLANIFIKIMI/ ne leke			REALIZIMI / ne leke		
		2016	2017	2018	2016	2017	2018
1	Të ardhura nga taksa & tarifa vendore gjithsejt	75,487,000	89,504,000	85,680,000	44,437,000	64,377,000	62,015,000
		0	0	0	0	0	0
	<u>Nga keto:</u>						
2	Të ardhura nga tarifa e pastrimit	7,300,000	7,260,000	8,000,000	6,163,000	6,217,000	6,211,000
1.1	Rritja e planifikimit të të ardhurave nga taksa&tarifa 2016-2017-2018		18.6%	-4.3%			
2.1	Rritja e planifikimit të tarifës së pastrimit 2016-2017-2018		-0.5%	10%			
1.2	Realizimi i planifikimit të të ardhurave nga taksa&tarifa 2016-2017-2018				59%	72%	72.4%
2.2	Realizmi i planifikimit të tarifës së pastrimit 2016-2017-2020				84.4%	85.6%	77.6%

Tabela 13. Planifikimi dhe realizmi i të ardhurave sipas viteve 2016-2017-2018
Burimi: Buxheti i Bashkisë 2018-2019

Duke ju referuar të dhënave për ecurinë së planifikimit të të ardhurave vendore në tre vitet paraardhës, dhe tarifës së pastrimit si pjesë e saj, mund të evidentojmë se:

- 1) Rritja e planifikimit të të ardhurave nga taksa&tarifa është realizuar nga viti 2016 në vitin 2017 në masën 18.6% për të pësuar një rënie në 2018 me -4.3% ,

- 2) Planifikimit i tarifës së pastrimit nga viti 2016 është ulur shumë pak me -0.5% në vitin 2017, për të pësuar një rritje përsëri në vitin 2018 me 10%.

Duke ju referuar të dhënave për ecurinë e realizimit të të ardhurave vendore në tre vitet paraardhës, dhe tarifës së pastrimit si pjesë e saj, mund të evidentojmë se:

- 1) Niveli i realizimit të të ardhurave nga taksa&tarifa në vitin 2017 është në masën 72%, dhe në vitin 2018 në masën 72.4%.
- 2) Niveli i realizimit të tarifës së pastrimit nga viti 2016 ka qenë 84.4%, dhe pas uljes së nivelit të planifikimit të tyre, janë realizuar 85.6% e tyre, dhe më pas në vitin 2018 pasi dhe planifikimi u rrit janë realizuar 77.6% e planifikimit.

Të gjitha tarifat si për familjet ashtu dhe për bizneset e qytetit të Gramshit, faturohen dhe mbledhen nga zyra e tatim taksave në bashki dhe në NJA. Pra janë autoritetet lokale, që nëpërmjet zyrës së taksave dhe tarifave mbledhin tarifat e qytetarëve pasi bashkia Gramsh nuk ka agent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Në vitin 2020 do kemi një ndryshim përse i përket mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore pasi ato që nga muaji janar 2020 do të kalojnë në faturën e ujit dhe do të mbledhen nëpërmjet Ujësjellësit Gramsh duke shpresuar në rritjen e nivelit të arkëtimeve për vitin që vjen.

Duke iu referuar performancës së deritanishme të mbulimit të kostos nga të ardhurat e mbledhura nga tarifat, rezulton se bashkia ka mbuluar në vitin 2018 vetëm 19.4% të kostos operative për menaxhimin e mbetjeve. Por, edhe pse plani i të ardhurave të vitit 2019 është rritur, realizimi i të ardhurave në masë më të lartë nuk është i garantuar. Si pasojë edhe mbulimi në një masë të lartë të kostos operative nuk është i garantuar, edhe pse sipas planifikimit të të ardhurave, mbulimi saj parashikohet të mbulohet në masën prej 30% të saj.

Bashkia Gramsh

Realizimi 2018 /lekë

Plani 2019/lekë

	Kosto operative e shërbimit	Të ardhurat e realizuara	% e mbulimit të kostos	Kosto operative e shërbimit	Të ardhurat e planifikuara	% e mbulimit të kostos
	13,727,797	6,211,000	45.2%	13,727,797	7,397,000	54%

Tabela 14. Mbulimi i kostos operative nga të ardhurat
Burimi: Dokumenti i buxhetit 2018-2019

Pamundësia ekonomike e një shtrese të gjerë të popullsisë së zonës për të paguar tarifat e pastrimit edhe pse ajo është më e ulëta në vend; ndërgjegjësimi i ulët për të paguar, mungesa e vullnetit për vendosjen e sanksioneve, bën të pamundur përballimin e kostos së këtij shërbimi nga tarifat.

Performanca e përgjithshme e bizneseve është e lartë përse i takon pagesës së tarifës së vendosur në lidhje me shërbimin e pastrimit dhe e ulët përse i përket familjarëve. Tarifa e mbledhur nga familjet është në masën 28-30% e planit ndërsa për bizneset është në masën pothuajse 100% realizim plani dhe pse bizneset në Bashkinë e Gramshit përballen me një sere sfidash dhe me një fuqi të ulët blerëse janë tepër të ndërgjegjësuar për detyrimet që kanë duke i likuiduar ato. Duhet të punohet më

shumë me familjet në mënyrë që të rriten arkëtimet nga kategoria e familjeve dhe pse administrate tatimore pranë Bashkisë Gramsh përballet cdo ditë me faktin që papunësia është shumë e lartë dhe një pjesë shumë e madhe e familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike.

3.5 Performanca aktuale e administrimit të mbetjeve vendore

Për të vlerësuar performancën aktuale të menaxhimit të mbetjeve, ekspertët dhe GP, ndërmorën një analizë të detajuar të sistemit por edhe perceptimin e publikut në lidhje me shërbimin e pastrimit. Analiza e sistemit është realizuar si në indikatorët e performancës ashtu edhe në identifikimin e avantazheve, dobësive, mundësive dhe rreziqeve që i gjithë sistemi apo elementët përbërës të tij shfaqin. Për këtë qëllim, analiza u bazua në të gjithë të dhënat e marra nga takimet, si dhe duke shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje të drejtpërdrejtë apo indirekte me menaxhimin e mbetjeve, në drejtim të aspekteve ligjore dhe administrative, cilësore dhe efektive, ekonomik dhe mjedisor që lidhet me veprimet apo mosveprimet e bashkisë, ashtu dhe me ndikimin e faktorëve të tjerë në këtë performancë të përgjithshme.

3.5.1 Analiza e indikatorëve të performancës

Bazuar në metodologjinë⁴ që në fillim të procesit u prezantuan indikatorët e përzgjedhur për monitorimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në nivel bashkie. Të dhënat e përfthuara do të ndihmojnë në krijimin e një pasqyre të qartë të realitetit por edhe në vendosjen e objektivave të qartë dhe plotësisht të matshëm për bashkinë për një periudhë të përcaktuar. Këto indikatorë që do të përshkruhen më poshtë do të maten dhe rishihen në baza një vjeçare dhe do të jenë shumë të rëndësishme edhe gjatë periudhës së raportimit pranë këshillit bashkiak. Gjithsej do të maten dhe monitorohen 8 indikatorë të ndarë në ato që lidhen me (i) cilësinë e shërbimit, (ii) indikatorë të qëndrueshmërisë mjedisore dhe (iii) indikatorë të qëndrueshmërisë ekonomike, financiare dhe institucionale. Jemi të vetëdijshëm se për disa nga indikatorët informacioni apo të dhënat e grumbulluara janë jo zyrtare apo të dhëna që nuk janë grumbulluar ndonjëherë ndaj duke qenë se mbledhen për herë të parë krahas vlerës përkatëse do të ketë dhe një kategorizim sipas saktësisë së informacionit në tre nivele e ulët, e mesme dhe e lartë.

Indikatorët e cilësisë së shërbimit

“Efikasiteti në mbledhjen e mbetjeve” shpreh sasinë e mbetjeve të mbledhura nga autoriteti i autorizuar për këtë shërbim përkundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në NJQV si për zonën urbane dhe për atë rurale. Besimi në këtë indikator varet shumë nga metodat e përdorura për grumbullimin e të dhënave. Duke qenë se nuk ka të dhëna të sakta në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe as të dhëna të sakta mbi sasia e mbetjeve të depozituara në vend depozitim mund të themi se besueshmëria e këtyre të dhënave është e ulët dhe mbështetur në hamëndësime. Megjithatë nga të dhënat e mbledhura shkalla e mbulimit të mbledhjes së mbetjeve është rreth 50% (90% në qytetin e Gramshit dhe 20-30% NJA Kodovjat dhe Pishaj). Në 7 NJA të tjera ky shërbim nuk i ofrohet fare për shkak të largësisë së madhe dhe infrastrukturës së keqe rrugore.

⁴ Metodologji e zhvilluar nga projekti dldp (per qeverisje dhe decentralizim vendor)

“Pastërtia e qytetit” shpreh efektivitetin e mbledhjes së mbetjeve dhe fshirjes së rrugëve. Vlerësohet në tre aspekte: në efektivitetin e mbledhjes së mbetjeve, të pastrimit të rrugëve dhe në atë të zonave rurale. Për sa i takon prezencës së mbetjeve përreth kontenerëve mund të themi që në qytetin e Gramshit (ku ka PGM) vihet re prezencë e moderuar e mbetjeve, ndërsa në rrugë ka prezencë të ulët të mbetjeve. Në zonat rurale ka prezencë të moderuar të mbetjeve dhe numër të vogël hot spotesh të krijuara. Në vlerësimin tonë ky indikator klasifikohet në kategorinë e mesme (50%) me saktësi të mesme pasi një pjesë e të dhënave vijnë dhe nga sondazhi i limituar i bërë përgjatë muajit shkurt 2019.

Indikatorët e Qëndrueshmërisë Mjedisore

“Ripërdorimi: shkalla e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonat urbane” përfaqëson shkallën e sasisë së mbetjeve të mbledhura zyrtarisht nga një cikël i mbyllur që nga pikat e grumbullimit në qendrën e trajtimit të mëtejshëm. Nuk ka të dhëna zyrtare, por ndërkohë ka iniciativa të komunitetit egjiptian për ndarje mbetjesh në burim (plastikë, qelq dhe metal). Por ky aktivitet nuk kalon vlerën 5%.

“Mbrotja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfill sanitar ose vend depozitime të aprovuara”. Të gjitha mbetjet e grumbulluara përgjatë këtyre viteve janë dërguar në venddepozitim në qytetit që edhe pse është ndërtuar së fundmi nuk ka parametrat e duhura për një landfill sanitar por edhe shkalla e vërtetësisë është e mesme pasi nuk ka rekorde zyrtare.

Indikatorët e Qëndrueshmërisë Institucionale

“Mbulimi i koston përmes tarifës” Krahason koston totale për shërbimin dhe financimin e tij përmes tarifës së vendosur dhe nivelit të mbledhjes së saj. Nëse i referohemi tabelës së mësipërme, të ardhurat vjetore të realizuara nga tarifa e pastrimit për 2018 janë 6,211,000 lekë, ndërsa kosto operative vjetore është 13,727,797 ALL, pra mbulimi i koston është 45.2%. Gjithsesi kjo kosto nuk është e plotë ndaj për vitin 2019 Bashkia ka llogaritur koston e shërbimit bazuar dhe mbi modelin e kosto tarifës.

“Kontributi i qytetarëve në financimin e shërbimit: niveli i mbledhjes së tarifës” reflekton kapacitetin/dëshirën e popullsisë për të paguar tarifën. Nëse i referohemi tabelës së mësipërme, të ardhurat vjetore të realizuara nga tarifa e pastrimit për 2018 janë 6,211,000 lekë, ndërsa totali i të ardhurave të planifikuara 7,397,000 leke, pra të adhurat realizohen në masën 84%.

“Transparenca e sistemit të faturimit” Vlerëson kapacitetin e bashkisë për t'i dhënë faturë klientit. Aktualisht bashkia ka një sistem faturimi për shërbimin e pastrimit, por klientët njihen me të kur vijnë në bashki për të kërkuar shërbim dhe nuk ka një informim aktiv të qytetarëve nga vetë bashkia. Ndaj mund të thuhet që transparenca ka qënë e ulët.

Vihet re se në Bashkinë Gramsh nuk ka një mekanizëm për të monitoruar performancën në drejtim të mbulimit, qëndrueshmërisë mjedisore dhe asaj financiare e institucionale, mbledhjes së tarifave. Nuk ka një database elektronik, por vetëm një regjistër elektronik të klientëve.

Indikatorët Viti 2018		Klasifikim i koduar me ngjyra			Saktësia e të dhënave
		I ulët	I mesëm	I lartë	
					E ulët Mesatare E lartë
Cilësia e shërbimit	C1 zona e mbulimit të shërbimit				
	C1.1 mbulimi i shërbimit në zonën urbane dhe peri-urbane	0 – 40 %	41 – 80%	81 – 100% 100%	E ulët
	C1.2 mbulimi i shërbimit në zonën rurale	0 – 30 %	31 – 50% 50%	51 – 100%	E ulët
	C2 pastërtia e qytetit	0 – 32 %	33 - 66% 50%	> 66%	E mesme
	C3 perceptimi publik: shkalla e kenaqshmërisë së publikut me shërbimin	0 – 50%	51 - 80%	81% - 100%	E mesme
Qëndrueshmëria mjedisore	D1 Ripërdorimi: shkalla e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonat urbane	0 – 5% 5%	5 – 20%	>20%	E ulët
	D2 Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfille sanitare ose vend depozitime të aprovuara	0 – 30%	31 – 70% 50%	71 – 100%	E ulët
Qëndrueshmëria Institucionale finan dhe ekonomike	E1 Mbulimi i kostos: tarifa mbulon koston.	0 – 35%	36 – 70% 45.2%	71 – 100%	E ulët
	E2 Si qytetarët kontribojnë në financimin e shërbimit: niveli i mbledhjes së tarifës	0 – 40%	41 – 75%	75 – 100% 84%	E lartë
	E3 Transparenca me sistemin e faturimit	E ulët	E mesme	E lartë	E ulët
Kosto e shërbimit		5,373 Lek/t (2555 ton/vit) 830.6 Lek / banorë / vit			

Tabela 15. Indikatorët e performancës, viti 2018

Burimi: GP Bashkia Gramsh

IV. PLANIFIKIMI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE URBANE

4.1 Vizioni

Vizioni i PVMMU të Bashkisë u formëzua si një proces i analizimit, diskutimit dhe konsultimeve me stafin e Bashkisë Gramsh të ngarkuar për hartimin e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve.

Pas analizës së metodologjisë aktuale të menaxhimit të mbetjeve, prioriteteve të bashkisë, realitetit, sfidave dhe dëshirës për një mjedis më të pastër, u ra dokort që vizioni i bashkisë të jetë:

Bashkia Gramsh synon të krijojë një sistem gjithëpërfshirës i menaxhimit të mbetjeve, i arritshëm nga çdo pjesëtar i komunitetit dhe i siguruar përmes një partneriteti të plotë midis të gjitha niveleve të qeverisjes dhe sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, ku banorët kanë ndjenjë të pronësisë dhe përgjegjshmërisë për mbetjet që ata krijojnë, duke reduktuar sa më shumë normën e gjenerimit të mbetjeve.

4.2 Objektivat

Për përmbushjen e vizionit të planit, u përcaktuan objektivat vendor për një periudhë 5 vjeçare(2020-2024), si më poshtë:

Infrastruktura dhe Mjedisi

- Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të Mbetjeve duke përdorur teknologji bashkëkohore deri në vitin 2022
- Përmirësimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve duke e shtrirë në 80% të territorit deri në vitin 2024;
- Deri ne 2023 venddepozitimi i Bashkisë rehabilitohet dhe kthehet në një pike transferimi funksional për mbetjet përpara se të depozitohen në landfillin rajonal;
- Përmirësimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në çdo lagje të qytetit, duke arritur frekuencën e mbledhjes së mbetjeve 7 herë në javë (çdo ditë), deri në vitin 2020;
- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim
- Kontribut në Planin e Zhvillimit Vendor lidhur me menaxhimin e mbetjeve
- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim;
- Ofrimi i shërbimit të ndarjes në burim të mbetjeve në një zonë pilot të qytetit brenda vitit 2021. Shtrirja e e skemës në dy rryma në lagje të tjera të qytetit, deri në mbulimin e plotë e tij;
- Reduktimi depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane dhe sidomos të mbetjeve voluminoze.
- Shtrirja e skemave të kompostimit edhe në njëstë e tjera administrative me karakter rural.

Ndërgjegjësimi i komunitetit

- Sensibilizimi i komunitetit dhe biznesit për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë

- Rritja e transparencës dhe e përgjegjshmërisë ndaj komunitetit të Gramshit
- Promovimi i ndarjes në dy rryma të mbetjeve urbane (të thata dhe të njoma) në lagjet kryesore të qytetit të Gramshit.

Forcimi Institucional

- Forcimi i kapaciteve të stafit për menaxhimin dhe monitorimin e mbetjeve
- Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve
- Forcimi i koordinimit ndër institucional rajonal për një menaxhim të integruar të mbetjeve
- Hartimi i rregulloreve për shërbime të caktuara të mbetjeve, duke përcaktuar standartet minimale që duhen plotësuar

Ekonomia dhe financat

- Forcimi i qëndrueshmërisë financiare duke rritur mbledhjen e tarifës së pastrimit gjatë periudhës 5 vjeçare në masën 90% nga familjet për të rritur të ardhurat në funksion të mbulimit të kostos së shërbimit
- Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve, duke konsoliduar mekanizimin e hartimit të buxhetit për shërbimet e mbetjeve dhe hartimin e marrëveshjeve dhe kontratave
- Rritja e nivelit të të ardhurave nga tarifat nga njësitë, të cilat marrin shërbim

4.3 Objekti i Planit

4.3.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Në bazë të legjislacionit ekzistues, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake për të cilën Bashkia e Gramshit është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse.

Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

Mbetje urbane (ushqim, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.),

Mbetje të veçanta bashkiake (mbetje inerte e ndërtimore, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;

Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës: (MF) mbetjet e prodhuara nga familjet; (MB) mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane. Ndërkohë,

⁵Siç përshkruhet në “Karakteristikat e Mbetjeve”

rryma të tjera mbetjes klasifikohen si mbetje masive, mbetje të ngurta (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen 'mbetje të veçanta' për të cilat njësia vendore duhet t'i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

4.3.2 Integrimi me aktet nënligjore dhe dokumentet e tjera strategjike vendore dhe rajonale, që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me mbetjet

Me qëllim efektivitetin dhe integrimi me planet, strategjitë, aktet nënligjore apo studimet të tjera në nivel rajonal dhe vendor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, ky plan vendor për menaxhimin e mbetjeve ka marrë parasysh përcaktimet e këtyre dokumentave, ndërkohë që përcakton objektivat, identifikon apo vlerëson mundësitë për realizimin e tyre:


- Plani i Përgjithshëm Vendor, i cili është në fazë miratimi.
- Plani i investimeve për ZM Elbasan përcakton në mënyrë të detajuar zgjidhjet teknologjike të nevojshme (impianetet ekzistuese, nevojat dhe specifikimet lokale, mundshmëria ekonomike dhe zhvillimet teknologjike).

4.3.3 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Për një organizim më të mirë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve që do të propozohet dhe eficiencës së këtij sistemi, territori i bashkisë Gramsh është ndarë me zona dhe nënzona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Identifikimi i këtyre zonave është bërë me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

- i. **Nën-zona e Parë:** karakterizohet si zona urbane e qendrës së Bashkisë, ku janë përqëndruar pjesa më e madhe e bizneseve, shkollave dhe institucioneve të tjera, si dhe zonë urbane me densitet të lartë. Në këtë zonë ndodhen pjesa më e madhe e pallateve/banesave. Në këtë zonë kemi rreth 91 kontenierë, por ata nuk janë në gjendje të mirë. Shpesh ka mbetje rreth tyre. Mbetjet depozitohen në Mashan 7 km larg qendrës së qytetit. Shërbimet e parashikuara në këtë zonë janë largimi i mbetjeve çdo ditë, fshirja e rrugëve të qytetit dhe shesheve (rreth 101,923m²) çdo ditë si dhe lagia e rrugëve (63,000 m²) një herë në ditë gjatë periudhës së verës.
- ii. **Nën-zona e Dytë:** përmbledh fshatrat si: Pishaj, Koçaj, Cekin, Qerret, Cerujë të Njesisë Administrative Pishaj, ku aktualisht ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve një herë në javë. Kjo zonë do zgjerohet edhe me shtatë fshatra të tjerë si: Trashovicë, Zgiup, Dushk, Drizë, Cingar, Kotorr dhe Gjergjovinë, brenda vitit 2020. Aktualisht ka 34 kontenierë, por numri i kontenierëve do të rritet si rezultat i zgjerimit të kësaj zone me shërbimin e pastrimit.

- iii. **Nën-zona e Tretë:** përmbledh fshatrat si: Kodovjat, Bërsnik dhe Mashan të Njesisë Administrative Kodovjat, ku aktualisht ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve një herë në javë. Kjo zonë do zgjerohet edhe me tre fshatra të tjerë si: Bulçar, Kokël dhe Bratilë brenda vitit 2020. Aktualisht ka 31 kontenierë, por numri i kontenierëve do të rritet si rezultat i zgjerimit të kësaj zone me shërbimin e pastrimit.



*Harta10: Zonat e mbetjeve.
Burimi: Bashkia Gramsh*

4.4 Skenarët e administrimit të mbetjeve

Skenarët në lidhje me menaxhimin e mbetjeve është mirë të përqëndrohen në mbledhjen e mbetjeve urbane dhe elementët e tjerë si ndarja e mbetjeve, riciklimi, kompostimi etj., të lidhen drejtpërdrejt me metodën e zgjedhur të mbledhjes së mbetjeve.

Shërbimet e pastrimit dhe alternativat e depozitimit të mbetjeve urbane, riciklimi, kompostimi dhe menaxhimi i mbetjeve voluminoze janë pjesë e sistemit dhe rrjedhojë e skemës së përzgjedhur nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve. Kështu duke marrë në konsideratë që sistemi në bashkinë Gramsh bazohet në një sistem me pika të përbashkëta, iniciativat për ndarjen e mbetjeve duhet të fokusohen në sistemin me dy kosha, të riciklueshme dhe të njoma.

SKENARI NR.1

Skenari i parë që propozojmë është skenari i menaxhimit të mbetjeve që zbatohet aktualisht në Bashkinë Gramsh. Sot, Gramshi mbulon me shërbimin e mbetjeve jo më shumë se 50% të popullsisë, që është afërsisht 95% popullsia e qytetit dhe pjesërisht NJ.A.Pishaj dhe Nj.A.Kodovjat rreth 25-30% (banesat përgjatë rrugës nacionale).

Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane

Norma ditore e gjenerimit të mbetjeve është 0.5 kg/ditë/banorë në qytet dhe 0.3 kg/ditë/banorë në fshat. Për bizneset e vogla e të mëdha kjo normë gjenerimi është 10 kg/ditë, ndërsa për institucionet është 12 kg/ditë. Pjesa më e madhe e mbetjeve të prodhuara vjen nga familjarët, ndjekur nga bizneset e vogla, të mëdha dhe në sasi më të vogël nga institucionet. E shprehur në përqindje 72% e mbetjeve të prodhuara vijnë nga sektori familjar, 22% nga bizneset dhe rreth 6% nga institucionet.

Shërbimi i pastrimit ofrohet nga kompania private "Kurora" Shpk (kontratë me shtrirje kohore korrik 2015-2020), ndërsa NJA Pishaj dhe Kodovjat shërbimi i pastrimit realizohet përmes Agjensisë së Shërbimit Publik. Në njësitë e tjera administrative nuk ofrohet shërbimi i pastrimit.

-Kompania kontraktore Kurora sh.p.k mbulon vetëm qytetin e Gramshit. Ajo grumbullon dhe transporton mbetjet çdo ditë, rreth 15 ton/ditë (referuar kapacitetit mbajtës të makinës teknologjike). Mbetjet pasi mblidhen transportohen deri në venddepozitimin, i cili ndodhet në fshatin Mashan, Nj.A.Kodovjat, me një distancë prej 7 km nga qendra e qytetit.

Personeli përkatës i subjektit "KURORA" shpk evadon çdo ditë mbetjet urbane në pikat e grumbullimit të mbetjeve, duke i dërguar ato në pikën e depozitimit. Pasi dërgohen në pikën e grumbullimit, mbetjet ngjishen dhe sistemohen.

-Agjensia e Shërbimeve e bashkisë Gramsh kryen grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve në dy Njësi Administrative me një frekuencë një herë në javë dhe kapacitet mbajtës 5 ton.

Në Nj.A.Pishaj shërbimi ofrohet në fshatrat: Ceruje, Qerret, Çekin, Pishaj, Kocaj (lagjia sipër).

Në Nj.A.Kodovjat shërbimi ofrohet në fshatrat: Kodovjat, Bersnik Poshte dhe Mashan.

Edhe këto mbetje pasi mblidhen dërgohen në pikën e grumbullimit, ku ngjishen dhe sistemohen.




Figura 4: Skema nr.1 e menaxhimit të mbetjeve
Burimi: Bashkia Gramsh

-Në Nj.A e tjera ku nuk ofrohet shërbimi nga bashkia, menaxhimi i mbetjeve kryhet me sistemin e vet-groposjes në zonat e paracaktuara nga vet banorët, të cilat mund të jenë përrenj, gropa të krijuara nga vetë banorët, rrëpira etj. Gjithsesi bashkia me stafin e saj e konsideron që në zonat rurale pjesa dërmuese e mbetjeve janë organike, ndaj duhet të shtyhet më tej nxitja e aktivitetit të kompostimit përkrah zgjerimit të zones së mbulimit me shërbimin e pastrimit.

Pastrimi i rrugëve

Nga 99,583 m² sipërfaqe rruge, trotuare dhe sheshe, fshihen dhe pastrohen me krah për cdo ditë/muaj 272.63m²/ditë. Fshirje dhe pastrim të plotë përfitojnë rrugët, sheshet dhe trotuaret e qytetit të Gramshit, ndërsa Nj.A. të tjera nuk e përfitojnë këtë shërbim. Procesi i fshirjes lidhet me aktivitetet e fshirjes me fshehtë dhe grumbullimi i mbetjeve e transportimi i tyre me karrocë dore në piken e grumbullimit të mbetjeve më të afërt. Për të përmbushur detyrimet, për kryerjen e këtyre shërbimeve janë 10 punonjes me kohë të plotë përgjatë gjithë vitit.

Lagia e rrugëve

Gjithashtu Bashkia Gramsh për periudhën maj-shtator të çdo viti ofron çdo ditë shërbimin e larjes për rrugët e qytetit, ku sipërfaqja e përlogaritur është 172.60 m²/ditë. Procesi i larjes kryhet me një mjet autobot dhe për të përmbushur detyrimet, për kryerjen e këtyre shërbimeve janë dy punonjës (1 shofer, 1 punëtor) me kohë të pjesshme.

Orari i larjes së rrugës është (05:00-07:00), në total (2 orë/ditë).

Infrastruktura e ofrimit të shërbimit aktual

Kurora sh.p.k ka vënë në dispozicion një makinë teknologjike me kapacitet mbajtës 15 ton, një kamionçinë me kapacitet 5 ton dhe një traktor për ngjeshjen e mbetjeve në vend-depozitim.

Ajo mbulon shërbimin e pastrimit me 14 punonjës nga të cilët 4 janë të dedikuar për menaxhimin e mbetjeve, 10 punonjës janë dedikuar fshirje, pastrim dhe lagje rrugësh.

Në qytetin e Gramshit funksionojnë 56 pika grumbullimi, me 101 kontenier metalike me kapacitet 1.1 m3. Gjithashtu përgjatë rrugës kryesore të qytetit dhe në parqet kryesore të qytetit janë vendosur 40 kosha metalike, të cilët zbrazen çdo ditë në mëngjes.

Për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Nj.A.Kodovjat dhe Nj.A.Pishaj mbetjet mblidhen dhe transportohen nga një kamionçinë e hapur 5 ton.

Në Nj.A.Pishaj funksionojnë 26 pika grumbullimi, me përbërje kontenierësh pjesërisht metalike dhe pjesërisht prej betoni. Ndërsa në Nj.A.Kodovjat funksionojnë 28 pika grumbullimi me kontenierë metalike.

Depozitimi

Në vend-depozitim kryhen këto operacione si më poshtë:

- *Depozitim i mbetjeve*

Të gjitha mbetjet që mbledh Drejtoria e Shërbimeve Publike, kompania Kurora sh.p.k. si dhe nga subjekte të tjera private, të cilët i sjellin mbetjet në mënyrë të pavarur depozitohen këtu.

- *Sistemim*

Grumbullimi në një vend të caktuar i të gjitha mbetjeve të grumbulluara.

- *Ngjeshje*

Ngjeshja bëhet e mekanizuar me mjetin tip traktor me thikë, i cili kalon sipër mbetjeve duke realizuar ngjeshjen e tyre.

- *Mbulim i mbetjeve.*

Mbulimi është procesi përfundimtar, i cili kryhet menjëherë pas ngjeshjes. Për procesin e mbulimit përdoret material dheu, i cili merret po brenda vend-depozitimit.

Ky vend-depozitim është i përcaktuar vetëm për mbetjet urbane dhe është parashikuar për një jetëgjatësi 10 vjet.

SKENARI NR.2

Skenari i dytë që propozojmë është vetmenaxhimi i mbetjeve nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e Bashkisë Gramsh.

Mbetjet nga banorët, mbetjet nga bizneset dhe mbetjet nga fshirja e rrugëve, do të mbledhen në pikat e grumbullimit të mbetjeve, të cilat më pas do të transportohen direkt në incenerator. Në periudhëafatgjatëështë parashikuar studimi dhe krijimi i një pike transferimi, ku mbetjet të grumbullohen për 2- 3 ditë aty, dhe më pas të dërgohen në incenerator. Kjo do na reduktonte kostot e transportit nga 7 herë në javë në 2-3 herë në javë, në varësi të mbetjeve të gjeneruara dhe madhësisë së kontenerëve të vendosura në pikën e transferimit. Njëkohësisht në pikën e transferimit do realizohet edhe ndarja e mbetjeve të riciklueshme, e cila do të kryhet nga kompani private. Do lidhen kontrata paraprakisht me kompani private që përpunojnë mbetjet e riciklueshme, ku kompaniteë do marrin persipër të mbledhin mbetjet e riciklueshme pa asnjë pagesë. Pjesa e mbetur e mbetjeve, pas ndarjes së mbetjeve të riciklueshme, do të shkojnë direkt në incenerator.

Mbetjet organike në zonat rurale do të kompostohen në mënyrë individuale nga banorët.

Gjithashtu, në këtë skenar është parashikuar identifikimi i një zone pilot në qytet, ku tëaplikohet ndarje në burim e mbetjeve urbane. Në shkollat e qytetit dhe rrugët kryesore të qytetit, do vendosen nga dy kontenerë në cdo pikë kontenerësh, një për mbetje të riciklueshme dhe një për mbetje të njoma ose të padiferencuara. Vendosija e kontenerëve dhe mbledhja e mbetjeve të riciklueshme do kryehet nga kompanitë që përpunojnë mbetje të riciklueshme, nëpërmjet marrveshjeve me Bashkinë Gramsh.




Figura 5: Skema nr.2 e menaxhimit të mbetjeve
Burimi: Bashkia Gramsh

Per zbatimin e këtij skenari është e nevojshme investimi në disa zëra:

Për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve për në vend-stacionim do të vihen në dispozicion:

1. Do të rehabilitohet vend-depozitimi aktual dhe do të kthehet në një pikë transferimi.
2. Dy mjete teknologjike me kapacitet njëra 5 ton do të kryejë shërbimin në NJA 2 herë në jave dhe tjetra me kapacitet 15 ton, e cila do të kryejë shërbimin në qytet çdo ditë.

3. Dy shoferë me kohë të plotë 8 orë në ditë.
4. Katër punëtorë shoqërues të mjeteve teknologjike, orët e punës do të jenë sipas përcaktimit të frekuencës së mbledhjes së mbetjeve.

Ky skenar ka tri pika kyce për menaxhimin e mbetjeve:

1. Vetmenaxhimi i mbetjeve nga Bashkia Gramsh

Qytetaret dhe bizneset i hedhin mbetjet në pikat e grumbullimit të mbetjeve. Cdo ditë të javës në qytet dhe një herë në javë në cdo fshat deri në 2020 dhe dy herë në javë në vitin 2021 dhe në vazhdim, dy shoferë dhe katër punëtorë shoqërues, mbledhin mbetjet në cdo pikë grumbullimi, nëpërmjet dy makinave teknologjike një 5 ton për Njesite Administrative dhe një 15 ton për qytetin e Gramshit. Pasi mbledhen fillimisht mbetjet do të dërgohen direkt në incenerator cdo ditë të javës duke filluar nga viti 2021, në vazhdim parashikohet të ndërtohet një pikë transferimi, ku mbetjet të qëndrojnë 2-3 ditë aty dhe më pas të transportohen me makina teknologjike në incenerator. Në pikën e transferimit do kryhet edhe ndarja e mbetjeve të ricikleshme, nëpërmjet kompanive private që merren me përpunimin e mbetjeve të riciklueshme. Pjesa e mbetur e mbetjeve do transferohet cdo 2-3 ditë në incenerator, në varësi të mbetjeve që do gjenerohen.

2. Zgjerimi i zonës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Në këtë skenar është planifikuar zgjerimi i zonës së shërbimit në zonën rurale në 9 fshatra të tjerë, 6 fshatra të Njesise Administrative Pishaj dhe 3 fshatra të Njesisë Administrative Kodovjat, duke e cuar mbulimin e zonës së asfaltuar të gjithë territorit të bashkisë Gramsh me këtë shërbim në 100%.

3. Reduktimi i mbetjeve

Reduktimi i mbetjeve do kryhet nëpërmjet tri mënyrave:

- a) Ndarja e mbetjeve të riciklueshme në pikën e transferimit nëpërmjet kompanive private që merren me përpunimin e mbetjeve të riciklueshme. Do lidhen kontrata paraprakisht me kompani private që përpunojnë mbetjet e riciklueshme, ku kompanitë do marrin përsipër të mbledhin mbetjet e riciklueshme pa pagesë, duke reduktuar në këtë mënyrë sasinë e mbetjeve që bashkia do duhet të dërgojë në incenerator.
- b) Kompostimi i mbetjeve organike në zonat rurale nëpërmjet kompostimit individual. Duke qënë zona rurale, pjesa më dominuese e mbetjeve që ato gjenerojnë janë mbetje organike. Për këtë kompostimi i mbetjeve organike është shumë i nevojshëm pasi ul në masën 50% gjenerimin e mbetjeve, duke ulur ndjeshëm koston e shërbimit për menaxhimin e mbetjeve. Kompostimi do kryhet në mënyrë individuale nga banorët e zonave rurale. Bashkia do organizojë disa aktivitete ndërgjegjësuese në zonat rurale dhe t'i demonstrojë mënyrat e kompostimit, të cilat banorët mund të përdorin për mbetjet organike. Do organizohen dy aktivitete ndërgjegjësuese në cdo fshat ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve.

- c) Ndarja në burim e mbetjeve në një zonë pilot në qytet. Do zgjedhim një nga lagjet më të vjetra të qytetit, atë lagje që mendojmë se mund ta pranojë më shpejt ndryshimin dhe është më e ndërgjegjësuar në raport me çështjet mjedisore dhe do zbatojmë ndarjen në burim të mbetjeve. Fillimisht duhet të vëmë në dispozicion kontenier mbetjesh të dedikuara për mbetjet e njoma dhe të riciklueshme. Vendosija e kontenierëve dhe largimi i mbetjeve të riciklueshme, do realizohet në bashkëpunim me kompanitë që përpunojnë mbetje të riciklueshme. Nëpërmjet marrveshjeve që do nënshkruhen midis bashkisë Gramsh dhe këtyre kompanive, do rregullohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë. Mbetjet e riciklueshme do duhet të menaxhohen nga vet këto kompani. Gjithashtu përfaqësues të bashkisë do kryejnë fushata sensibilizuese në lagje të qytetit dhe nëpër shkolla, për t'i shpjeguar ndarjen në burim të mbetjeve, rëndësinë e saj dhe ndikimin që ka në mbrojtjen e mjedisit.

Për fshirjen e rrugëve dhe trotuarëve do të vihen në dispozicion:

1. Katërmbedhjetë punëtor me proces fshirje natën dhe ditën me kohë të plotë
2. Punëtorëve do t'u vihen në dispozicion materiale pune fshesa, karroca, lopata, krëhër, dorashka, kosha plastik lëvizës, veshmbathje.

Në procesin e fshirjes do të përfshihet sipërfaqja prej 24,141 m², duke e cuar sipërfaqen e mbulimit me këtë shërbim në 100% për qytetin.

Për lagjen e rrugëve shesheve dhe trotuarëve do të vihen në dispozicion:

1. Një punonjës shofer me kohë të plotë për periudhën maj-shtator të çdo viti.
2. Autobot me vetmbushje për lagjen e rrugëve.

Në procesin e lagies do të përfshihet sipërfaqja prej 87,110m².

Vend-stacionimi ka për vendodhje fshatin Mashan të Njësisë Administrative Kodovjat me një distancë 7 km larg qendrës së qytetit 50 km larg nga Landfilli Elbasan.

Të dy skenarët e propozuar janë të arritshëm dhe të realizueshëm, në kushtet në të cilat ndodhet Bashkia Gramsh. Duke analizuar efikasitetin dhe efektivitetin e çdo skenari, si edhe për të qenë në një linjë me objektivat e vendosura nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit, bashkia do duhet të marrë në konsideratë dhe të zbatojë skenarin numër 2.

Pavarësisht se vitin e parë skenari numër 2 është i ngarkuar financiarisht për shkak të blerjes së dy makinerive, rehabilitimit të pikës së grumbullimit, duke e kthyer atë në pikë transferimi dhe zgjerimit të zonës së shërbimit me nëntë fshatra të rinj, nëse e shohim në periudhë afatgjatë, kostoja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve është më e ulët se kostoja që paguajme aktualisht për këtë shërbim.

Për më tepër, Bashkia Gramsh nuk mund të vazhdojë të mbajë më mbetjet në pikën e grumbullimit në fshatin Mashan, mbetjet sipas udhezimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do duhet të dërgohen në incenerator.

Bashkia Gramsh aktualisht i ka të gjitha kapacitetet e nevojshme për ta kryer vetë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, për këtë dhe arsyet e përmendura më sipër, sygjerojmë skenarin numër dy si skenarin më të përshtatshëm për Bashkinë Gramsh.

4.4.1 Menaxhimi i mbetjeve bazuar ne objektivat ndërkombëtar, kombëtare dhe rajonale

Neni 4 i Direktivës Kuadër të BE-së për Mbetjet, i rishikuar (WFD (Direktiva 2008/98/EC), përcakton pesë hapa për trajtimin e mbetjeve në bazë të prioriteteve. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve është një udhëzues i pranuar kombëtar dhe ndërkombëtar, për t'i dhënë prioritet praktikave të menaxhimit të mbetjeve, me qëllim arritjen e rezultateve optimale mjedisore. Kjo hierarki përcakton rendin e preferuar të praktikave për menaxhimin e mbetjeve, nga më të preferuarat tek ato më pak të preferuara.

Shmangia e gjenerimit të mbetjeve në Bashkinë Gramsh është akoma në një fazë shumë të hershme. Megjithatë, në nivel shkollash, nxënësit mund të edukohen për përdorimin e kujdesshëm të produkteve (cantat prej beze, shishe personale uji). Rezultatet e kësaj politike do të jenë të vështira për t'u matur, por mund të vëzhgohen.

Të qënurit një bashki e varfër nga ana ekonomike, **ripërdorimi** i materialeve është shumë i rëndësishëm. Promovimi i ripërdorimit të materialeve është shumë i arritshëm dhe nis me ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Materiali i **riciklueshëm** nuk është në sasi shumë të madhe, pasi shumica e mbetjeve janë organike për vetë faktin se zona ka në përgjithësi karakter rural. Megjithatë, riciklimi është i mundshëm në dy drejtime kryesore:

- 1. Kompostimi** - Të gjithë qytetarët dhe bizneset në fshat do të inkurajohen dhe do të edukohen të shmangin plotësisht mbetjet organike nga sistemi i menaxhimit. Një politikë e tillë pritet të reduktojë maksimalisht, me rreth 50%, sasinë e mbetjeve urbane në nivel lokal.
- 2. Zbatimi i një sistemi për ndarjen e mbetjeve dhe rikuperimi** - Një sistem i grumbullimit të mbetjes së thatë në disa lagje të qytetit, së bashku me mbetjet e grumbulluara në zona/ shkolla pilot të qytetit do të krijojë mundësinë e grumbullimit të sa më shumë mbetjeje të thatë, e cila do ti jepet kolektorëve dhe ato më pas ua shesin kompanive të riciklimit. Shkollat e qytetit mund të kenë skemë pilote me dy kosha, për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku në njërin kosh do të hidhet mbetja e thatë dhe në koshin tjetër mbetja organike.

Mbetjet për **energji** janë mundësia e parashikuar dhe investuar për bashkinë, pasi e gjithë zona e Elbasanit bazuar dhe në master plan operon me incinerator dhe landfill.

Depozitimi i mbetjeve mendohet se pas 2 viteve venddepozitimi ekzistues do të mbyllet, rehabilitohet për të zvogëluar mundësinë e pasojave jo të këndshme mjedisore dhe shëndetësore dhe do kryhen studime fizibiliteti për caktimin e një pike transferimi ose stacionimi midis Gramshit dhe Elbasanit.

- **Të dhëna mbi popullsinë dhe bizneset**

Për parashikimin e numrit të popullsisë për vitet 2019-2024 u konsiderua:

- Popullsia sipas RrC dhe popullsia sipas Census 2011, por e korrigjuar me të njëjtën metodë që llogaritet popullsia për çdo bashki për efekt të përfitimit të transfertës së pakushtëzuar nga qeverisja qendrore.
- Duke qenë se emigrimi (si brenda qyteteve të tjera dhe jashtë Shqipërisë) ka pësuar rritje të qëndrueshme dhe nga ana tjetër rritja natyrale e popullsisë është në po të njëjtat nivele ne do të konsiderojmë si popullsi për zonën popullsinë e korrigjuar si më lart.
- Bizneset dhe Institucionet për periudhën 2019-2024, do të konsiderohen ato që janë regjistruar në vitin 2019

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin total të banorëve, bizneseve dhe institucioneve për periudhën 2019-2024:

Nr	Popullsia	V.2019			Planifikimi 2020-2024
		Popullsia e korrigjuar	Biznese & Instituc.	Total	Popullsia
		Nr	Nr	Nr	Nr
I	Totali	14.545	451	14.996	16.252
1	Gramsh	10,481	401	10882	10,481
2	NJA Pishaj	2,656	36	2692	3,682
3	NJA Kodovjat	1,408	14	1422	2,089

Tabela 16. Numri banorëve, bizneseve dhe institucioneve për periudhën 2019-2024

i. Gjenerimi i mbetjeve nga çdo zonë mbetjesh

Sipas analizës së kostove duke marrë për bazë numrin e popullsisë së korrigjuar të vitit 2019 dhe numrin e bizneseve, dhe një normë gjenerimi 0.5kg/banorë/ditë në zonën urbane dhe 0.4 kg/banorë/ditë në zonën rurale. Rezulton një total i mbetjeve të gjeneruara prej 6.87 ton/ditë apo 2507 ton/vit.

Referuar shpërndarjes së bizneseve dhe institucioneve sipas çdo njësie administrative dhe gjenerimit ditor të mbetjeve nga çdo konsumator, rezulton që gjenerimi i mbetjeve ditor, në herë mbledhje dhe ai vjetor në çdo zonë mbetjesh të jetë si më poshtë në 2019 dhe 2021 mbasi ndryshon frekuenca e mbledhjes në zonat 2 dhe 3:

Nr	Emertimi Zones	Popullsia e korrektuar	Frekuenca dite ne jave	Gjenerimi (kg/dit)	Gjenerimi (ton/dit)	Gjenerimi ton/here	Mbetje ton/vit
1	Zona 1	10,481	7	5955.00	5.24	5.24	1912.75
2	Zona 2	2,656	1	1207.20	1.06	7.44	387.75
3	Zona 3	1,408	1	640.00	0.56	3.94	205.57
	Totali	14,545	1	7802.20	6.87	16.62	2506.07

Tabela 17. Konsumatorët dhe gjenerimi i mbetjeve në bazë vjetore 2019

Nr	Emertimi Zones	Popullsia e korrektuar	Frekuenca dite ne jave	Gjenerimi (kg/dit)	Gjenerimi (ton/dit)	Gjenerimi ton/here	Mbetje ton/vit
1	Zona 1	10,481	7	5955.00	5.24	5.24	1912.75
2	Zona 2	3,682	2	1673.60	1.47	5.15	537.56
3	Zona 3	2,089	2	949.60	0.84	2.92	305.01
	Totali	16,252		5955.00	5.24	5.24	1912.75

Tabela 18. Konsumatorët dhe gjenerimi i mbetjeve në bazë vjetore 2021

Ndërsa sasia e mbetjeve të planifikuara për t'u grumbulluar për vitet 2019-2024, bazuar në normat e mësipërme të gjenerimit, për çdo zonë mbetjesh është si më poshtë:

Nr	Emertimi Zones	Mbetje 2019	Mbetje 2020	Mbetje 2021	Mbetje 2022	Mbetje 2023	Mbetje 2024
1	Zona 1	1912.75	1912.75	1912.75	1912.75	1912.75	1912.75
2	Zona 2	387.75	387.75	537.56	537.56	537.56	537.56
3	Zona 3	205.57	205.57	305.01	305.01	305.01	305.01
	Totali	2506.07	2506.07	2755.32	2755.32	2755.32	2755.32

Tabela 19. Mbledhja e mbetjeve për vitet 2019-2024

Pjesa më e madhe e mbetjeve gjenerohen nga Zona 1 që i përket dhe qytetit të Gramshit dhe që përben 76% (të mbledhjes në vitin 2019) e 69% (në vitin 2024).

ii. Llogaritja e numrit të nevojshëm të kontenierëve

Llogaritja e kontenierëve të domosdoshëm për grumbullimin e mbetjeve është në funksion të tre faktorëve të domosdoshëm që janë gjenerimi i mbetjeve nga familjet, biznesi dhe institucionet, frekuenca e mbledhjes së tyre dhe kapaciteti i kontenierit. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh “të mëdha” duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.

Një kontenier tipik ka një vëllim 1.1m^3 , i cili ka një kapacitet maksimal mbajtës prej rreth 0,1 ton mbetjesh të ngurta, në qoftë se konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej 0.11 ton/m^3 për mbetjet. Kjo dendësi është matur në disa njësi vendore gjatë një fushate peshimi, por që është subjekt i ndryshimeve sipas përbërjes së mbetjeve.

Tabelat e mëposhtme përmbledhin nevojat aktuale për kontenierë (1.1 m^3) në vitin 2019, në zbatim të skemës së përbashkët të grumbullimit mikës të mbetjeve:

zona	Mbetje ton/vit	mbetje (ton/dit)	Frekuenca dite/jave	Gjenerimi ton/here	Dendësia e mbetjeve ton/m ³	Koef. mbushjes	Nevoja Kazane kontenier			
							2019	2020-2021	2022	2023-2024
Zona 1	1912.75	5.24	7	5.24	0.15	0.85	93	103	120	120
Zona 2	537.56	1.47	2	5.15	0.05	0.85	34	64	80	80
Zona 3	305.01	0.84	2	2.92	0.05	0.85	31	51	60	60
Totali	2755.32	7.55		13.32			158	218	260	260

Tabela20. Llogaritja e numrit të kontenierëve për vitet 2019-2023

Pra, për mbledhjen mikës të mbetjeve sipas frekuencave të propozuara, bashkia ka shpërndarë në vitin 2019 në territorin e saj 158 kontenierë aq sa është dhe numri aktual i tyre. Ndërkohë bashkia ka buxhetuar shumën prej 2,500,000 lekë për blerjen e 60 kontenierëve të rinj në vitin 2020.

Për vitet e tjera, bashkia duhet të shtojë numrin e kontenierëve në funksion të rritjes së gjenerimit të mbetjeve dhe shtrirjes së shërbimit si dhe amortizimit të kontenierëve aktual. Pra, sipas tabelës së mësipërme numri i kontenierëve në vitin 2024 do të jetë 260 kontenierë ose 102 kontenierë më shumë se në vitin 2019.

Duke patur parasysh edhe amortizimin sidomos të kontenierëve ekzistues gjatë vitit, ky numër patjetër që duhet të jetë më i madh.

iii. Makinat për grumbullimin e mbetjeve

Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë zakonisht vetëngjeshës me kapacitet 5 ton mjeti që disponon bashkia dhe 16 ton kamioni që përdor firma aktualisht kontraktuese. Këta kamionë sugjerohen për t'u përdorur në varësi të tipit dhe popullsinë së njësisë.

Normalisht një zonë rurale përdor kamionë me kapacitet 5 ton, ndërsa një zonë urbane kamionë me kapacitet 16 ton. Numri i kamionëve varion bazuar në sasinë e mbetjeve për t'u mbledhur dhe numrin e turneve të nevojshme për çdo kamion. Kapaciteti aktual i ngarkimit për një përbërje tipike mbetjesh është rreth 85% të kapacitetit total mbajtës të kamionit.

Bashkia Gramsh për specifikën e zonës përdor kamion 5 ton për Zonën 2 dhe Zonën 3 dhe e kryen vet shërbimin kurse në zonën 1 firma kontraktuale aktuale përdor kamion 16 ton. Në funksion të variablave të mësipërm, pra të sasisë ditore të mbetjeve të gjeneruara, distancave dhe shtrirjes në vite si dhe kapacitetit mbushës bashkisë i nevojiten rreth 2 kamionë ndaj në vitin 2020 parashikohet të blihet një kamion 15 ton pasi në vitin 2020 në momentin që kontraktuesi mbaron kontratën me Bashkinë Gramsh dhe shërbimi i pastrimit do të ofrohet nga vetë bashkia duke u krijuar një agjensi për këtë shërbim.

Në vitin 2021 parashikohet që mbetjet e grumbulluara të dërgohen çdo ditë në incenerator ndaj dhe kamioni që do të blihet është me kapacitet 15 ton në mënyrë që minimizohen pak kostot e transportit pasi distanca deri në incenerator vajtje-ardhje llogaritet tek 100 km .

Deri në fund të vitit 2021 dy makinat teknologjike 5 ton dhe 15 ton janë të mjaftueshme për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në incineratorin e Elbasanit.

- Intenerari i grumbullimit të mbetjeve dhe transporti i tyre

Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të grumbullimit dhe transportimit lidhen drejtpërsëdrejti me intinerarin e përzgjedhur të lëvizjes së makinës si dhe me kohën efektive të punës gjatë ndalesave në çdo PGM.

Ulja e kohës së përgjithshme të mbledhjes, më saktë – kohës së ngarkimit, shmangies së rrugëve me gjysmë ngarkesë apo përdorimi i kamionëve të mirë me kapacitet më të mirë ngarkimi do të rrisin efektivitetin dhe efikasitetin e mbledhjes së mbetjeve⁶.

Për të përmirësuar kohën e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, duhet të merren në shqyrtim itinerarët aktualë në zbatim të parimeve të listuara më poshtë:

⁶ Koha e grumbullimit të mbetjeve për një pikë me 2 kontenierë të shkojë nga 2.5-3 min.

- Itinerarët nuk duhet të copëtohen apo të mbivendosen. Secili itinerar duhet të jetë kompakt, i përbërë nga segmentet e mbledhura në të njëjtën zonë gjeografike;
- Itinerari i mbledhjes duhet të nisë sa më pranë autoparkut që të jetë e mundur, duke marrë parasysh rrugët me trafik të madh dhe ato me një kalim;
- Në rastin e rrugëve me një kalim, është më mirë të fillohet itinerari në fundin e sipërm të rrugës, duke kaluar poshtë saj në kahun e rregullt;
- Shërbimet në rrugët pa krye mund të konsiderohen si shërbime për segmente rruge që mund të ndërpriten, përderisa ato mund të mblidhen vetëm duke kaluar poshtë segmentit të rrugës. Për të mbajtur kthesat djathtas në minimum, (në vendet ku automjetet lëvizin në krahun e majtë), mbledhja e mbetjeve nga rrugët pa krye bëhet kur ato janë në të majtë të kamionit. Këto mbetje duhet të mblidhen duke ecur për poshtë, mbrapsht apo duke bërë një kthesë në formë U;
- Mbetjet në kodra të pjerrëta duhet të mblidhen, aty ku është praktike, në të dy krahët e rrugës kur kamioni po zbret për poshtë. Kjo lehtëson mbledhje të sigurt, të lehtë dhe të shpejtë. Kjo ul edhe amortizimin e automjetit si dhe kursen karburant.
- Për mbledhjen nga të dy krahët e rrugës në të njëjtën kohë, në përgjithësi është më mirë të bëhet itinerari në rrugë të drejtë sipas planit para se të kalohet në itinerarin në krahun e kundërt.

Pas verifikimit të plotësimit të parimeve të mësipërme, është e rëndësishme të bëhet matja/ testimi i kohës reale të grumbullimit të mbetjeve.

4.4.2 Buxhetimi në bazë aktiviteti

Metodologjia e përdorur është buxhetimi në bazë të programit, mbështetur në ligjin 9936/2008 “Për menaxhimin financiar në RSH” dhe në ligjin organik 139/2015: “Për vetëqeverisjen vendore” ku sipas nenit 23 (pika 10) *Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve përfshihet në programin e shërbimeve publike.*

Llogaritja e koston për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në Bashkinë e Tepelenës, është bazuar në **VKM 319/2018** për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe modelin e përgatitur nga dldp.

Përlllogaritja është bazuar në blloqet vijuese:

- Të dhënat përmbledhëse për zonën administrative,
 - Investime kapitale (kamionë dhe kontenierët e nevojshëm),
 - Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel),
 - Kostoja për largimin në “Incinerator” është zero në momentin aktual,
 - Kostot e amortizimit (ri investimit),
 - Kostot administrative
- A. Fshirja dhe larja e rrugëve

Bashkia synon përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar si dhe rritjen e zonës të mbuluar me shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shesheve, duke përfshirë gjithë zonën urbane.

Aktualisht, mbulohet me shërbim fshirje sipërfaqja prej 101.923 m² /muaj rrugë, trotuare dhe sheshe. Gjithashtu lagen çdo ditë gjatë periudhës së maj-shtator 63.000 m² / muaj sipërfaqe.

Sipas objektivave të programit buxhetor afatmesëm, Bashkia Gramsh do të krijojë një infrastrukturë me bashkëkohore, pra do të rritë sipërfaqet e rrugëve të asfaltuara, duke tentuar drejt përmirësimit të standartit të rrjetit rrugor të qytetit.

Metodologjia e pastrimit të rrugëve është jo shumë efikase (nuk përdoren makina fshesë) dhe kjo metodologji do të përdoret dhe për 5 vitet e ardhshme, pra do të vazhdohet të fshihet me punëtorë (në mënyrë manuale).

Politikat, objektivat dhe kostot e shërbimit

Politikat 2019-2024

i. Shërbimi i fshirjes së sipërfaqeve

- Bashkia do të përfshijë në shërbimin e fshirjes, të gjithë rrugët e trotuaret e qytetit të Gramshit të cilat aktualisht e përfitojnë këtë shërbim duke shtuar dhe sipërfaqe të reja në vitin 2021.
- Do të vazhdojë fshirja e të njëjtës sipërfaqe në Gramsh dhe do të përfshihen në shërbimin e pastrimit sipërfaqet e reja të që do të rikonstruktohen apo janë në proces asfaltimi sipas programit buxhetor afatmesëm të miratuar nga Bashkia dhe objektivave më afatgjatë në këtë sektor.

ii. Shërbimi i larjes së sipërfaqeve

- Do të vazhdojë të laget e njëjta sipërfaqe në NjA Gramsh dhe në vazhdim do të përfshihen në këtë aktivitet dhe sipërfaqet e reja që do të fshihen.

Kosto për çdo aktivitet

Kur flasim për aktivitete të pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe shesheve , ato përfshijnë:

- fshirje me fshesë çdo muaj e 101,923 m² rrugë, trotuare dhe sheshe për NjA Gramsh të cilat do të fshihen shtatë ditë në javë.
- mbledhje e mbetjeve nga fshirja dhe nga koshat e vegjël të mbetjeve;
- depozitimi i këtyre mbetjeve në pikat e afërta të grumbullimit (kontenierët);
- lagia e përditshme e sipërfaqeve prej 63.000 m² /muaj , të përcaktuara si më sipër në sezonin përkatës maj-shtator në 5 muaj të vitit;

Standarti i shërbimit Viti 2019

- a) Fshirje me fshesë çdo muaj e sipërfaqes prej 101.923 m²,
- b) Lagie çdo ditë për periudhën 5- mujore, nga 1 maj-30 shtator e 63.000 m² /muaj sipërfaqe,
- b) Norma e fshirjes rreth 10,192 m²/punëtor në muaj,
- c) Norma e lagies 152 ditë pune në vit,

Standarti i shërbimit Viti 2021

- a) Fshirje me fshesë çdo muaj e sipërfaqes prej 122,946 m²,
- b) Lagie çdo ditë për periudhën 5- mujore, nga 1 maj-30 shtator e 74,895 m² /muaj sipërfaqe,
- b) Norma e fshirjes rreth 12,295 m²/punëtor në muaj,
- c) Norma e lagies 152 ditë pune në vit,

Llogaritja e qendrave të kostos për çdo aktivitet

- ✓ Fillimisht, mbi bazën e standardit aktual të shërbimit të ofruar, aktivitetëve, normave të shërbimit, çmimeve aktuale të tregut, llogaritet kosto operative për çdo qendër kostoje për vitin 2019.
- ✓ Llogaritjet e fuqisë punëtore janë bërë sipas kodit të punës për 40 orë në javë, prashtohen puntorë rezervë për të zëvendësuar ditët e pushimit, festave, lejesë zakonisht dhe të ndonjë raporti mjekësor.
- ✓ Kosto për njësi shërbimi për çdo aktivitet për vitin 2019, u përdor si referencë për llogaritjen e koston operative në vitet 2019-2024, me disa korigjime të rastit. Shpenzimet krahasuar me vitin 2019 rriten mbi bazën e sipërfaqeve të reja që Bashkia vendos të shtohen sipas mundësive buxhetore.

Kosto Fshirjen e rrugëve (000/Leke)	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Gramsh	4.015	5.098	6.470	6.470	6.470	6.470
Shuma	4.015	5.098	6.470	6.470	6.470	6.470
Lekë për m ² fshirje	3.28	3.90	4.66	4.66	4.66	4.66

Tabela 21. Kosto e fshirjes së rrugëve

Kosto larje e rrugëve/shesheve (000/Leke)	2019	2020	2021	2022	2023	2024
GRAMSH	7,463	1,444	1,153	1,153	1,153	1,153

Shuma	7,463	1,444	1,153	1,153	1,153	1,153
Lekë për m² larje	23.69	4.42	3.08	3.08	3.08	3.08

Tabela 22. Kosto e larjes së rrugëve

Në anekse gjeni llogaritjen analitike të koston së fshirjes dhe larjes së rrugëve.

Mbledhja, largimi⁷ dhe transporti miks i mbetjeve

Mbledhja dhe llogaritja e të dhënave për periudhën 2019-2024, shërbeu për kuptimin dhe vlerësimin e situatës aktuale që lidhet me investime kapitale, shpenzimet operative, shpenzimet e personelit dhe shpenzime të tjera administrative. Informacioni u siguria nëpërmjet intervistave me personat përgjegjës për NJQV-të, si dhe bazat e të dhënave duke shfrytëzuar hartat, dokumentet strategjike, planet kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, dhe referencat e raporteve të ndryshme.

Supozimet:

- ✓ Aktualisht mbetjet grumbullohen: Zona I-rë largohen mbetjet nga kontenierët 7-ditë në javë, Zona e II-të largohen 1 herë në javë, Zona III-të largohen 1-herë në javë. Më pas është menduar që në 2021 në Zonat –II dhe Zonat –III mbetjet të grumbullohen dhe të largohen 2 herë në javë.
- ✓ Normalisht një kamion që grumbullon mbetjet duhet të vizitojë të gjithë zonën administrative (pikat e grumbullimit), duke udhëtuar përreth derisa kamioni të mbushet plot. Më tej, ai drejtohet në fushën e depozitimit 'landfill' dhe kthehet përsëri, gjë që mund të përkojë me një turn ose përfundimin e shërbimit të grumbullimit për një ekip 1 shofe plus 2 punonjës. Gjendja e rrugëve është shumë e rëndësishme pasi kjo lidhet kryesisht me konsumin dhe kostot e amortizimit dhe, për më tepër me kohën e shpenzuar për grumbullimin. Rrugët e shtruara përmirësojnë shumë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve. Distancat të cilat u morrën në konsideratë janë:
 - Distanca për grumbullimin, për të mbushur një kamion,
 - Distanca për transportin, për të shkuar dhe kthyer nga fusha e depozitimit 'landfill Elbasan'.

Rezultatet e mbetjeve të gjeneruara, për qëllime të llogaritjes së koston, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

TE DHENAT BAZE				
Emri i Zones se Mbetjeve (NjA)	Njësia	Zona I	Zona II	Zona III

⁷ Per termin “mbledhje dhe largim” sipas ligjit 139/2015, mund te perdoret fjala permbledhese “grumbullim

Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve	Nr.	7	1	1
Kategoria		Urban	Rurale	Rural
Popullsia dhe biznesi i shërbyer në këtë zonë	Nr.	10,481	2,656	1,408
% e popullsisë që përjashtohen (të regjistruar, por jetojnë jashtë)	%	-	-	-
Popullsia shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin)	Nr.	10,481	2,656	1,408
Rrugët (distanca nga Landfilli vajtje-ardhje)	Km	14	14	14
Rrugët (distanca e përshkuar gjatë grumbullimit/turn për një kamion)	Km	17	27	22
Mbetjet e gjeneruara per njesi (banor, biznes, institucion)	kg/njesi/dite	5,955.0	1,207.2	640.0
Totali i mbetjeve të gjeneruara	ton/dite	5.2	1	0.6
Totali i mbetjeve të gjeneruara	ton/dite	5.2	1	1
Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve sipas frekuencës	ton/dite	5.2	1.1	0.6
Totali i mbetjeve të gjeneruar	ton/vit	1,913	388	206

Tabela 23. Të dhëna bazë për çdo zonë mbetjesh Viti 2019

Të gjitha shifrat e mësipërme kanë të bëjnë me mbetjet e ngurta urbane, duke mos përfshirë mbetjet e rrezikshme, bujqësore, inertet dhe mbetjet voluminoze, të cilat duhet të trajtohen veçmas në bazë të standardeve për menaxhimin e tyre. Më sipër paraqitet tabela ku pasqyrohet situata aktuale për këtë shërbim. Gjithashtu në 2021 do të kemi ndryshim në procesin e menaxhimit të mbetjeve pasi do të ndryshojë si frekuenca e grumbullimit të mbetjeve në zonat II dhe III nga 1 herë në javë në 2 herë në javë grumbullimi i mbetjeve, Gjithashtu duke filluar nga janari 2021 do të ndryshojë venddepozitimi i mbetjeve të grumbulluara, nga venddepozitimi aktual pasi ai nuk i plotëson kushtet optimale në inceneratorin e Elbasanit.

Politikat, objektivat dhe kostot

Sipas skemës mix të prezantuar më sipër familjet, bizneset dhe institucionet çojnë në pikat e grumbullimit ku janë vendosur kontenierët të gjitha mbetjet e gjeneruara dhe më pas nëpërmjet mjeteve të transportit ato destinohen në venddepozitimin/ landfillin më të afërt, ku realizohet dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre.

Politikat 2019-2024

Mbi plotësimin e bashkise me kontenierët e nevojshëm

- ✓ Vitin e parë të planit, 2019, Bashkia bleu kontenierë të rinj (rreth 72 kontenier) të domosdoshëm, duke pas në dispozicion 158 kontenier aktualisht të shpërndara në zonat ku ofrohet ky shërbim, sipas gjenerimit të mbetjeve në tre zonat e mbuluara me shërbim në vitin aktual.
- ✓ Në vitin 2020 janë parashikuar të blihen 60 kontenier për të mbuluar zonat e ofrimit të shërbimit.
- ✓ Nga viti 2021-2024, bashkia do të sigurojë numrin e nevojshëm të kontenierëve prej 160 kontenier të rinj, që sipas llogaritjeve të bëra dhe gjenerimit të mbetjeve dhe zgjerimit të zonave të shërbimit arrin në 260 kontenier, duke mbuluar 100% të qytetit Gramsh dhe 100% të gjitha zonat me afalt nëpër Njësi Administrative.

Numri i kontenierëve sipas zonave	Numri aktual gjendje	Parashikimi i kontinerëve 2020-2024				
		viti				
	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Zona 1	93	103	103	120	120	120
Zona 2	34	64	64	80	80	80
Zona 3	31	51	51	60	60	60
Mirwmbajte/rezerve						
Total	158	218	218	260	260	260
Kontenierë Shtesë për çdo vit	0	60	0	42	0	0

Tabela 24. Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme

Mbi organizimin e pikave të vendosjes së kontenierëve

Përcaktimi i pikave për vendosjen e kontenierëve do të jetë në funksion të grumbullimit miks të mbetjeve dhe në çdo pikë do të vendosen 1-2 kontenierë, pra mesatarisht bashkia do të ketë sipas numrit të kontenierëve 260 pika.

- ✓ Nga 158 pika aktuale për grumbullimin e mbetjeve, do të shtohen dhe 102 pika.

Llogaritja e qendrave të kosto për çdo aktivitet

- ✓ Fillimisht, mbi bazën e standardit aktual të shërbimit të ofruar, aktivitetëve, normave të shërbimit, çmimeve aktuale të tregut, llogaritet kosto operative për çdo qendër kostoje për vitin 2019.

- ✓ Kosto për njësi shërbimi për çdo aktivitet të vitit 2019, u përdor si referencë për llogaritjen e kostos operative në vitet 2019-2024, me disa korigjime të rastit. Shpenzimet krahasuar me vitin 2019 rriten mbi bazën e gjenerimit të mbetjeve dhe shtimit të zonave të shërbimit në të gjithë territorin

Aktiviteti i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve sipas skemës së mësipërme përfshin:

- Grumbullimin mix të mbetjeve urbane në të gjitha pikat publike me kontenierë
- Pastrimin e vendit rreth kontenierëve
- Transportin e mbetjeve në landfillin e Mashanit dhe në incinerator duke filluar nga viti 2021.

Standarti i shërbimit

Bashkia aktualisht i largon mbetjet çdo ditë për të gjitha zonat urbane dhe gjysëm urbane dhe 1 herë në javë për zonat rurale. Më pas në 2021 frekuenca në zonat rurale ku ofrohet ky shërbim do të bëhet 2 herë në javë, pasi këto frekuenca rezultojnë si më të përshtatshme për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve.

Nga shërbimi i pastrimit në bashki, planifikohet se do të largohen të gjitha mbetjet e gjeneruara e grumbulluara në kontenierët sipas këtij grafiku:

VITI 2019 - 2020

1. Zona I-rë do t'i largojnë mbetjet 7-ditë në javë,
2. Zona e II-të do t'i largojnë 1 herë në javë,
3. Zona III-të do t'i largojnë 1-herë në javë,

VITI 2021-2024

1. Zona I-rë do t'i largojnë mbetjet 7-ditë në javë,
2. Zona e II-të do t'i largojnë 2 herë në javë,
3. Zona III-të do t'i largojnë 2-herë në javë,

C. Kostot e Mbledhjes dhe Transportit të Mbetjeve

C.1 Kostot Kapitale

Bashkia është e domosdoshme të krijojë infrastrukturën bazë fizike të menaxhimit të mbetjeve. Si hap i parë, duhet llogaritur sa kamionë dhe konteniere nevojiten për të menaxhuar mbetjet në mënyrën e duhur. Blerja e këtyre mjeteve përfaqëson investimin kapital. Përdorimi nga ana jonë i numrit të popullsisë së regjistrit Civil të korrigjuar ofron koston më të ulët kapitale.

C.1.1 Kosto kapitale për Kamionët

Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë vetëngjeshës me kapacitet 5 dhe 16 ton. Këta kamionë sugjerohen për t'u përdorur në varësi të tipit dhe popullsinë e njësisë. Normalisht në zonë rurale dhe gjysëm urbane mirë është të përdoret kamioni me kapacitet 5 ton, ndërsa një zonë urbane kamioni me kapacitet më të madh dhe tek ne është aktualisht 16 ton.

Sipas tabelës së mëposhtme kosto kapitale për blerjen e 1 kamioni të përdorur është 4,000,000 lekë, për një kamion 5 ton i cili është blerë në vitin aktual 2019.

Kosto blerje kamioni ⁸	5 Ton (Viti 2019)	15 ton (Viti 2020)
Kosto kamionit (cmimi i referohet tregut aktual për kamion të përdorur)	4.000.000	5.500.000
Numri i kamioneve	1	1
Totali i kostove të investimit (kamione) (Leke)	4.000.000	5.500.000

Tabela 25: Nevojat kapitale për makina teknologjike

Deri në fund të vitit 2021 dy makinat teknologjike, një e kapacitetit 5 ton gjendje që ka Bashkia (e blerë në 2019) dhe një kamion i planifikuar për tu marrë nga Bashkia në 2020 me kapacitet 15 ton, janë të mjaftueshme për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në landfillin e Mashanit dhe më pas në incenerator në vitin 2021.

C.1.2 Kosto kapitale për Kontenierët

Një kontenier tipik ka një vëllim 1.1m^3 , i cili ka një kapacitet maksimal mbajtës prej rreth 0,1 ton mbetjesh të ngurta, në qoftë se konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej 0.11 ton/m^3 për mbetjet. Kjo dendësi është mirë të matet nga bashkia nëpërmjet peshimit, sepse është subjekt i ndryshimeve sipas përbërjes së mbetjeve. Kapaciteti i një kontenieri është në varësi të madhësisë së tij dhe dendësisë specifike të mbetjeve në kontenier. Shifrat e dhëna mund të përdoren si vlerësim paraprak.

⁸ Modeli Dldp i konsideron zonat si zona mbetjesh dhe llogarit 4 kamionë, pra 1 kamion për çdo zonë, pavarësisht gjenerimit ditor të mbetjeve.




Figura 6: rritja e numrit të kontenierëve në 5 vitet e ardhshme

Numri i kontenierëve të nevojshëm llogaritet duke marrë në konsideratë një tipologji të kufizuar të mbetjeve, kryesisht shtëpiake. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh “të mëdha” duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.

Sipas grafikut numri i kontenierëve të nevojshëm për grumbullimin e mbetjeve është 260.

Në funksion të rritjes së gjenerimit të mbetjeve në vite, bashkia do të plotësojë dhe numrin e nevojshëm të kontenierëve për vitet 2019-2024. Pra, kontenierët në vitin 2024 rriten me 102 copë krahasuar me vitin 2019.

Për vitin 2019-2024, Bashkia duhet të buxhetojë kosto kapitale 9,744,000 lekë për blerjen e kontenierëve të nevojshëm.

C.2 Kostot Operative

Kostot operative janë shpenzimet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e infrastrukturës (në lidhje me kamionët dhe kontenierët) dhe me transportin e mbetjeve, duke përfshirë koston e personelit. Këto kosto vjetore duhen mbajtur të ndara, sepse janë të lidhura ngushtë me ndryshimet e tregut dhe inflacionin.

Llogaritja e koston operative varet nga disa variabla:

- i. Ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi, të cilat lidhen ngushtë me:
 - frekuencën e grumbullimit të mbetjeve (nga 1 herë apo 7 herë në javë), pra me sasinë e mbetjeve që grumbullohen. Nëse ka një gjenerim mbetjesh prej rreth 3.5 ton/ditë, ka nevojë për shërbime të përditshme, ndërsa për një gjenerim më pak se 3 ton/ditë organizohet grumbullimi një herë në 2 ose 3 ditë. Në rast se shërbimi nuk kryhet çdo ditë ka nevojë për shtim të numrit të kontenierëve.
- ii. Kostoja e karburantit- Konsumi i karburantit varet nga një planifikim i mirë i itinerarit, grumbullimit dhe transportit eficient, gjedjes teknike të automjetit (*niveli i lartë i amortizimit sjell rritje të konsumit të karburantit në normativën për litra/km, sikurse edhe rasti i kamionit në pronësi të Bashkisë që ka normativ të lartë=35litër/km*) dhe ndikon shumë në kostot e

përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Administratorët duhet të llogarisin ndryshimet gjatë viteve të planit të çmimit të karburanteve dhe ta adresojnë atë në mënyrën e duhur.

C.2.1 Kostot e Mirëmbajtjes

i. Mirëmbajtja e kamionëve

Kostot që lidhen me kamionët janë të larta dhe mirëmbajtja e tyre është kërkesë e legjislacionit. Mirëmbajtja e kamionëve është e lidhur me ndërrimin vajit dhe filtrave, të gomave dhe punëve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen. Kostot që lidhen me kamionët janë shumë të larta dhe kërkon një plan të mirë administrativ për mirëmbajtjen. Për më tepër, kostot e sigurimeve dhe taksave duhet të llogariten çdo vit.

Shifrat për sigurimet dhe taksat i referohen taksave kombëtare për tipin e kamionit të përdorur.

Për shkak të ndarjes të bashkisë në 3-zona mbetjesh, kostot e mirëmbajtjes së kamionit 5 ton, që i shërben zonave II dhe III, janë përlllogaritur në zonën e dyte të mbetjeve, por në se Bashkia do të bëjë një përlllogaritje të detajuar dhe analitike për çdo zonë shërbimi, ajo duhet të shpërndahet në mënyrë proporcionale në të 2-zonat, sipas kilometrave dhe frekuences së mbledhjes e largimit për në landfill.

ii. Mirëmbajtja mekanike (shërbimet)

Mirëmbajtja mekanike lidhet me orët e punës së kamionit, me kushtet e rrugëve, përdorimin e kamionit. Këto kosto duhet të mbikqyren për t'i mbajtur sa të jetë e mundur në nivele të ulta. Sasia e parave të kërkuar për mirëmbajtjen vjen nga përvoja e mëparëshme e kamionit në pronësi/përdorim, nga gjendja teknike e kamionit të ri që do merret dhe nga përdorimi i këtyre mjeteve me një skenar/grafik të ri sa më eficient dhe i realizueshëm.

iii. Parkimi

Sugjerohet të përdoret për parkim të mjeteve toka e vet bashkisë, se në rast të kundërt mund të ketë kosto të tjera që lidhen me qeranë, me mirëmbajtjen e parkimit, rojet, shpenzime të tjera etj. Sasia e parave të kërkuara për parkimin bazohet në realitetin e njësisë. Nëse NJQV ka tokën e saj, mund të ulë kostot e parkimit duke ndërtuar një park për të gjithë mjetet.

Tabela më poshtë tregon kostot totale të mirëmbajtjes⁹ për çdo zonë mbetjesh, e llogaritur vetëm për dy kamionët dhe e ndarë për çdo zonë:

KOSTOT E MIREMBAJTJES	Njësia	Zona 1	Zona 2
Sigurimi i kamionit + taksat	leke/kamion/vit	49,500	45,000
Vaj + filtra	leke/kamion/vit	224,280	130,000
Goma	leke/kamion/vit	448,000	400,000

⁹ Kostot e mirembajtjes jane llogaritur per 2 kamione dhe jane ndare ne menyre te barabarte per zonat.

Mirëmbajtja mekanike	leke/kamion/vit	320,000	100,000
Parkim	leke/kamion/vit	-	-
Kostot totale të mirëmbajtjes	leke/kamion/vit	1,041,780	675,000

Tabela 26: Kosto e mirëmbajtjes

C.2.2 Kostot e Mbledhjes dhe Transportit

Kostoja e mbledhjes dhe transportit varet nga:

- Koha e shpenzuar (orë)** - ka të bëjë me kohën për mbledhjen e mbetjeve në kohë për transportin e tyre në landfill. Kjo shifër varet nga lloji i automjetit dhe llojit të zonës (urban, gjysëm urban, rural). Zakonisht për kohën e grumbullimit një kamion 5t do t'i duhen 3 orë për të përfunduar ndërsa një kamioni 16t do t'i duhen 4 orë (keto mund të maten nga vetë bashkia). Koha gjithashtu ndryshon në varësi të distancës në landfill dhe shpejtësisë të kamionit. Në landfill, kamionët kanë nevojë për një kohë shtesë për të shkarkuar që është mesatarisht 0,5 orë/turn.
- Distancat e përgjithshme (km)** - llogaritur si distanca për grumbullimin e mbetjeve dhe distanca në landfill. Një sistem rrugor i mirë i brendshëm do të rezultojë shumë eficient për të zvogëluar distancat e përgjithshme, pra, më pak kohë dhe më pak karburant. Intinerari i rrugëve të brendshme të kamionëve sugjerohet të studiohet më përpara, për të mos përshkuar (nëse është e mundur) të njëjtat rrugë dy herë.
- Konsumi i karburantit (l)** - Varet nga lloji i automjetit dhe numri i shërbimeve. Nga përvoja konsumi për kamionë për grumbullimin e mbetjeve është përkatësisht: për kamionin 5t = 3 litra/orë, për atë 16t = 5litra/orë.
Konsumi për kamionë gjatë transportit është konsideuar përkatësisht: për llojin 5t = 0.35 litra/km, për llojin 16t = 0.5litra/km.
Për të qenë sa më të saktë dhe për të përcaktuar ku janë kostot kryesore (dhe kursimet e mundshme), këshillohet të ndahen kostot për grumbullimin (kur kamioni është duke u mbushur) nga kostot e transportit (kur kamioni është e plot dhe rrugës për në 'landfill').

C.2.2/a Kosto e grumbullimit të mbetjeve

Tabela e mëposhtme përcakton koston e grumbullimit të mbetjeve:

Kostot e grumbullimit	Njësia	Zona I	Zona II	Zona III
Dite pune (nëse më pak se 2ton/ditë, grumbullimi 2herë/javë)	dite	365	52	52
Kostot e karburantit	leke/liter	180	180	180

Koha për të ngarkuar një kamion në herë - koha e grumbullimit	ore	4	3	3
Koha totale për grumbullim (nr. kamionëve * kohë/kamion * nr. i turneve)	ore/dite	1	1	1
Koha për të shkarkuar në "landfill" [h]	ore	0.5	0.5	0.5
Proporcioni i kohës totale për grumbullim [%]	%	83%	83%	83%
Karburanti i konsumuar gjatë grumbullimit	litra/vit	558,450.0	88,452.0	72,072.0
e /vit ne total për grumbullim	km/vit	6,205.0	1,404.0	1,144.0
Kostot totale për grumbullim (vit)	leke/vit	558,450	88,452	72,072

Tabela 27. Kosto e grumbullimit të mbetjeve

C.2.2/b Kosto e transportit të mbetjeve

Tabela e mëposhtme përcakton koston e transportit të mbetjeve:

Kostot e transportit	Njësia	Zona I	Zona II	Zona III
Shpejtësia e lëvizjes	km/ore	50	50	50
Koha e transportimit për në "landfill"	ore	0.6	0.6	0.6
Koha totale e harxhuar për transportim (një ditë/të gjithë kamionët)	ore/dite	0.6	0.6	0.6
Proporcioni i kohës totale për transport [%]	%	16%	16%	16%
Totali i km për transport për dit, të gjithë kamionat	km/dite	31.0	41.0	36.0
Karburan i konsumuar gjatë transportit	litra/vit	459,900.0	45,864.0	45,864.0
Kilometra rrugë /vit ne total për transport	km/vit	5,110	728	728
Kostot totale për transport (vit)	leke/vit	459,900	45,864	45,864

Tabela 28. Kosto e transportit të mbetjeve

C.2.2/c Kosto e personelit për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve

Llogaritja e koston së personelit është një komponent menaxhues i përgjegjshëm që duhet të adresojë edhe aspektet sociale.

Fokusohet tek kostot operative të personelit, por duke u kufizuar tek shoferët dhe operatorët e kamionëve. Pavarësisht se shërbimi mund të ofrohet nga vetë njësia ose kontraktohet së jashtmi,

personeli i punësuar duhet të mbikqyret gjithmonë nga administratorët e shërbimeve të bashkise, për të siguruar që ekipi punon me eficiencë shërbimi (kohë, siguri, performancë të detyrës, etj.)

Kjo kosto kushtëzohet nga:

i. **Personeli (Numri)**

Një kombinim i mirë është 1 shofer për makinë dhe dy operatorë gjatë grumbullimit të mbetjeve. Operatorët nuk është gjithmonë e nevojshme të shoqërojnë kamionin në venddepozitim.

Numri i shoferëve dhe punëtorëve llogaritet duke marrë parasysh numrin e turneve për/kamion dhe kufizimin ligjor të orëve të punës në ditë dhe javë. Pra një kamion mund të përdoret nga 2 shoferë, (*1 e përdor paradite dhe një mbasdite*) në rastin kur shërbimi ofrohet në 3-zona dhe përsëri këta 2-shoferë mund të mbulojnë edhe rritjen e zonave të mbulimit me shërbim (*viti 2021-2024*) në 3-zona shërbimi por mbulim më të gjërë.

Personeli duhet mbështetur me uniforma, mjete për grumbullim, pastrues kimike etj.

ii. **Orari i punës**

Sipas kodit të punës 1 punëtor nuk mund të punojë më shumë se 48 orë në javë. Në rast të orareve të zgjatura mbi 8 orë, orët shtesë konsiderohen me pagesë, dhe nuk mund të punohet mbi 12 orë në ditë. Kur është e mundur, orët jashtë orarit të punës duhet të shmangen. Duhet të vendoset një ekuilibër i mirë mes numrit të turneve, orëve për turn dhe orët e totale të punës për çdo staf. Nëse është e pashmangshme, duhet të llogariten kostot shtesë për orët shtesë, ose, në qoftë se është vërtet e nevojshme, të pajtohet në punë më shumë personel.

Dita e punës së personelit përbëhet nga koha për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin (ditari) dhe takimet/trajnimet. Për llogaritjen e kostos duhet të kryhet një shpërndarje mes shërbimit të kamionit dhe mirëmbajtjes.

a) Llogaritja jonë: maksimumi 8 orë në ditë dhe 40 orë një javë - kohë të përfshira këtu për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin, takime etj.

b) Llogaritja jonë: 7.3% e kohës e harxhuar me punët e mirëmbajtjes dhe 7.7% e kohës për ditë pushime

Paga - është llogaritur në bazë të Kodit të Punës duke respektuar pagën minimale dhe pjesën tjetër në varësi të punës dhe kapacitetit. Paga përfshin pagesën dhe për detyra të tjera. Në pagesën mujore ligjore përfshihen dhe kritere të tjera si puna natën apo dhe vjetërsia në punë si dhe taksat ndaj shtetit.

Tabela e mëposhtme llogarit koston e shoferave dhe operatorëve viti 2019:

Kostot e shofereve dhe operatoreve	Njësia	Zona I	Zona II	Zona III
Ditët e punës në javë	dite/jave	7	1	1
Orët e punës në javë	ore/jave	40	40	40
Orët e punës në ditë	ore/dite	8	8	8
Mirëmbajtja (ne % ndaj kohës së punës)	%	7.30%		
Pushimet	%	7.70%		
Numri i shoferave bazuar në nevojën ditore				
Orët e punës për javë / shofer (pa mirëmbajtjen dhe fundjavat)	ore	33.9	33.9	33.9
Koha javore e nevojshme për mirëmbajtje	ore/jave	2.47	2.47	2.47
Koha javore e nevojshme për pushim fundjave	ore/jave	2.61	2.61	2.61
Orët e punës për javë / shofer (me mirëmbajtjen)	ore/jave	36.3	36.3	36.3
Numri total i shoferave të nevojshëm (duke konsideruar orët maksimale të punës në javë)	numri	1	1	0
Paga mujore e shoferave	leke/vit	390,000	504,000	-
Taksat (ne % ndaj pages)	%	0.48%	0.48%	0.00%
Kosto vjetore per shoferet	leke/vit	577,200	745,920	
Numri i punonjesve/operatoreve per ekip (1 shofer X 2 operatore)	numri	2	2	
Ore e punes ne jave/operator (perfshijne mirembajtjen)	ore/jave	28.0	28.0	
Koha e mbetur per detyra te tjera ne jave / operator	ore/jave	11.9	11.9	
Paga mujore e punonjësve/operatorëve	leke/muaj	390,000	468,000	
Taksat (ne % ndaj pages)	%	0.48%	0.48%	
Kosto vjetore per operatorët	leke/vit	1,154,400	1,385,280	

Tabela 29. Kosto e shoferëve dhe operatorëve viti 2019

C.2.3 Kostot e Depozitimit të mbetjeve në landfill

Sipas legjislacionit për “mbetjet” çdo NJQV duhet t’i depozitojë mbetjet në një mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt. Kosto për depozitim mbetjesh është vendosur si tarifë hyrjeje dhe zakonisht paguhet për ton.

Kostot e depozitimit mund të jenë subjekt i ndryshimit, bazuar në sasinë e mbetjeve që shkon përditë në ‘landfill’ dhe sipas shërbimeve që kryhen në të. Si pasojë duhet të nënshkruhet një marrëveshje e qartë, e cila do ta adresojë tarifën bazuar në një plan biznesi të përshtatshëm dhe të shtrirë në kohë.

Bashkia i depoziton mbetjet në landfillin e Majkoshit dhe duke qënë se e ka në administrim të saj nuk paguan tarifë.

C.2.4 Kostot e Amortizimit

Në mënyrë që sistemi të mbahet në punë për një kohë të gjatë rëndësi ka llogaritja e kostove të nevojshme për riinvestim. Pra, konsiderimi i koston së amortizimit është çështje e qëndrueshmërisë të sistemit dhe siguron një sistem funksional.

Llogaritja bazohet në legjislacionin shqiptar për amortizimin e pajisjeve, e cila parashikon një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe lidhen direkt me koston vjetore për amortizimin për kamionët dhe kontenierët. Kjo i shtohet sistemit si një përqindje për vitin, që praktikisht paraqet 6-15% të shumës totale të koston për kamionë dhe 2-6% të shumës totale të koston kontenierë në vit.

Kjo nuk lidhet detyrimisht me amortizimin e vërtetë. Përdorimi i papërshtatshëm mund të shkurtojë jetën e pajisjeve dhe për këtë arsye të ndikojë ndjeshëm në koston për mirëmbajtjen, investimet, dhe eficiencën e shërbimit (koha, karburanti). Për kontenieret kjo llogaritje është subjekt verifikimi në bazë të përdorimit të tyre.

Tabela e mëposhtme parashikon koston e amortizimit për dy kamionët dhe 232 kontenierët, pra vetëm për kontenierët e rinj. Kontenierët ekzistues, deri në fund të vitit 2019 do të zëvendësohen me të rinj, për shkak të gjendjes së tyre shumë të keqe, prandaj nuk është llogaritur kosto amortizimi.

Kostot e amortizimit	Njësia	Zona I
Kamionë		
Amortizimi i kamionit në vit	%/vit	6%
Kosto amortizimi per kamionet	leke/vit	240,000
Kazanë		
Amortizimi i kazanit në vit	%/vit	2%
Kosto amortizimi konteniere	leke/vit	132,720
Totali i koston amortizimit	leke/vit	372,720

Tabela 30. Kosto e amortizimit

A. Kostot Administrative dhe e Ardhura Neto

Kostot administrative mund të përfshijnë koston e nevojshme për rikuperimin e kostove dhe për fushatat e ndërgjegjësimit publik. Ajo mund të paraqitet e veçantë, ose të jetë pjesë e kostove të përgjithshme administrative. Ky vendim merret në bazë të kapaciteteve dhe nevojave të bashkisë.

Përveç kësaj, duhen llogaritur të ardhurat neto, të cilat kërkohen për teknologji të reja, zgjerimin e shërbimit dhe çështje të tjera të paplanifikuara dhe të nevojshme. Shifra përcaktohet nga administratori vendor bazuar në kapacitetin financiar. Shifra është vendosur si përqindje e kostove totale.

Përvoja sugjeron se këto përqindje janë përkatësisht: 9% për kostot administrative dhe 4% të ardhura neto.

B. PERMBLEDHESE E KOSTOS OPERATIVE DHE KAPITALE

E.1 Kosto e vitit 2019

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e kostos totale për vitin e parë të planit (2019), dhe informon drejtorinë përkatëse mbi nevojat për investime, personel, operacione, amortizimin e mjeteve dhe kosto të tjera, në mënyrë që të jetë në gjendje të paraqesë vlerësimin e kostos në nivelin e duhur tek kryetari i bashkisë dhe këshilli i njësisë.

Kosto totale operacionale	Njesia	Zona I	Zona II	Zona III	TOTALI
Mirembajtje	Leke/vit	3,869,850	3,209,076	143,976	7,222,902
Kosto totale investime	Njesia	Zona I	Zona II	Zona III	TOTALI
Kamione(blerje/qera)	leke		4,000,000		4,000,000
Kontenier (17 cope)	Leke	-	3,024,000	-	3,024,000
Kosto totale		-	7,024,000		7,024,000
Të ardhurat neto (ne % ndaj kostos totale)	%				
Totali i të ardhurave neto	Leke/vit	-	-	-	-
TOTAL KOSTO OPERACIONALE	Leke/vit	3,869,850	10,233,076	143,976	14,246,902
Kosto totale per fshirje	Leke/vit				4,015,440
Kosto totale per larje	Leke/vit				1,492,510
TOTALI I KOSTOS SHERBIMIT TE PASTRIMIT	Leke/vit				19,754,852
Kostot totale për ton mbetje (cikël i plotë)	Leke/ton	2,023	26,391	700	5,685

Kostot totale për banor mbetje në vit (cikël i plotë)	Leke/banor/vit	369	3,853	102	980
Kostot totale për banor sherbim pastrimi në vit (cikël i plotë)	Leke/banor/vit				1358.2

Tabela 31. Kosto e totale e shërbimit

Sipas peshës që zënë shpenzimet në strukturën e kostos 2019, nga të gjitha zërat e shpenzimeve janë grupuar për efekt të ndarjes sipas zërave buxhetorë, shpenzimet për personelin në mbledhjen, grumbullimin, transportin, fshirjen dhe larjen, dhe paraqiten në tabelën e grafikun e mëposhtëm:

Struktura e kostos së shërbimit të pasterimit	%	Leke në vit
Mirëmbajtje	9%	1,716,780
Grumbullim	4%	718,974
Transport	3%	551,628
Personeli	39%	7,655,550
Amortizimi	2%	372,720
Investime	36%	7,024,000
Fshirje	2%	374,400
Larje	7%	1,340,800
TOTALI	100%	19,754,852

Tabela 32. Struktura e kostos së shërbimit




Figura 7: Struktura e koston operative

Siç edhe evidentohet, shpenzimet për personelin zënë pjesën më të madhe, në 39% të koston. Kjo shpjegohet me mënyrën e realizimit të shërbimit, manuale, pa paisje, mjete e teknologji të reja që reduktojnë nevojën për fuqi punëtore e ulin numrin e madh të tyre. Gjithashtu, kjo ka lidhje me mundësitë e pakta financiare të bashkisë dhe nivelin ekonomik të komunitetit.

E.2 Kosto e viteve 2019-2024

Bazuar në normat për njësi të koston së vitit 2019 dhe disa shtesave të tjera u llogarit dhe kosto për periudhën 2019-2024.

Kosto totale operative	Njesia	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Mirembajtje	Leke/vit	7,222,902	7698486	11329787	11282067	11282067	11282067
Kosto totale investime	Njesia	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Kamione 1, 5-Ton (viti 2021)	LEK/VIT	4,000,000	5,500,000	-	-	-	-
Autobot per lagje rruges 1	LEK/VIT		5,500,000	-	-	-	-
Kontenier 137 cope x 30000	cofer/leke	3,024,000	2,520,000	-	2,100,000	2,100,000	-
Kosto totale		7,024,000	8,020,000	-	2,100,000	2,100,000	-
Të ardhurat neto (ne % ndaj koston totale)	%	-	-	-	-	-	-

Totali i të ardhurave neto	Leke/vit	-	-	-	-	-	-
TOTAL KOSTO OPERACIONALE	Leke/vit	14,246,902	15,718,486	11,329,787	13,382,067	13,382,067	11,282,067
Kosto totale per fshirje	Leke/vit	4,015,440	5,097,576	6,870,448	6,870,448	6,870,448	6,870,448
Kosto totale per larje	Leke/vit	1,492,510	1,443,681	1,153,365	1,153,365	1,153,365	1,153,365
TOTALI I KOSTOS SHERBIMIT TE PASTRIMIT	Leke/vit	19,754,852	22,259,743	19,353,600	21,405,880	21,405,880	19,305,880
Kostot totale për ton mbetje (cikël i plotë)	Leke/ton	5,685	6,272	4,112	4,857	4,857	4,095
Kostot totale për banor mbetje në vit (cikël i plotë)	Leke/banor /vit	980	1,081	697	823	823	694
Kostot totale për banor sherbim pastrimi në vit (cikël i plotë)	Leke/banor /vit	1,358	1,530	1,191	1,317	1,317	1,188

Tabela 33: Kosto e totale e shërbimit

Ndryshimet e koston sipas çdo shërbimi, evidentohen në garfikun e mëposhtëm:




Figura 7: Ndryshimi i kostove të shërbimit 2019-2024

Nëse do analizonim strukturën e koston së shërbimit të pastrimit në vite, do vërejmë se është rritur në 2-vitet e fundit vlera e mirëmbajtjes në koston e transportit dhe grumbullimit, e cila vjen si rezultat i rritjes së zonave të mbulimit, duke mbuluar të gjithë territorin e asfaltuar të Bashkisë. Këto ndryshime paraqiten si në tabelën e grafikon e mëposhtëm:

Struktura e koston se sherbimit te pasterimit	%	Leke ne vit
---	---	-------------

Mirëmbajtje	9%	1,716,780
Grumbullim	5%	1,039,563
Transport	19%	3,609,900
Personeli	56%	10,824,837
Amortizimi	4%	788,314
Investime	0%	-
Fshirje	2%	400,600
Larje	5%	925,800
TOTALI	100%	19,305,794

Tabela 34: Struktura e koston së shërbimit në vitin 2024




Figura 8. Struktura e koston së shërbimit në vitin 2024

V. PERSPEKTIVA FINANCIARE

5.1. Çështja e financimit dhe strategjia e “mbulimit të kostos”

Investimet kapitale

Sipas vlerësimit paraprak të prezantuar më lart, investimet kapitale duhet të rriten në mënyrë progresive në 5 vitet e ardhshme sipas nevojave për përmirësimin dhe modernizimin e sistemit të manaxhimit të mbetjeve. Investimet do të kërkojnë të mbulohen nga burimet financiare vendore (nga të ardhurat e vetë bashkisë) të kombinuara me programet e huaja të donatorëve që janë të pranishëm në rajon për pajisje dhe makineri, si dhe nga burimet kombëtare, nga donatorët e huaj dhe bankat e zhvillimit, sektori privat apo kombinimi i tyre për investimet e tjera.

Strategjia e mbulimit të kostos dhe niveli i tarifave

Sipas legjislacionit ekzistues, autoritetet vendore kanë përgjegjësinë të kontrollojnë caktimin dhe përshtatjen e tarifave të mbetjeve në përputhje me politikat e tarifave të përcaktuara nga këshilli bashkiak dhe të bazuara në principet e mëposhtme:

- Parimin “kush ndot paguan”
- Rakordimin me buxhetin vjetor
- Prioritetet lokale dhe politike
- Mundësia e pagesës

Shqyrtimi paraprak i strukturës aktuale financiare të sektorit të manaxhimit të mbetjeve në Bashki tregon se ajo nuk ka një performancë të mirë në realizimin e të ardhurave nga mbetjet duke mbuluar deri 34% të shpenzimeve aktuale për shërbimet e pastrimit dhe largimit të mbetjeve, por edhe buxheti aktual është i pamjaftueshëm për modernizimin e shërbimeve të pastrimit dhe përmbushjen e standarteve kombëtare për depozitimin mjedisor të mbetjeve.

Gjithashtu vihet re dhe një planifikim me rezerva i të ardhurave. Baza e përmirësimit të mëtejshëm të sistemit aktual të tarifave dhe të të ardhurave nga mbetjet duhet të mbështet në parimin “*ndotësi paguan*” apo mbi “*përgjegjësia e prodhuesit të mbetjeve*” si dhe në elasticitetin e sistemit në mbështetje të iniciativave për minimizimin e mbetjeve. Qëllimi i bashkisë është të zbatojë sistemin e mbulimit të kostos që lidhet me objektivat e saj. Prandaj, nëse bashkia synon të përmbushë objektivin menjëherë, plani rekomandon rritjen e nivelit të tarifave në mënyrë progresive drejt mbulimit të kostos operative, kostos së mirëmbajtjes dhe amortizimit si dhe duke përdorur subvencione apo të ardhura të tjera të bashkisë për të mbështetur kostot administrative.

Ngritja e strategjisë për mbulimin e kostos fillon nga llogaritja totale e kostos, ku të gjitha kostot që lidhen me komponentët e sistemit të administrimit të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme evidentohen dhe përmbledhen në tabelën e mëposhtme.

KOSTO TOTALE E MENAXHIMIT TE MBETJEVE	2019	2020	2021	2022	2023	2024
KOSTO E MBLEDHJE LARGIM MBETJE	7,222,902	7,698,486	11,329,787	11,282,067	11,282,067	11,282,067
KOSTO FSHIRJE	4,015,440	6,125,495	6,125,495	6,125,495	6,125,495	6,125,495
KOSTO LAGIE	1,492,510	1,492,510	1,492,510	1,492,510	1,492,510	1,492,510
TOTALI KOSTOS SHERBIMIT	12,730,852	15,316,491	18,947,792	18,900,072	18,900,072	18,900,072
INVESTIME	7,024,000	8,020,000	-	2,100,000	2,100,000	-
TOTALI KOSTOS SE MENAXHIMIT MBETJEVE	19,754,852	22,259,743	19,353,600	21,405,880	21,405,880	19,305,880

Tabela 35: Përmbledhje e evidentimit të kostove, 2019-2024¹⁰

Politika vendore dhe planifikimi i mbetjeve

Mbledhja e mbetjeve urbane, pastrimi i rrugëve, etj, konsiderohen shërbime publike në shërbim të të gjithë qytetarëve nga i cili është e vështirë të përjashtojmë pa krijuar probleme urbane, mjedisore, por njëkohësisht është një shërbim me kosto të konsiderueshme për të cilën të gjithë që përfitojnë duhet të paguajnë.

Për të mundur një parashikim dhe strategji reale të llogaritjes së të ardhurave për periudhën 5-vjeçare, rekomandohet që bashkia të marrë në konsideratë faktorë të tjerë socialë¹¹ (si psh. pamundësia e disa familjeve për të paguar), apo eksperiencia dhe performanca aktuale e bashkisë për të mbledhur të ardhurat që lidhet me rritjen nga niveli aktual i tarifës dhe të pagesës së tarifave nga konsumatorët si dhe performancën aktuale të bashkisë për mbledhjen e të ardhurave, duke zbatuar “Planin e standart të veprimit dhe monitorimit për mbledhjen e tarifës së pastrimit dhe i detyrimeve të prapambetura. Identifikimi dhe vlerësimi i këtyre faktorëve ndihmojnë bashkinë të orientojë veprimet dhe strategjitë për modernizimin e mëtejshëm të sistemit fiskal të dhe mbulimin e kostos së shërbimit të mbetjeve nga tarifatat. Në draft Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve, standartet e përcaktuara janë:

1-Mbulimi i kostove me të ardhurat nga mbledhja e tarifave:

¹⁰ Skenari i grumbullimit dhe transportit miks të mbetjeve dhe përdorimi i venddepozitimit të Mashanit për vitin 2019 dhe 2020 dhe dërgimi në incinerator për vitet 2021-2024.

¹¹ Në fakt sot bashkia aplikon një tarifë të reduktuar për familjet invalide dhe pensionistet

- 80% deri në vitin 2023, 90% deri në 2028, 100% deri në 2033

2-Niveli i mbledhjes së tarifave:

- 80% deri në 2023, 90% deri në 2028, 100% deri në 2033

Në funksion të përmbushjes dhe arritjes së këtyre standarteve, Bashkia duhet të realizojë një politik fiskale me nivele më të ulta tarifimi në vitet 2020-2022, dhe pastaj një rritje të nivelit të tarifave, deri në planifikimin e mbulimit të 80% të kostonë së planifikuar të shërbimit.

Tabela e mëposhtme paraqet se si janë marr në konsideratë dhe kanë ndryshuar këta faktorë si dhe performancën e bashkisë në vjeljen e tarifave dhe në parashikimin e të ardhurave për vitet e ardhshme.

Ndryshimi dhe rritja e të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga viti 2019 në vitin 2024, paraqitet si rezultat:

- ✓ i zgjerimit të zonave të shërbimit në të gjithë Bashkinë, e përrjedhë rritje e bazës së tatueshme për familjarët nga 3360 familje në vitin 2019, në 3960 familje në vitin 2024,
- ✓ rritjen e nivelit të tarifës në mënyrë periodike në grupin familje NJA Gramsh nga 1200/lekë në vit në vitin 2020 në 2000/lekë vit në vitn 2024,
- ✓ rritjen e nivelit të tarifës në mënyrë periodike në grupin familje NJA Pishaj, Kodovjat, Sult, nga 700/lekë në vit në vitin 2020 në 1000/lekë vit në vitn 2024,
- ✓ rritjen e lehtë të tarifës për institucionet shtetërore,
- ✓ rritje e nivelit të tarifës në grupin e biznesit, e cila ndikon me rritjen e vlerës të realizimit së tarifës për këtë grup mbas 5-viteve,

Nga këto ndryshime në planin e të ardhurave 2020-2024, vlera që pasqyrohet sipas grupimeve paraqitet:

- Grupi familje me 2581 mijë lekë;
- Grupi institucione 460 mijë lekë;
- Grupi biznese 2842 mijë lekë;

Në mënyrë analitike, të dhënat për të ardhurat e planifikuara të viteve 2020-2024 për tarifen e pastrimit paraqiten:

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane

Bashkia Gramsh

	TABELA ANALITIKE E TARIFES SE PASTRIMIT SIPAS VITEVE	2020			2021			2022			2023			2024		
Nr	Tarifa e shërbimeve publike sipas Paketës fiskale	Baza e tatueshme sipas paketës fiskale /numer	Tarifa miratuar ne paketën fiskale lek/vit	Vlera e planifikuar ne Buxhetin e Bashkisë lek/vit	Baza e tatueshme sipas paketës fiskale /numer	Tarifa miratuar ne paketën fiskale lek/vit	Vlera e planifikuar ne Buxhetin e Bashkisë lek/vit	Baza e tatueshme sipas paketës fiskale /numer	Tarifa miratuar ne paketën fiskale lek/vit	Vlera e planifikuar ne Buxhetin e Bashkisë lek/vit	Baza e tatueshme sipas paketës fiskale /numer	Tarifa miratuar ne paketën fiskale lek/vit	Vlera e planifikuar ne Buxhetin e Bashkisë lek/vit	Baza e tatueshme sipas paketës fiskale /numer	Tarifa miratuar ne paketën fiskale lek/vit	Vlera e planifikuar ne Buxhetin e Bashkisë lek/vit
	Tarifa familjare:															
1	a) Tarifa per familjet e Bashkia GRAMSH	2,214	1,200	2,656,800	2,214	1,200	2,656,800	2,214	1,200	2,656,800	2,214	1,200	2,656,800	2,214	2,000	4,428,000
2	b) Per familjet qe kane nje pjesetar invalid pune,te verber,veteran lufte,para e teraplegjik	246	200	49,200	246	200	49,200	246	200	49,200	246	200	49,200	246	200	49,200
3	c) Per pensionistet cift ose te vetmuar	200	100	20,000	200	100	20,000	200	100	20,000	200	100	20,000	200	100	20,000
4	d) Tarifa per familje NJA PISHAJ,KODOVJAT,SULT	700	700	490,000	1,000	700	700,000	1,300	700	910,000	1,300	800	1,040,000	1,300	1,000	1,300,000
A	Familje gjithsejt	3,360		3,216,000	3,660		3,426,000	3,960		3,636,000	3,960		3,766,000	3,960		5,797,200
1	Ujesjelles,Dr.Sherbimit Spitalor,	2	100,000	200,000	2	100,000	200,000	2	100,000	200,000	2	100,000	200,000	2	100,000	200,000
2	OSHEE	1	200,000	200,000	1	200,000	200,000	1	200,000	200,000	1	200,000	200,000	1	200,000	200,000
2	Albtelecom	1	120,000	120,000	1	120,000	120,000	1	120,000	120,000	1	120,000	120,000	1	150,000	150,000
3	Uzina Mekanike Cekin	1	30,000	30,000	1	30,000	30,000	1	30,000	30,000	1	30,000	30,000	1	50,000	50,000
4	Institucionet e tjera	12	20,000	240,000	12	20,000	240,000	12	20,000	240,000	12	20,000	240,000	12	50,000	600,000
B	Institucione gjithsejt	17		790,000	17		790,000	17		790,000	17		790,000	17		1,200,000
1	Devoll Hidropawer sha, Thertorja	2	200,000	400,000	2	200,000	400,000	2	200,000	400,000	2	200,000	400,000	2	250,000	500,000
3	Bankat dhe institucionet kredidhenese dhe fab. Perpunim peshku dhe HEC dhe subjekte jo rezidente qe krijojne kantire ndertimi ne B.Gramsh	14	100,000	1,400,000	14	100,000	1,400,000	14	100,000	1,400,000	14	100,000	1,400,000	14	150,000	2,100,000
4	Tarifat per bizneset e vogla 0-5ml leke	214	3,500	749,000	214	3,500	749,000	214	5,000	1,070,000	214	5,000	1,070,000	214	5,000	1,070,000
5	Tarifat per bizneset e vogla 0-5ml leke ushqimore, bar kafe	123	5,000	615,000	123	5,000	615,000	123	7,000	861,000	123	7,000	861,000	123	7,000	861,000
6	Tarifa per bizneset e vogla 5-8 ml leke	31	7,000	217,000	31	7,000	217,000	31	8,000	248,000	31	8,000	248,000	31	9,000	279,000
7	Tarifa per bizneset e vogla 5-8 ml leke ushqimore bar -kafe	7	9,000	63,000	7	9,000	63,000	7	10,000	70,000	7	10,000	70,000	7	10,000	70,000
8	Subjekte ndertimi	4	100,000	400,000	4	100,000	400,000	4	100,000	400,000	4	100,000	400,000	4	150,000	600,000
9	Subjekte prodhimi	1	60,000	60,000	1	60,000	60,000	1	60,000	60,000	1	60,000	60,000	1	90,000	90,000
10	Subjekte tregtare	25	40,000	1,000,000	25	40,000	1,000,000	25	40,000	1,000,000	25	40,000	1,000,000	25	70,000	1,750,000
11	Subjekte riparimi dhe shërbimi	10	30,000	300,000	10	30,000	300,000	10	30,000	300,000	10	30,000	300,000	10	40,000	400,000

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane

Bashkia Gramsh

12	Kompanite internet,kabllor,fibra optike	1	50,000	50,000	1	50,000	50,000	1	50,000	50,000	1	50,000	50,000	1	100,000	100,000
13	Tarifa per bizneset e vogla ne NJA	26	2,500	65,000	26	2,500	65,000	26	2,500	65,000	26	3,500	91,000	26	3,500	91,000
14	Subjekte prodhimi + karburante NJA	5	30,000	150,000	5	30,000	150,000	5	30,000	150,000	5	40,000	200,000	5	50,000	250,000
15	Biznes VIP NJA+ subjekte ndertimi	3	100,000	300,000	3	100,000	300,000	3	100,000	300,000	3	100,000	300,000	3	150,000	450,000
16	Tarife per cdo tregetar ambulant ne NJA	3	750	2,250	3	750	2,250	3	1,000	3,000	3	1,000	3,000	3	1,000	3,000
C	Biznesi gjithsejt	469		5,771,250	469		5,771,250	469		6,377,000	469		6,453,000	469		8,614,000
	TOTALI A+B+C			9,777,250		-	9,987,250		-	10,803,000		-	11,009,000		-	15,661,200

Tabela 36: Analizë e përmbledhur e planifikimit të të ardhurave

Për të vlerësuar efektivitetin e sistemit drejt arritjes së objektivave të mbulimit të koston, të ardhurat e planifikuara për secilin konsumator përmbledhen së bashku dhe krahasohen me koston totale operative kapitale. Në rastin tonë, përqindjet e mbulimit të koston për vitet në vazhdim paraqitet e lartë dhe në progres drejt mbulimit me 81 % në vitin 2024, nëse analiza nuk i kthehet rivlerësimit të nivelit të tarifave apo nëse politika vendore nuk subvencionon tarifat.

KOSTO TOTALE E MENAXHIMIT TE MBETJEVE	2020	2021	2022	2023	2024
TOTALI KOSTOS SHERBIMIT	22,259,743	19,353,600	21,405,880	21,405,880	19,305,880
TE ARDHURA	9,777,250	9,987,250	10,803,000	11,009,000	15,661,200
KOEFIÇENTI MBULIMIT KOSTOS SHERBIMIT	44%	52%	50%	51%	81%

Tabela 37. Koeficienti i mbulimit të koston 2019-2024

VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

6.1 Rregullorja vendore

Në plotësim të kuadrit ligjor të administrimit të mbetjeve, Bashkia Gramsh duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren e vet lokale, ku të përcaktojë qartë rolin dhe përgjegjësitë e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, për të siguruar administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të vet administrativ.

Ky dokument duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve dhe pastrimin e qytetit duke saktësuar rregullat, teknikat e metodat e administrimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Rregullorja duhet të jetë në përputhje me pjesën më të madhe të Direktivave të BE për Mbetjet dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

Qëllimi i rregullores është mbajtja pastër dhe siguri i një mjedisi të shëndetshëm për banorët e bashkisë.

Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja do të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv e të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

- Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, procedurat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;
- Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve, si:
- Të mos dëmtohen kontenierët, të mos ndryshohet destinacionit i tyre, të mos dëmtohet dhe ndryshohet destinacionit i pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- Të mos depozitohen mbetjet, të mos digjen mbetjet në kazanë, të mos hidhen mbetjet në rrymat ujore dhe kanalizimet, të mos hidhen mbetjet në territore publike;
- Të shmangët dhe parandalohet hedhja abuzive e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, të mos depozitohen kafshët e ngordhura dhe materialet helmuese;
- Të shmangët parkimi i automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;

- Të pastrohet hapësira rreth dyqaneve dhe pikave ambulatorë të shitjes; të mbahet higjenë dhe të dezinfektohen kontenierët dhe koshat e hedhurinave;
- Të paguhet taksat dhe tarifat vendore për mbetjet;
- Çështje të tjera të shëndetit publik.
- Të drejtat dhe detyrimet e administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve) si:
 - Proçedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
 - Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
 - Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
 - Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
 - Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
 - Mbajtja e të dhënave për mbetjet;
 - Parandalimi i problemeve për shëndetin publik;
 - Çështje të tjera të shëndetit publik, të tilla si procedurat e shëndetit, sigurisë dhe urgjencës;

Synimi i rregullores duhet të përfshijë të gjitha institucionet qendrore e lokale me seli në territorin e bashkisë, të gjithë individët, të gjithë operatorët publikë e privatë, vendas e të huaj të angazhuar në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve urbane (grumbullimi, depozitimi, transportimi, ndarja, riciklimi, trajtimi dhe asgjësimi). Rregullorja duhet të përfshijë edhe një seksion për marrëdhëniet me publikun, aktivitetet e ndaluara, sanksionet dhe masat ndëshkimore.

Një nga rregullat synuese më të rëndësishme që duhet përcaktuar në rregullore është grumbullimi i diferencuar dhe trajtimi i mbetjeve në të gjitha fazat e menaxhimit të tyre, si edhe ndalimi i përzierjes së tyre me mbetjet e rrezikshme.

6.2 Detyrimi dhe sanksionet

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve duhet të parashikojë dhe sanksionojë një listë sa më gjithëpërfshirëse ndalimesh dhe detyrimesh. *Në këtë listë mund të përfshihen ndalimet dhe detyrimet si më poshtë:*

- është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në të gjithë territorin e bashkisë, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, çdo lloj mbetje, papastërti, hedhurinë e ngurta, gjysëm e ngurta, e lëngët dhe në përgjithësi materiale mbetjesh dhe hedhurinash të çdo lloji, natyre dhe dimensionit, edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi për sipërfaqet ujore, lumenjt, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet, anët e rrugëve, etj.
- është e ndaluar dorëzimi i mbeturinave në vendet e zbuluara të hapësirave private, në trojet e sheshet, prona të rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari

ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave.

- cilido shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryej largimin e mbetjeve. Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i bashkisë cakton nëpërmjet një urdhërese, operacionet e nevojshme dhe afatet brenda të cilave duhet të veprohet, si dhe periudhën kohore për shlyerjen e dëmit monetar;
- është e ndaluar hedhja në kontenierë apo në pajisjet e përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, të mbetjeve të lëngta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mirë, të substancave të ngrohta apo ndezëse, për më tepër mbetje të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik;
- është e ndaluar hedhja e mbetjeve të ndryshme nga ato për të cilat janë vendosur kontenierët ose është caktuar shërbimi i grumbullimit;
- është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve voluminoze që nuk janë reduktuar më parë, si për nga dimensionimi, përbërja dhe karakteristika të tjera që mund t'i shkaktojnë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit, për më tepër mund të shkaktojnë rreziqe për qytetarët apo personat përgjegjës për shërbimin;
- është e detyrueshme për të gjithë llojet e prodhuesve dhe mbajtësve të mbetjeve urbane, objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rekuperimin e materialeve dhe energjisë, të dorëzojnë këto materiale në përputhje me mënyrat e caktuara në shërbimet respektive;
- është i ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajisjeve të përdorura për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo pëmbysja,
- janë të ndaluara sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo shërbimit të fshirjes;
- është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lëkura frutash, letra apo copa letrash, cigare, kuti, shishe dhe të ngjashme);
- është i ndaluar dorëzimi, tek shërbimi i grumbullimit, i kafshëve të ngordhura;
- është i ndaluar dorëzimi tek shërbimi i grumbullimit të mbetjeve speciale për të cilat nuk është lidhur një marrëveshje e përshtatshme;
- djegia e mbeturinave në kontenierë, rreth tyre dhe në çdo ambjent tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.
- ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbeturinat e kontenierëve e në pikat e grumbullimit të tyre.
- nuk pranohet e drejta për kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm pa miratimin e bashkisë.

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve të shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksione që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të

bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “*ndotësi paguan*”, ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijojë një sistem të drejtë dhe të shkurajojë dhe parandalojë ndotësit.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve lokale (Neni 61, 62 i Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve), sipas rregullores së ardhshme të administrimit të mbetjeve dhe listës së gjobave dhe shkeljeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

6.3 Liçencimi Mjedisor

Një element i domosdoshëm i menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve në Shqipëri, në të ardhmen, është përputhshmëria me ligjin. Legjislacioni Shqiptar mbi mbetjet vjen kryesisht nga Direktivat e Bashkimit Evropian – Kuadri Udhëzues për mbetjet i vitit 2008 dhe direktiva të tjera të ndryshme përfshirë, në veçanti Direktivën e Landfilleve të vitit 1999.

Çështjet që duhen patur parasysh lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në Bashkinë Gramsh përfshijnë (lista nuk është shteruese): Kontrollin e Ndikimeve Mjedisore të Menaxhimit të Mbetjeve, Planifikimin e Përdorimit të Tokës, Zhvillimin e Tregut të Riciklimit, etj.

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor vendor do të kërkojë përmirësime në sistemin e liçencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. *Sipas legjislacionit kombëtar:*

- i. Bashkitë duhet të bashkëpunojnë me DRM (Drejtorinë Rajonale të Mjedisit) kur japim miratime për aktivitete që ushtrojnë veprimtari apo projekte për administrimin e mbetjeve (Neni 25 i ligjit për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta)
- ii. Të japin miratimin për vendet e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore (Neni 13 i Ligjit për Mbetjet e Rrezikshme)
- iii. Të kontrollojnë vazhdimisht përmbushjen e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbetjeve (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-urbane). Në këtë aspekt, ajo duhet të marrë herë pas here raporte nga personat e përfshirë në këto veprimtari.
- iv. Të shikohet mundësia për një mekanizëm kontrolli jo vetëm për shërbimin e pastrimit nga vetë Bashkia, por edhe nga të tretë (auditues të pavarur) apo dhe kur të bëhen vlerësime për ndonjë venddepozitim lokal, apo rehabilitim hotspoti.
- v. Të stimulohen bizneset për t’u certifikuar me standartet e sistemeve të menaxhimit të mjedisit ISO 14001 të cilat do të rrisin pjesëmarrjen e bizneseve në zinxhirin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

6.4 Pjesëmarrja e Sektorit Privat

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze apo mbetjeve të riciklueshme, duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve.

Duke iu referuar eksperiencës ndërkombëtare dhe në disa raste kombëtare, ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, ku disa prej tyre mund të jenë:

- sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik;
- administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik;
- aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, atëherë dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve;
- i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standarteve operative dhe teknike, etj.

Duke dashur të punësojë qytetarët e saj dhe të zgjidhë problemin social të papunësisë por edhe të arrijë përfitimet maksimale nga përfshirja e sektorit privat në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve, bashkia duhet të ketë në vëmendje rekomandimet e mëposhtme:

- **Konkurrenca:** Duhet të sigurojë një konkurrencë të vërtetë mes kompanive të sektorit privat dhe madje, nëse është e mundur, midis kompanive private dhe ndërmarrjeve publike të komercializuara që operojnë në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane.
- **Kërkesa e llogarisë:** për të siguruar se kontrata funksionon: Me qëllim që kontrata me sektorin privat të japë përmirësimet e duhura dhe të matshme në efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimit, duhet të përmbushen një sërë kriteresh bazë:
 - 1) Masat e mirë-përcaktuara të performancës;
 - 2) Sanksione të zbatueshme për punën e dobët;
 - 3) Monitorim vigjilent dhe
 - 4) Kërkesa e llogarisë për kostot.
- **Transparenca:** Marrëveshjet financiare dhe marrja e vendimeve duhet të jenë transparente. Arsyet për vendimet, veçanërisht për zgjedhjen e ofruesve të shërbimeve nga sektori privat, si dhe administrimi i fondeve publike duhet të jenë të hapura për publikun;
- **Kohëzgjatja e duhur e marrëveshjes dhe ofrimi i pajisjeve:** kontratat që përfshijnë edhe investime në makineri duhet të kenë të paktën një kohëzgjatje prej 5 vjetësh, ndërsa investimet në prona të patundshme kërkojnë të paktën një kohëzgjatje prej 10 vjetësh për marrëveshjet dhe kontratat.

6.5 Mbështetja Politike

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve paraqet sfida reale për të gjitha palët e interesuara për të mbajtur një qasje të koordinuar të menaxhimit të tranzicionit drejt një sistemi modern të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Gramsh. Në këtë kuadër do të jetë thelbësor komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet palëve të interesuara dhe një mënyrë efektive për të vijuar progresin e zbatimit të PVMM.

Menaxhimi i mbetjeve dhe pastërtia duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për banorët e bashkisë dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Këshilli Bashkiak për të arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë Këshilli Bashkiak duhet të shikojë me prioritet mbështetjen e projekteve, iniciativave lokale për modernizimin e këtij sektori ashtu si masat për përmirësimin e buxhetit, investimet dhe përmirësimin e paketës fiskale, nga ana tjetër bashkia duhet të sigurojë transparencën maksimale ndaj këshillit dhe publikut. Kjo marrëdhënie reciproke do të mundësojë paanësinë politike për çështjet që lidhen me mjedisin dhe pastërtinë e qytetit.

Bashkia në bashkëpunim me ndërmarrjen e pastrimit duhet të përcaktojë dhe publikojë grafikun për pastrimin e qytetit (çdo ditë, herët në mëngjes ose vonë në mbrëmje), dhe grafikun për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve (gjatë ditës).

Rishikimi i strukturës duhet të jetë prioritet për bashkinë që të sigurojë një shërbim sa më cilësor, duke përfshirë një strukturë vertikale më të mirë dhe vendosjen e rregulloreve të duhura. Për të siguruar një angazhim të plotë dhe për të mundësuar shërbimin e kërkuar, është e nevojshme një përshkrim më i mirë i punës ose të paktën një ndarje më e mirë e punës për stafin ekzistues.

Për këtë arsye, janë parashikuar dy drejtime kryesore:

1. *Struktura e menaxhimit*
2. *Rregullore lokale për menaxhimin e mbetjeve*

Objektivi kryesor i këtij sektori do të jetë:

- *mbulimi me shërbimin e pastrimit të të gjithë territorit,*
- *mbulimin 100% të kostos nga tarifa, dhe*
- *monitorimin e vazhdueshëm të PVMMU.*

VII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Nëse duam që PVMMU të funksionojë dhe zbatohet me sukses në Gramsh, është mjaft e rëndësishme që publiku ta kuptojë dhe mbështesë atë në çdo hallkë të tij. Po ashtu, suksesi i skemave që propozohen, nismave që do të ndërmerren varen tërësisht nga shkalla e angazhimit nga vetë përdoruesit si: familjarët, bizneset, etj.

Menaxhimi i mbetjeve është sa problem teknik dhe kërkon organizim të mirë dhe përdorim të teknologjive moderne, por është dhe problem komunikimi me zbatuesit e saj, qofshin këta banorë, biznese apo institucione publike. Ndërsa incentivat ligjore dhe ato ekonomike mund të ndryshojnë sjelljen e qytetarëve, krijimi i ndërgjegjes së duhur të publikut dhe dëshira për të menaxhuar sa më mirë mbetjet është po aq e rëndësishme.

Promovimi i ndërgjegjësimit publik mbi problemet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, dhe inkurajimi i individëve dhe komuniteteve për të marrë më tepër përgjegjësi për mbetjet që ata vetë prodhojnë, është një aspekt i rëndësishëm i informimit qytetar por edhe i mirë artikulluar nga vetë bashkia në Vizionin e PVMMU. *Ndaj bashkia duhet të fokusohet në:*

- i. **Informimin e publikut mbi shërbimin e ri të menaxhimit të mbetjeve** – duke i mundësuar publikut të bashkëpunojë në mënyrë konstruktive me një skemë të re. Publiku duhet të njoftohet mbi vendet e përcaktuara si VGM, oraret e zbrazjes së kontenierëve, frekuencën e tërheqjes së mbetjeve, standartin e shërbimit të pastrimit. Informacioni duhet të komunikohet në mënyrë të qartë për t'i mundësuar ata të koordinohen me rregullat e shërbimit dhe t'u tregohen dhe mjetet që do të përdoren për mbledhjen e mendimeve dhe ankesave të tyre. Ky proces duhet të përfshijë gjithashtu edhe informacion mbi rregulloren, penaltitetet dhe sanksionet, strategjinë e mbulimit të kostos dhe nivelin e tarifës, mbi mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.
- ii. **Rritja e ndërgjegjësimit ndaj praktikave të mira** në menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane – duke nisur nga identifikimi i grupeve të interesit dhe hartimi së bashku me to i programeve për zbatimin e skemave të ndarjes në burim të mbetjeve, riciklimit, apo kompostimit. Në grupet e interesit duhet të përfshihen familjet, bizneset, institucionet, grupet në nevojë, të rinjtë dhe fëmijët si pjesë e grupeve të fokusuara të cilat do të përfitojnë nga shërbimi i pastrimit. Ata do të marrin një rol të rëndësishëm në promovimin, kryerjen dhe zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit publik.
- iii. **Edukimi i brezit të ri** përmes një programi të detajuar edukues brenda dhe jashtë ambienteve të shkollës për të rritur njohuritë e tyre mbi shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe për të inkurajuar minimizimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin. Praktikant apo aksionet konkrete të pastrimit janë një metodë shumë e mirë edukimi duke bashkëpunuar me grupet rinore apo dhe me stafet pedagogjike të shkollave.
- iv. **Forcimi dhe rritja e përfshirjes publike dhe biznesit** – duke rritur bashkëpunimin me grupe të ndryshme interesi në sigurimin e mbështetjes publike për iniciativat e menaxhimit të mbetjeve, alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin, mobilizimin e publikut dhe grupeve të tjera të

interesit në mbështetjen e zbatimit të tyre, futjen e pagesës së rregullt të tarifës duke vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë e tyre për të paguar. Një çështje e cila ka nevojë të merret në konsideratë, është siguri i angazhimit privat në menaxhimin e mbetjeve urbane, për të krijuar mundësi për krijimin e partneritetit publik-privat (PPP).

7.1 Metodat që mund të përdoren

Bashkia Gramsh duhet të diversifikojë sa më shumë mjetet e komunikimit që edhe qytetarët të kuptojnë sfidat dhe ecurinë e bashkisë në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe në të gjithë territorin. Synimi i fushatave duhet të jetë ofrimi i informacionit të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së qytetit, rritja e ndërgjegjësimit qytetar për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore dhe nxitja e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë *broshurat, artikujt në gazeta* me qarkullim kombëtar dhe rajonal, njoftimet, tabelat informuese dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Duhet të përdoren materiale komunikimi për të ndihmuar banorët të kuptojnë sfidat për administrimin e mbetjeve të komunitetit si dhe përparimin për trajtimin e këtyre sfidave. Po ashtu tabelat e informimit mund të përdoren për dhënien e mesazheve ndërgjegjësuës, informative dhe kontakteve për informim të mëtejshëm apo ankesa. Nga bashkia mund të shpërndahet falas një broshurë me orientime për përdorimin e kontenierëve dhe vendndodhjen e tyre; orientime mbi fraksionet që grumbullohen, udhëzues për dorëzimin e duhur të materialeve të ndryshme sipas fraksioneve, detyrimet dhe detyrat për dorëzimin në mënyrën e duhur të mbetjeve, nevojat dhe pretendimet e bashkëpunimit të qytetarëve, etj.

Metoda e komunikimit *derë më derë* rekomandohet si mjaft efektive për të ftuar qytetarët të bëhen pjesë e nismave të ndryshme, sic është ajo e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret por edhe të mbështesin bashkinë në zbatimin e skemave të përzgjedhura. Banorëve dhe bizneseve duhet t'u shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, për metodologjinë e kompostimit, etj.

Të përdoren kamionët dhe kontenierët për informim: Tek të gjithë kamionët dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme (me germa të paktën 10 cm të mëdha) parrulla “Mbani pastër qytetin tuaj” apo ndonjë parullë tjetër.

Në mënyrë periodike mund të kryhet një reklamim në masë të gjërë, nëpërmjet materialeve gjithëpërfshirëse, i rezultateve cilësore dhe sasiore të arritura gjatë viteve paraardhës, në veçanti për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve, me qëllim pjesmarrjen aktive të publikut në këtë proces. Mekanizmat e marrjes së mendimit dhe reagimit qytetar – Autoritetet lokale kanë identifikuar ndërgjegjen e ulët qytetare një nga faktorët kryesorë që ndikojnë negativisht në pastërtinë e qytetit dhe

më konkretisht në papastërtinë e disa PGM, (hedhjen pa kriter të mbetjeve urbane dhe voluminoze jashte kontenierëve) si dhe ekzistencën e pikave informale ku hidhen pa kriter mbetje. Për këtë qëllim, ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe pastërtisë së qytetit, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve.

Bashkia duhet që përmes *njoftimeve publike* të ftojë qytetarët të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak edhe kur diskutohen çështje të menaxhimit të mbetjeve. Institucionalizimi i një mekanizmi të tillë do të rrisë besimin tek banorët se bashkia i merr parasysh mendimet, idetë dhe sugjerimet e tyre. Kjo realizohet duke ngritur zyrën e informacionit për të mundësuar marrjen e mendimit nëpërmjet:

- Mbledhjes së ankesave të qytetarëve.
- Sondazheve të herëpashershme si një mjet i mirë monitorimi të shërbimit dhe standarteve që ai ofron. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t'u përfshirë në sondazh, mostra që duhet të realizohet është midis 150 dhe 200 të intervistuar.

VIII. PLANI I AKTIVITETEVE

Bashkia Gramsh synon të krijojë një sistem gjithëpërfshirës i menaxhimit të mbetjeve, i arritshëm nga çdo pjesëtar i komunitetit dhe i siguruar përmes një partneriteti të plotë midis të gjitha niveleve të qeverisjes dhe sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, ku banorët kanë ndjenjë të pronësisë dhe përgjegjshmërisë për mbetjet që ata krijojnë, duke reduktuar sa më shumë normën e gjenerimit të mbetjeve.

Shënim: Afatet kohore: Afatshkurtër (1-2) Afatmesëm (2-3) Afatgjatë (3-5)

Aktivitete	Rolet Përgjegjese	Aktorët mbështetës	Afatet Kohore	Buxheti
Objektivi: Aprovimi i PLMIM				
Prezantimi i PLMIM dhe konsultimi me publikun.	Grupi i punës PLMIM, Bashkia Gramsh	Komuniteti	Afatshkurtër	Pa kosto
Rishikimi i PLMIM dhe përshtatja sipas komenteve/ sygjërimeve nga konsultimi me publikun.	Bashkia Gramsh	Grupi i punës PLMIM	Afatshkurtër	Pa kosto
Dërgimi i PLMIM për miratim në Këshillin Bashkiak.	Bashkia Gramsh	Grupi i punës PLMIM	Afatshkurtër	Pa kosto
Rishikim dhe përditesim përfundimtar i PLMIM.	Bashkia Gramsh	Grupi i punës PLMIM	Afatshkurtër	Pa kosto
Miratimi i PLMIM.	Këshilli Bashkiak Gramsh	Grupi i punës PLMIM	Afatshkurtër	Pa kosto
Krijimi i një ekip zbatimi dhe monitorimi (EZM) në të gjithë territorin ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve.	Bashkia Gramsh	Grupi i punës PLMIM	Afatshkurtër	Pa kosto

Drejtimi Strategjik Infrastruktura dhe Mjedisi				
Objekti: Përmirësimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Gramsh: Ofrimi i shërbimeve eficiente dhe cilësore				
Riorganizimi i zonave të shërbimit të mbetjeve	Bashkia Gramsh DSHP	Grupi i punës PLMIM	Afatshkurter	10,000 ALL
- <i>Zona e parë që konsiston në zonën urbane, pra përfshin gjithë qytetin.</i>				
- <i>Zona e dytë që konsiston në Njësinë Administrative Pishaj</i>				
- <i>Zona e tretë që konsiston në Njësinë Administrative Kodovjat</i>				
Zgjerimi i dy zonave rurale me 10 fshatra të tjerë.	Bashkia Gramsh DSHP	Grupi i punës PLMIM	Afatshkurtër	Pa kosto
- <i>Konsultimi me banorët e fshatrave të rinj që do mbulohen me shërbimin e pastrimit, në lidhje me vendosjen e kontenierëve</i>				
- <i>Përgatitja e hartës së shpërndarjes së kontenierëve</i>				
- <i>Vendosja e kontenierëve në zonat e përcaktuara</i>				
Investim në infrastrukturë duke e përmirësuar atë, në saj të nevojave të reja që ka Bashkia e re (blerje kontenierë dhe mjete teknologjike).	Bashkia Gramsh DSHP	Donatorë të huaj Biznese	Afatshkurtër	11,420,000 Lekë
Përmirësim i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në çdo lagje të qytetit duke arritur frekuencën e mbledhjes 7 herë në javë (çdo ditë).	Bashkia Gramsh DSHP	-	Afatshkurtër	Buxheti Vjetor i Programit të mbetjeve
Përmirësim i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në çdo fshat ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve nga një herë në javë në dy herë në javë.	Bashkia Gramsh DSHP	-	Afatshkurtër	Buxheti Vjetor i Programit të mbetjeve
Monitorimi i rregullt i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonat e shërbimeve.	DSHP	Drejtorja e Financave dhe EZM	Afatshkurtër	Pa kosto

Raportime të rregullta nga të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e monitorimit në instancet vendimmarrëse të bashkisë.	Bashkia Gramsh DSHP	EZM	Afatshkurtër	Pa kosto
Përgatitja e raporteve ditore/javore dhe mujore të gjendjes së PGM për të gjitha NJ.A.	Supervizori	DSHP	Afatshkurtër	Pa kosto
Objekti: Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi i mbetjeve inerte dhe ndërtimore				
Inspektimi dhe kontrolli i ndotjes urbane nga materialet inerte dhe ndërtimore, skeletet e makinave, etj, që nga gjenerimi, transporti deri depozitimin e tyre.	Specialisti i Mjedisit në Bashki, Policia Bashkiake	DSHP	Periodikisht, (çdo ditë)	Pa kosto
Projektim dhe ndërtim ose miratim të një venddepozitimi të përkohshëm për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore brenda standarteve kombëtare.	Drejtoria e Urbanistikës, DSHP	Donatorë të Huaj, Projekte qeveritare	Afatgjatë	Për tu parë
Organizimi i tryezave lokale me industrinë e ndërtimit për të inkurajuar përdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve.	Specialisti i Mjedisit në Bashki,	Kompanitë e ndërtimit, Policia Bashkiake, DSHP	Afatmesëm	30,000ALL
Hartimi i një rregullore për operimin e venddepozitimit për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore. Përcaktimi i sanksioneve kundrejt gjeneruesve të mbetjeve në rast të mos menaxhimit të duhur të këtyre mbetjeve që ata gjenerojnë.	Specialisti i Mjedisit në Bashki, Policia Bashkiake	Drejtoria Juridike dhe DSHP	Afatmesëm	Pa kosto
Monitorimi i rregullt i operimit të venddepozitimit të mbetjeve ndërtimore dhe vëllimore, si dhe monitorimi i prodhuesve të tyre në lidhje me procedurën që ata ndjekin kur gjenerojnë këto lloj mbetjesh.	Specialisti i Mjedisit në Bashki, Policia Bashkiake	DSHP	Afatmesëm	Pa kosto
Objekti: Rehabilitimi i vend-depozitimit në Bashkinë Gramsh dhe studimi për krijimin e një pike transferimi				
Kryerja e një studimi fizibiliteti për rehabilitimin dhe mbylljen e venddepozitimit.	Bashkia Gramsh, Drejtoria e Urbanistikës, DSHP	MTM, MEF, MIE	Afatgjatë	500,000 ALL

Rehabilitimi i vend-depozitimit në teritorin e Bashkisë Gramsh.	Bashkia Gramsh, Drejtoria e Urbanistikës	MTM, MEF, Donatore te huaj	Afatgjatë	
Hartimi dhe miratimi i një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes se pikes se grumbullimit.	Bashkia Gramsh	EZM	Afatgjatë	
Kryerja e një studimi fizibiliteti për krijimin e një pike transferimi.	Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Gramsh	MTM, MIE, Inspektoriati i Mjedisit Elbasan, ARM	Afatgjatë	200,000 Eur
Përmirësimi i procedurave të liçensimit mjedisor të ST në kooperim të ngushtë me strukturat e Agjensisë Rajonale	Bashkia Gramsh,	ARM	Afatgjatë	Pa kosto
Lobim institucional pranë qeverisë qendrore (M.I.E.& M.T.M) për financimin e një pikë-transferimi.	Bashkia Gramsh, Kryetari i Bashkisë	Donatorë të Huaj, Projekte qeveritare	Afatgjatë	Pa kosto
Objektivi: Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema të përshtatshme pilot				
Prezantimi i skenave te ndarjes në burim në rruget kryesore të qytetit dhe në shkollat 9 vjecare dhe të mesme të qytetit (mbetje të njoma dhe të thata).	Bashkia Gramsh, DSHP	Komuniteti	Afatgjatë	Pa kosto
Aplikimi i infrastrukturës së përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme.	Bashkia Gramsh, DSHP	Bizneset ricikluese	Afatgjatë	
Investim në kontenierë dhe makina teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve.	Bashkia Gramsh, DSHP	Bizneset ricikluese	Afatgjatë	

Prezantimi i skemave të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme në Njësite Administrative të zonave rurale.	Bashkia Gramsh, DSHP, Administratori i Njësive, Specialisti i mjedisit	Komuniteti, Kryesia e Fshatit	Afatgjatë	
Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të biodegradueshme.	Bashkia Gramsh, DSHP	Komuniteti	Afatgjatë	
Projektimi dhe ndërtimi i dy pikave të hapura për kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme dhe kontrolli i vazhdueshëm i këtyre pikave.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria e Urbanistikës, Specialisti i Mjedisit	EZM, Komuniteti	Afatgjatë	200,000 Lekë
Mobilizimi i përfshirjes së komunitetit në skemat pilot, bërja e anketimeve paraprake për vlerësimin e vullnetit për t'u përfshirë para se të përzgjidhen zonat e dëshiruara.	Bashkia Gramsh, DSHP	Komuniteti, Bizneset, vullnetare dhe OJF	Afatmesëm	
Krijimi dhe zbatimi i skemave pilot të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi sipas skemave pilot të rekomanduara në këtë plan.	Bashkia Gramsh, DSHP	Komuniteti, Bizneset,	Afatgjatë	
Organizimi i takimeve në komunitet dhe me biznese, para dhe gjatë fillimit të skemave pilot për të mbështetur përpjekjet/programet e ndërgjegjësimit dhe edukimit për të rritur cilësinë dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit.	Bashkia Gramsh, DSHP	Komuniteti, bizneset, OJF	Afatgjatë	30,000 ALL
Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe analiza ekonomike mbi zhvillimin lokal të kompostimit në nivel lokal ose ndër-lokal.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike		Afat mesëm	500,000 ALL
Objekti: Stimulimi dhe mbështetja e sektorit privat lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit.				

Stimulimi dhe mbështetja e sektorit privat lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria ekonomike	Bizneset	Afatgjatë	
Inkurajimi i shtrirjes së skemave të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi përmes bashkë-financimit me bizneset e riciklimit dhe komunitetin.	Bashkia Gramsh , DSHP	Komuniteti	Afatshkurtër	
Promovimi dhe zhvillimi i tregjeve lokale për materiale të riciklueshme.	Bashkia Gramsh, DSHP	Komuniteti Bizneset	Afatshkurtër	
Drejtimi Strategjik: Sensibilizimi i komunitetit				
Objekti: Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të Bashkisë për mbajtjen pastër të territorit, pagimin e tarifës së pastrimit, si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve.				
Ofrimi i vazhdueshëm i informacioneve të përgjithshme për publikun dhe bizneset; broshura informative, buletinë, postera, rrjete sociale, etj.	Bashkia Gramsh, DSHP	Oj-f-të, zyra vendore arsimore, Bizneset, Komuniteti	Afatshkurtër	20,000 ALL
Ofrimi i informacioneve specifike për grupet e interesit (konsumatorët në zonat pilot).	Bashkia Gramsh, DSHP	Oj-f-të, zyra vendore arsimore, Bizneset, Komuniteti	Afatshkurtër	20,000 ALL
Lançimi i nismave të reja (grumbullimi individual i mbetjeve, riciklimi dhe kompostimi) duke përdorur promovimin në TV, radio lokale dhe gazeta.	Bashkia Gramsh, DSHP	OJF-të, Bizneset, Komuniteti	Afatshkurtër	100,000 ALL
Përdorimi i mjeteve teknologjike dhe kontenierët për të ofruar informacion të përgjithshëm (slogan, numrat e kontaktit, grafikët e shërbimit).	Bashkia Gramsh, DSHP	OJF-të, zyra vendore arsimore, Bizneset, Komuniteti	Afatshkurtër	

Me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit të bëhen transparent për publikun kostot e shërbimeve të pastrimit sipas kontratave si dhe detyrimet, ndalimet, rregullat si dhe një informacion specifik rreth shërbimeve, orareve, iniciativave, etj.	Bashkia Gramsh, DSHP	Komuniteti	Afatgjatë	10,000 ALL
Realizimi i fushatës "derë më derë" për të përfshirë popullatën dhe bizneset në mënyrë eficiente mbi aktivitetet e riciklimit dhe pagesës së tarifës së pastrimit.	Bashkia Gramsh, DSHP	OJF-të, zyra vendore arsimore, Bizneset, Komuniteti	Afatshkurtër	40,000 ALL
Hartimi i programeve dhe fushatave "vijuese" të riciklimit për të përmirësuar cilësinë e ndarjes në burim përmes programeve të riciklimit	Bashkia Gramsh, DSHP	OJF-të, zyra vendore Arsimore, Bizneset, Komuniteti	Afatshkurtër	40,000 ALL
Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët	Bashkia Gramsh	OJF-të, zyra vendore Arsimore, Bizneset, Komuniteti	Afatshkurtër	50,000 ALL
Drejtimi Strategjik: Forcimi Institucional				
Objektivi: Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij.				
Krijimi i dhe miratimi i një strukture lokale të inspektorëve bashkiak në lidhje me mjedisin dhe mbetjet / Zgjerimi dhe Forcimi i ASHP me staf për ofrimin e shërbimit nga vetë bashkia.	Specialisti i Mjedisit ne Bashki, Policia Bashkiake, DSHP	GP PLMIM	Afatshkurtër	
Hartimi i rregullores se funksionimit te ASHP.	Bashkia Gramsh	Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerezore	Afatshkurter	Pa kosto

Zbatimi i sistemit të monitorimit në të gjitha NJ.A. të Bashkisë dhe aplikimi i sanksioneve kundrejt shkelësve të rregullave apo dëmtuesve.	Specialisti i Mjedisit në Bashki,	Raportues nga komuniteti	Afatshkurtër	Pa kosto
Koordinimi në nivel rajonal dhe me njësitë lokale fqinje për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet, apo organizimin e shërbimit apo përdorimit e përbashkët të infrastrukturës së mbetjeve.	Specialisti i Mjedisit në Bashki, DSHP, Policia bashkiake	Inspektoriati Mjedisit Elbasan, ARM	Afatshkurtër	Pa kosto
Drejtimi Strategjik: Menaxhimi Financiar i Qendrueshem				
Objektivi: Krijimi i nje sistemi financiar te permiresuar (lidhur me buxhetin e investimeve te nevojshme)				
Rishikimi i koston së shërbimit për shpenzimet kapitale (makina dhe kontenerë).	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Spektori i Tatim Taksave	Cdo vit	Pa kosto
Rritje progresive e buxhetit vjetor operacional + mirëmbajtjes drejt mbulimit total të kostove operacionale dhe koston kapitale.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Spektori i Tatim Taksave	Afatshkurtër	Pa kosto
Objektivi: Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, marrvëshjeve dhe kontratave.				
Hartimi i projekteve konkrete dhe kerkimi per mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, huaj nga institucione financiare apo banka.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Spektori i Tatim Taksave	Afatshkurtër	
Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total te koston.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Spektori i Tatim Taksave	Afatshkurtër	Pa kosto
Aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mospagimin e tarifave të mbetjeve.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Spektori i Tatim Taksave	Afatshkurtër	Pa kosto
Vendos stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Aplikimi i uljeve në tarifat dhe heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Spektori i Tatim Taksave	Afatshkurtër	Pa kosto

Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan."	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Sektori i Tatim Taksave	Afatshkurtër	Pa kosto
Realizimi i pyetësoreve për të matur perceptimin e banorëve mbi shërbimin e pastrimit.	Bashkia Gramsh	DSHP	Afatshkurtër	15,000 ALL
Rishikimi i strategjisë së mbulimit të kostove dhe nivelit të tarifave, bazuar në analizën e zhvilluar në plan dhe marrja në konsideratë e performancës së grumbullimit, studimin e dëshirës për të paguar, kostove dhe objektivave si dhe indikatorët financiar të përcaktuar në këtë plan.	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Sektori i Tatim Taksave	Afatshkurtër	Pa kosto
Transparenca dhe komunikimi: Proçesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke përdorur metodat e komunikimit në masë si dhe atë "derë më derë".	Bashkia Gramsh, DSHP, Drejtoria Ekonomike	Sektori i Tatim Taksave	Afatshkurtër	Pa kosto

Tabela 38: Plani i veprimit 2019-2024

IX. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE.

Është e rëndësishme të monitorohet progresi i PVMMU, efektiviteti i masave që janë marrë dhe të identifikohen nevojat e reja.

Në punën për zbatimin e PVMMU, Kryetari i Bashkisë dhe stafi i tij duhet të mbështeten nga komuniteti dhe aktorët e tjerë institucional.

Aktorët kryesor janë:

Aktori	Bashkia (DSHP)	Kompania private	Supervizori nga DSHP	Qytetarët
Detyra	Bën grumbullimin, përpunimin e informacionit, harton raporte dhe jep direktiva. Raporton tek kryetari i Bashkisë.	Lidhja kryesore me Supervizorin Njohje më e mirë e zonave të tyre. Raportojnë çdo ditë tek DSHP.	Mban raporte të detajuara dhe raporton tek DSHP.	Raportojnë/ankohen në NJA; Zyra me një ndalesë, Telefon/façe internet e Bashkisë;

*Tabela 39:Aktorët kryesorë për zbatimin e PVMMU
Burimi: Bashkia Gramsh*

Koordinator i pëgjithshëm për zbatimin e monitorimit duhet të jetë Supervizori nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Ekipi do të fillojë të punojë menjëherë. Njerëzit e ngarkuar me këtë detyrë duhet të (i) kenë njohuritë e duhura në fushë për të realizuar monitorimin si dhe (ii) në numër të mjaftueshëm për të siguruar që janë matur të gjithë treguesit e monitorimit në të gjithë territorin, që janë përpunuar të dhënat dhe që në fund janë arritur konkluzionet. Ekipi i zbatimit duhet të siguroj informacion të saktë në lidhje me ecurinë e zbatimit të planit nga kompania provate me të gjithë elementet e tij nëpërmjet:

- Organizimit të vizitave në terren gjatë orareve të punës sipas grafikut javor përgjatë gjithë vitit.
- Organizimit të takimeve të hapura me grupe qytetarësh. (Nr telefoni per ankesa)

Monitorimit të dokumentacionit.Detyra e parë e këtij ekipi do të jetë hartimi i planit të detajuar të monitorimit, i cili duhet të konsistojë në indikatorët e performancës që vijnë:

- Indikatorët e performancës mjedisore
- Indikatorët financiarë
- Indikatorët administrativ


Shkalla e hierarkisë

Figura9:Shkalla e hierarkisë për PVMMU
Burimi: Bashkia Gramsh

Supervizori në bazë të informacionit të mbledhur do të raportojë tek Kryetari i Bashkisë dhe tek Shërbimet Publike mbi ecurinë e planit çdo muaj.

Në të njëjtën kohë, të gjitha palët e interesit në menaxhimin e mbetjeve, do t'u ofrohen informacione të rregullta mbi zbatimin e planit dhe fletë informative mbi gjendjen e mjedisit, duke përfshirë edhe një raport vjetor. Po ashtu bashkia në lidhje me monitorimin dhe raportimin e të dhënave komunikon me shumë aktorë në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar. Skema e komunikimit jepet bashkëlidhur.




Figure 20: Skema e komunikimit mes aktorëve

Detyrat e ekipit monitorues:

Bashkia (Drejtoria e Shërbimeve Publike)

- Përcakton prioritetet, termat e tenderit, planin e menaxhimit të mbetjeve
- Përcakton strategjinë e komunikimit mbi grumbullimin e mbetjeve, fshirjen dhe larjen e rrugëve
- Përcakton buxhetet, miraton faturat, përfshirë gjobat
- Blen materiale të reja (kazanë) dhe hap tenderat e rinj, nëse është e nevojshme
- Përcjell shqetësimet e këshillit/kryetarit/qytetarëve në lidhje me shërbimin e ofruar
- Negocion me ndërmarrjen/kompaninë në rast mosmarrëveshjes
- Raporton periodikisht (një herë në muaj) tek kryetari i bashkisë

Administratori

- Kontrollon çdo ditë (vetë ose nëpërmjet inspektorëve) shërbimin e ofruar ndaj qytetarëve dhe raporton tek drejtori i ndërmarrjes (një herë në muaj);
- Verifikon cilësinë dhe sasinë e shërbimit;
- Verifikon dhe përshtat nevojat për kazanë:
- Kur kazanët nuk mjaftojnë (kazanë të mbushur plot dhe mbetje në rrugë): propozon shtimin;
- Propozon të zhvendosë / të heqë ose të shtojë pika grumbullimi
- Identifikon nevojat e veçanta: p.sh. mbetje inerte për t'u mbledhur,
- Jep informacion:
 1. ndërmarrjes menjëherë për çdo mangësi në cilësi / sasi:
 2. Kazanë të papastruar apo të dëmtuar rrugën, ditën dhe orën e vëzhgimit

Dy rolet e reja të propozuara si detyra për stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

Supervizori

Roli: Të kontrollojë respektimin e kontratës, verifikimin dhe çertifikimin e faturave dhe propozimin e pagesave të operatorit si dhe gjobat dhe penaltitetet kur cilësia dhe sasia e punës nuk janë në termat e përcaktuara në kontratë. Ndërkohë po ky person duhet të organizojë aktivitetet e vlerësimit të shërbimit nga ana e qytetarëve dhe bizneseve, duke bërë të mundur monitorimin në plan të gjerë të këtij aktiviteti sensitiv.

Punon: në zyrën e bashkisë nën përgjegjësinë e Drejtorisë së shërbimeve publike. Përcakton prioritet dhe bën porosi për nevojat e veçanta që duhet të kryhen nga operatori (inerte, evente, zhvendosje të kontenierëve, etj.) në kuadër të buxhetit.

Harton: statistikën dhe kontrollet e sasive. Verifikon dhe raporton të dhënat (mirëmbajtja e kontenierëve, oraret e grumbullimit, rrugët, km, punonjësit, etj.).

Raporton në mënyrë të përvajshme dhe të përmuajshme për bashkinë, duke u bazuar tek të dhënat nga njësitë administrative, dhe statistikën. Raportet do të përmbajnë por nuk do të kufizohen në informacionin si më poshtë:

- Sasitë e shërbimeve: kontrollin dhe miratimin e faturave

- Mungesa e cilësisë: mos mbledhja e kontenierëve, vendet e grumbullimit të pa pastruara, kazanët e dëmtuar, mbetjet e depozituara jashtë vend-depozitimit
- Propozime bashkisë për gjambat, kur është e nevojshme, duke u bazuar në statistikat e mbledhura.
- Vendos reduktimin ose zhvendosjen e kontenierave dhe propozon rritje të numrit, nëse është e nevojshme.
- Zhvillon sondazhe dhe anketime me qytetarët dhe bizneset në lidhje me vlerësimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe mbi këtë bazë propozon ndryshimet në strukturat përkatëse.

Specialisti i menaxhimit të mbetjeve:

Roli: Të personalizojë dhe krijojë sistemin e të dhënave të abonentëve që marrin shërbimin e pastrimit. Të llogarisë koston dhe të përcaktojë tarifën sipas modelit që do të bëhet i detyruar nga qeveria.

Punon: në zyrën e bashkisë nën përgjegjësinë e Drejtorisë së shërbimeve publike. Hedh në sistem të dhënat dhe përcakton prioritet.

Përgatit: faturën e shërbimit; bën shpërndarjen e saj në baza vjetore (ose trimestrale) dhe realizon mbledhjen e saj

Raporton: në mënyrë të përmuajshme dhe një vjeçare për bashkinë informacion në lidhje me tarifën e mbledhur;

Harton: propozime për shpenzime të veçanta, dhe ndihmon në përgatitjen e buxhetit vjetor për Bashkinë;

Propozon për politika subvencionimi, kontrata paralele për 3R, analiza dhe sugjerime për të arritur objektivat e menaxhimit të mbetjeve në lidhje me kosto/tarifën, Shpenzime të veçanta jashtë buxhetit vjetor.

Statistika të ofruara nga kompania

Kontraktuesi duhet të mbajë statistika ditore në pikat kryesore dhe t'i raportojë ato çdo muaj, në formë elektronike apo në letër, tek mbikqyesi.

- ✓ Sasinë ditore të mbetjeve të grumbulluara dhe të depozituara në venddepozitim
- ✓ Numrin e kazanëve të pastruar
- ✓ Orët e sakta të grumbullimit: kohën e saktë të nisjes së kamionëve, kohën e zbrasjes në venddepozitim dhe kohën e kthimit në garazh
- ✓ Kilometrat ditore të çdo kamioni
- ✓ Numrin ditor dhe itinerarin e lëvizjes së kamionëve
- ✓ Listën ditore të pastrimit dhe të larjes së rrugëve
- ✓ Oraret ditore të larjes dhe të fshirjes manuale/ mekanike
- ✓ Listën e punonjësve dhe oraret ditore të punës
- ✓ Inventarin mujor të kazanëve, nga rruga në rrugë dhe gjendjen fizike të tyre
- ✓ Zhvendosjen, mbajtjen ose humbjen e kazanëve: kazanët e larë: listën e kazanëve me probleme (rrugën, numrin e kazanit), riparimet specifike, datën etj.
- ✓ Sasinë e mbetjeve të ricikluar të grumbulluar/përpunuar nga qendra(t) e grumbullimit

- ✓ Marrjen e komenteve/reagim ndaj kërkesave të kryetarëve të lagjeve/rajoneve ose supervisorit rreth mungesës së cilësisë apo të sasisë së grumbulluar

Kontrollori në venddepozitim

- ✓ Raporton mbi aktivitetet në venddepozitim, kontrollon dhe mbledh informacione mbi sasinë e shërbimit
- ✓ Raporton për çdo kamion: ID-në e kamionit, orën, llojin e mbetjeve (nëse është e veçantë)
- ✓ Raporton orët e punës së makinerive (buldozerit)
- ✓ Raporton për ndonjë ngjarje të veçantë në venddepozitim: zjarr, aksident, etj. dhe kontrollon cilësinë e mbetjeve
- ✓ Informon supervisorin në rast mbetjesh ose kamionësh jo në përshtatje me atë çka është përcaktuar
- ✓ Siguron raporte javore për supervisorin